ZBULUESIT

Viti 1 - Tremujori 2

Zbulimi i thesareve të përjetshme në librin e Lukës përfshirë lindjen e Jezusit përmes mësimit të Tij të shëmbëlltyrës së samaritanit të mirë



Programi Bazë

Zbuluesit është një shërbesë e Discovery Land Global.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Një mesazh nga drejtoresha ekzekutive

Të dashur drejtues,

Ju jeni pjesë e një grupi shumë të rëndësishëm të njerëzve që janë thirrur për të ndërtuar brezin e ardhshëm të dishepujve të qëndrueshëm. Lutem që do të përjetoni gëzim të madh çdo javë ndërsa studioni Fjalën e Perëndisë dhe pastaj diskutoni rreth saj me nxënësit tuaj. Pavarësisht rolit tuaj apo moshës me të cilën punoni, ju jeni me vlerë! Efesianëve 2:10 thotë: *"Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to."* Ky varg na kujton se të shërbyerit nuk ka të bëjë me ne, por me punën e mbretërisë që Perëndia po bën përmes nesh.

Këtë tremujor do të kuptojmë më mirë zemrën e Jezusit, ndërsa ecim përkrah Tij dhe studiojmë shërbesën e Tij në Dhiatën e Re. Shijojini pasazhet e Shkrimit dhe thellohuni personalisht në marrëdhënien tuaj me Të ndërsa përgatiteni çdo javë. Gjithashtu, kaloni kohë duke u lutur dhe duke i kërkuar Perëndisë të punojë në jetën tuaj dhe në jetën e nxënësve tuaj gjatë këtij tremujori. Për disa nga ata nxënës, ti mund të jesh personi i vetëm që lutet dhe i udhëheq frymërisht. Përgjatë tremujorit do t'i sfidojmë nxënësit të besojnë në Jezusin si Shpëtimtari i tyre, të dinë se çfarë besojnë dhe, si rezultat i njohjes së Fjalës së Perëndisë, të bëhen të guximshëm e të kenë kurajë ndërsa qëndrojnë në Jezusin në jetën e përditshme.

E bekuar që shërbej me ju!

Kris Smoll
Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Tabela e Përmbajtjes
Viti 1 – Tremujori 2

Të kuptojmë kurikulën..... 4
Përmbledhja e tremujorit..... 9
Mësimi 1: Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit.. 12
Mësimi 2: Jezusi lind..... 22
Mësimi 3: Festojmë për Jezusin! 29
Mësimi 4: Maria dhe Jozefi prezantojnë Jezusin në tempull. 33
Mësimi 5: Jezusi mëson në tempull..... 39
Mësimi 6: Jezusi pagëzohet dhe refuzohet.. 46
Mësimi 7: Jezusi shëron vjehrrën e Pjetrit..... 54
Mësimi 8: Një grua mëkatare vajos Jezusin. 60
Mësimi 9: Jezusi u mëson dishepujve të mos kenë turp. 67
Mësimi 10: Jezusi mëson për samaritanin e mirë..... 74
Mësimi 11: Dita e përsëritjes. 81
Mësimi 12: Dita e testit 84

Shtojca

Mësim tematik: Bibla është e vërtetë..... 87
Mësim tematik: Jezusi është Mbreti ynë..... 95
Lojërat e fundit të përsëritjes 101
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin ..... `104
Falënderimet dhe lejet..... 106

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

TË KUPTOJMË KURIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbulesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të meditуar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepro si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektiv të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
-: 15 Loja e përsëritjes
: 00 Adhurimi
: 15 Koha e zbulimit
: 30 Mësimi nga Bibla
: 60 Loja e fundit e përsëritjes
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiqu t'i bashkosh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin
Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin
Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimit:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).
Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.
Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.
Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën "Vepro si duhet" te mësimi.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që "t'i jepni jetë Biblës", duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t'i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t'i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin "Gjejeni" në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t'i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posteri *Ndihu si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimit dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
2 Pjesëmarrja aktive në klasë
1 Shfaqja e frytit të Frymës
1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesaret e gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhja e Tremujorit

Viti 1 – Tremujori 2

Këtë tremujor do të vazhdojmë udhëtimin përmes Biblës ndërsa studiojmë librin e Lukës. Siç mësuam tek Zanafilla, Perëndia kishte premtuar një Shpëtimtar për botën. Ashtu si besimtarët sot shikojnë pas dhe besojnë në atë Shpëtimtar që erdhi dhe vdiq për mëkatin tonë, patriarkët e Dhiatës së Vjetër mezi prisnin dhe besonin në premtimin e Perëndisë për Shpëtimtarin që do të vinte një ditë. Studimi i librit të Lukës na zbulon se si premtimi u bë realitet. Lutja jonë është që, përmes këtij studimi, shumë nxënës do të besojnë në Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezusin, dhe se ata që besojnë do të rriten në hirin dhe njohjen e Tij.

Perëndia kishte vepruar gjatë 400 viteve pas kohëve të regjistruara të Dhiatës së Vjetër. Edhe pse Ai nuk foli drejtpërdrejt me njerëzit, siç kishte bërë në Dhiatën e Vjetër, Fjala e Tij e shkruar vazhdonte të fliste. Shumë judenj u mbajtën në premtimin e Fjalës së Tij dhe jetuan në shpresën e Shpëtimtarit që do të vinte. Një ditë, kur një prift i quajtur Zakaria po shërbente me besnikëri në tempullin e Zotit në Jerusalem, Perëndia theu heshtjen. Engjëlli i Tij i foli Zakarias dhe lajmëroi se ai dhe gruaja e tij Elizabeta, përmes një mrekullie, do të kishin një djalë, i cili do të përgatiste popullin e Izraelit për ardhjen e Zotit. Engjëlli i Perëndisë i foli gjithashtu një vajze të re të quajtur Mari dhe i dha lajmin më të jashtëzakonshëm – ajo do të ishte nëna e vetë Birit të Perëndisë, Shpëtimtarit të botës. Fjala e Perëndisë u përmbush për Zakarian, Elizabetën dhe Marinë. U përmbush edhe për ne. Prandaj mund të themi gjithmonë me gëzim: “Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë.”

Pikërisht siç kishte premtuar Perëndia, Zakaria dhe Elizabeta patën një djalë të quajtur Gjon, dhe Maria pati një djalë të quajtur Jezus. Kur Jezusi lindi, Perëndia foli sërish përmes engjëllit të Tij me disa barinj që po ruanin delet në fusha. Ishte lajmi më i mirë i historisë njerëzore: Shpëtimtari i botës kishte lindur në Bethlehem! Kur dëgjuan atë që shpallën engjëjt, barinjtë nxituan të shihnin Shpëtimtarin foshnjë, dhe kur e panë, ua treguan të tjerëve Lajmin e Mirë. Sepse, si mund të mos e tregonin? Ne kemi të njëjtin Lajm të Mirë, ndaj duhet t’u tregojmë të tjerëve se Jezusi lindi për të qenë Shpëtimtari ynë.

Pasi lindi Jezusi, Maria dhe burri i saj, Jozefi, bënë atë që thoshte Ligji i Perëndisë. E rrethprenë Jezusin në ditën e tetë dhe më vonë e prezantuan të sapolindurin, Birin e Perëndisë, në tempullin e Jerusalemit. Në tempull ata patën dy takime të mrekullueshme. I pari ishte një njeri i quajtur Simeon, i cili kishte pritur me durim të shihte Shpëtimtarin para se të vdiste. Takimi i dytë ishte një profeteshë e vjetër e quajtur Ana, e cila e njohu foshnjën Jezus si Shpëtimtarin. Siç mund ta shohim,

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Perëndisa shpërbleu durimin e tyre dhe nga ata mësojmë të presim me durim Perëndinë.

Edhe pse Perëndia nuk na ka zbuluar shumë nga fëmijëria e Jezusit, Ai na informon për një ngjarje shumë të rëndësishme. Jozefi dhe Maria ishin besnikë në pjesëmarrjen e përvitshme të festës së Pashkës në Jerusalem. Kur Jezusi ishte 12 vjeç qëndroi në tempull pas festës, duke mësuar nga mësuesit e tempullit dhe duke u rritur në urtësi. Megjithëse prindërit e tij u tronditën nga zhdukja e menduar e tij, Ai u siguroi me qetësi se shtëpia e Atit të Tij ishte pikërisht vendi ku duhet të ishte. Fjala e Perëndisë na thotë se Jezusi vazhdoi të rritej në urtësi dhe na thotë të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë. Prandaj duhet t'i përkushtohemi studimit të përditshëm të Fjalës së Perëndisë, që të mund të rritemi në urtësi.

Jezusi u rrit dhe erdhi koha e Tij për të filluar shërbesën. Në bindje ndaj Atit të Tij Qiellor, Jezusi shkoi të pagëzohej nga Gjon Pagëzori. Pak kohë pas pagëzimit të Tij dhe tundimit nga Satani në shkretëtirë, Jezusi shkoi të jepte mësim në sinagogë në qytetin e Tij, Nazaret. Përmes mësimit atë ditë, Ai u tha njerëzve në sinagogë se Ai ishte Shpëtimtari që kishin pritur. Por në vend që ta pranonin, ata e refuzuan. Në vend që të zgjidhnin Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, judenjtë në Nazaret e refuzuan dhe u përpoqën ta vrasin. Por, prej atij refuzimi dhe vdekjes së Tij në kryq, secili prej nesh ka mundësinë ta zgjedhë Jezusin si Shpëtimtar.

Jezusi shpëtoi nga hebrenjtë në Nazaret dhe vazhdoi shërbesën e Tij. Përveç mësimit dhe predikimit, Jezusi bëri shumë mrekulli. Mrekullitë e Tij të shërimit kanë qenë prova që u duhej njerëzve për të besuar se Ai ishte Biri i Perëndisë, Shpëtimtari i botës. Edhe pse shumë njerëz në kohën e Jezusit erdhën tek Ai për shërim fizik, qëllimi i Tij në botë ishte të vdiste në kryq dhe të ringjallej, që ata të mund të shëroheshin frymërisht nga mëkati i tyre. Ata që janë shëruar frymërisht nga Jezusi e dinë që, ose tani ose në të ardhmen, Ai do të na shërojë edhe fizikisht. Ne ecim në këtë jetë duke besuar se Jezusi mund të na shërojë.

Gjatë kohës së Jezusit në tokë, drejtuesit fetarë u përpoqën shumë herë ta zhvlerësonin dhe të kundërshtonin faktin se Ai ishte Shpëtimtari. Këta burra të vetëdrejtësuar i anashkalonin shumë lehtësisht mrekullitë e Tij dhe urtësinë e Tij, dhe me keqdashje sulmonin dashurinë dhe mëshirën e Tij. Kjo sjellje u bë shumë e dukshme një mbrëmje, kur Simoni fariseu e ftoi Jezusin për darkë. Një grua mëkatare erdhi dhe adhuroi Jezusin, duke larë këmbët e Tij me lotët dhe flokët e saj, duke i puthur e duke i vajosur me parfum. Simoni e përqeshi në vend që të përulej e të kuptonte se ishte po aq mëkatar sa ajo. Ky kontrast i errët na ndihmon të pranojmë me përulje se jemi mëkatarë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ndërsa Jezusi vazhdonte shërbesën e Tij, njerëzit që dëshmonin mrekullitë e Tij të mëdha dhe dëgjonin mësimet e Tij me autoritet, pyesnin veten se kush ishte Ai dhe diskutonin mes tyre mundësitë. Jezusi i dinte hamendësimet e tyre, dhe një ditë, ndërsa kalonte kohë me dishepujt e Tij, Ai i përballi me një pyetje: "Kush thoni ju se jam Unë?" Kur Pjetri iu përgjigj se Ai ishte Mesia i Perëndisë, Jezusi i paralajmëroi dishepujt të mos kishin turp prej Tij, duke u shpjeguar se, nëse duam këtë jetë më shumë se Atë, do ta humbasim. Ky paralajmërim na ndihmon të jemi të guximshëm dhe të mos kemi turp për Jezusin.

Përgjatë shërbesës së Jezusit, "ekspertët" në Ligjin e Perëndisë e testuan me pyetje për ta vënë në vështirësi. Një ekspert i tillë i bëri Jezusit pyetjen e drejtë, por me qëllimin e gabuar. Kur e pyeti Jezusin se çfarë duhet të bënte për të fituar jetën e përjetshme, Jezusi e pyeti se çfarë thoshte ligji, që është, të duash Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht. Në vend që, me përulje të pranonte se ishte i paaftë ta bënte këtë, eksperti u përpoq të gjente hapësira boshe në ligj. Jezusi iu përgjigj me shëmbëlltyrën e samaritanit të mirë. Ekperti dukej jo i gatshëm të kuptonte se po fliste me të vetmin që e donte vërtet Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht, dhe se gjithë të tjerët dështojnë në këtë. Vetëm kur besojmë tek Ai që e deshi Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht mund t'i duam vërtet të tjerët.

Ndërsa i afrohemi fundit të një tremujori tjetër, ne marrim një ditë për të kujtuar e përsëritur gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Pas dy javësh do të rikthehemi te libri i Lukës, për të vazhduar studimin e jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit, gjithashtu do të nisim studimin e jetës së apostullit Pal në librin e Veprave.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 1
Luka 1

Kupto si duhet:	Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit.
Mendo si duhet:	"Ki besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua." Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar kur besoj në Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

Fjalët e Urta 3:5-6 është një nga pasazhet e preferuara të 12 vargjeve kyç për shumë persona. Ama, një gjë është ta dish, e tjetër gjë ta vësh në veprim. Mund të jetë e vështirë ta vendosim besimin te dikush tjetër por, kur e njohim vërtet Atë që është 100% i besueshëm, marrëdhënia jonë me Të bëhet "jeleku ynë i shpëtimit" midis dallgëve të jetës. Këtë javë, ndërsa përgatitemi për të shërbyer, le të shqyrtojmë veten dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na rrisë besimin në Të.

Lutu: Lutu që Perëndia të të japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe që nxënësit në klasën tënde të kuptojnë nevojën e miqve të tyre për një Shpëtimtar.

Lexo: Luka 1

Kupto si duhet: Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit
Perëndia kishte vepruar gjatë 400 viteve pas kohëve të regjistruara të Dhiatës së Vjetër. Edhe pse Ai nuk foli drejtpërdrejt me njerëzit, siç kishte bërë në Dhiatën e Vjetër, Fjala e Tij e shkruar vazhdonte të fliste. Shumë judenj u mbajtën në premtimin e Fjalës së Tij dhe jetuan në shpresën e Shpëtimtarit që do të vinte. Një ditë, kur një prift i quajtur Zakaria po shërbente me besnikëri në tempullin e Zotit në Jerusalem, Perëndia theu heshtjen. Engjëlli i Tij i foli Zakarias dhe lajmëroi se ai dhe gruaja e tij Elizabeta, përmes një mrekullie, do të kishin një djalë, i cili do të përgatiste popullin e Izraelit për ardhjen e Zotit. Engjëlli i Perëndisë i foli gjithashtu një vajze të re të quajtur Mari dhe i dha lajmin më të jashtëzakonshëm – ajo do të ishte nëna e vetë Birit të Perëndisë, Shpëtimtarit të botës. Fjala e Perëndisë u përmbush për Zakarian, Elizabetën dhe Marinë. U përmbush edhe për ne. Prandaj mund të themi gjithmonë me gëzim: "Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë."

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:

- Cakto këto personazhe për mësimin: Elizabeta, Zakaria, Maria, foshnja Gjon dhe foshnja Jezus. Mund të jenë kukulla, vizatime ose forma të prera me karton. Mos shëno emra mbi to, por ndërsa shpjegon, shto objekte ose fjalë që lidhen me personat.
- Përdor kostume dhe inskenoje mësimin.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: A mund të të besoj?

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit **t'i besojnë** një mesazhi duke u mbështetur tek ai dhe duke qenë vërtet të bindur për të.





Aktiviteti 1: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Kuti ose çanta – sillni sa më shumë të tilla, që hapen e mbyllen lehtësisht (synim: të paktën pesë kuti për çdo nxënës)
- Pesë etiketa të arta (burim i printueshëm)
- Një kuti e veçantë dhuratash, në ngjyrë të artë, me të paktën pesë dhurata brenda (ide për dhurata: 20 etiketa shpërblyese ose çmime të tjera si çokollata apo karamele me mbështjellëse ngjyrë floriri)
- Një zarf i artë me një mesazh të veçantë brenda: "Pesë nga kutitë/çantat kanë një etiketë të artë. Synimi yt është të gjesh atë që ka etiketën e artë! Kushdo që gjen një etiketë të artë, do të marrë një dhuratë të veçantë nga kjo kuti e artë në fund të Kohës së zbulimit! Nëse e gjen një etiketë të artë, duhet të ulesh menjëherë mënjanë." (burim i printueshëm)

Udhëzime për ambientin: Përpara fillimit të Kohës së zbulimit, vendosi pesë etiketat e arta brenda pesë kutive/çantave dhe sigurohu që të gjitha kutitë/çantat të jenë të vendosura në një grumbull të madh në hapësirën e KZ-së. Kutia e artë (me pesë dhurata brenda) dhe zarfi i artë duhet të vendosen në një zonë të veçantë, larg kutive/çantave dhe duhet t'i nxisin dhe t'i emocionojnë nxënësit.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

1. Kur nxënësit të arrijnë në stacionin e kutive, habitu me ta për zarfin e artë dhe për kutinë e artë të dhuratave. Thekso që kjo duket si një mesazh vërtet **i besueshëm.** Lexoje mesazhin e veçantë që gjendet brenda zarfit, duke shfaqur emocion. Nxiti nxënësit për gjetjen e etiketave të arta!
2. Thuaju nxënësve se mund të hapin sa kuti të duan derisa të gjejnë etiketën e artë; por, kur hapin një kuti që nuk ka etiketën e artë, duhet ta mbyllin dhe ta vendosin prapë te grumbulli i kutive. E njëjta kuti do të hapet disa herë. Kjo do ta shtojë entuziazmin te nxënësit. Demonstroje hapjen dhe mbylljen e kutive. Informoji nxënësit që, nëse nuk e mbyllin kutinë që kanë hapur, do të pezullohen nga loja për dhjetë sekonda, gjë që ul mundësinë e tyre për të gjetur një etiketë të artë.
3. Thuaj: "A i **besoni** këtij mesazhi të veçantë? A mendoni se vërtet gjenden pesë etiketa të arta dhe se, kushdo që gjen një etiketë të artë do të marrë një dhuratë të veçantë? A jeni të emocionuar? Atëherë, le të fillojmë! Përgatituni! Gati, nisu!"
4. Ti, bashkë me mësuesin kryesor dhe bariun, duhet të shihni nxënësit që nuk i mbyllin kutitë dhe t'u kërkoni të qëndrojnë larg për dhjetë sekonda, gjithashtu ndihmoni duke u siguruar që kutitë të jenë të mbyllura mirë pasi hapen.
5. Përsërite herë pas here fjalën **besim** duke thënë: "Unë e di që mund **t'i besojmë** mesazhit që gjendet në zarf, duhet të ketë patjetër pesë etiketa të arta."
6. Kur një nxënës gjen një etiketë të artë, kërkoji të ulet mënjanë (çdo nxënës mund të gjejë vetëm një etiketë).
7. Sigurohu që të gjenden të pesta etiketat e arta (kjo është shumë e rëndësishme për suksesin e KZ-së).
8. Në fund të Kohës së zbulimit hap kutinë e artë të dhuratave dhe jepi secilit nga nxënësit ose 20 etiketa shpërblyese, ose një dhuratë të veçantë.
9. Përforcoje duke përsëritur faktin se je i gëzuar që ata i **besuan** mesazhit.

Këshillë për Kohën e zbulimit: për klasa me më shumë nxënës, ndaji në grupe për kryerjen e aktivitetit.

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Përbërës për pudingun – puding me çokollatë, krem pastiçerie, grimca shumëngjyr-rëshe për spërkatje
- "Haribo" si krimba (pesë gjysma për t'i fshehur në puding dhe pesë qese të vogla me "Haribo" për fituesit)
- Tasa të cekët
- Peceta
- Gushore plastike
- Një kuti e veçantë, e artë me pesë dhurata brenda (qeset e vogla me "Haribo"-t)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Një zarf i artë me këtë mesazh të veçantë brenda: “Pesë nga tasat me puding kanë nga një gjysmë “Haribo”-je në formë krimbi brenda. Duhet ta konsumoni pudingun pa përdorur duart. Po, do të bëheni pis! Kushdo që gjen krimbin fiton një dhuratë të veçantë!” (burim i printueshëm)



Udhëzime për ambientin: vendos një gjysmë “Haribo”-je në fund të secilit prej tasave të cekët (gjysma e “Haribo”-s krimb do ta bëjë më të vështirë gjetjen), pastaj bëj aq tasa me puding dhe grimca shumëngjyrëshe për spërkatje sa nxënës ke, dhe vendosi në frigorifer. Shtoje kremin e pastiçerisë para se të vijnë nxënësit. Për të nxitur përfshirjen, vendos kutinë e artë (me pesë dhuratat brenda) dhe zarfin e artë diku ku nxënësit mund t’i shohin.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Kur nxënësit të arrijnë në stacionin e ushqimit, trego entuziazëm për zarfin e artë. Thekso se duket si një mesazh, të cilit vërtet mund **t’i besosh.** Lexoje me entuziazëm mesazhin e veçantë brenda zarfit. Nxiti vërtet nxënësit për gjetjen e “Haribo”-ve në puding!
2. Pyet: “A i **besoni** mesazhit të veçantë? A mendoni se është e vërtetë që pesë nga tasat me puding kanë “Haribo” në formë krimbi brenda, dhe a besoni që, nëse gjeni një prej tyre, do të merrni një dhuratë të veçantë? E po, mirë pra, kryqëzojini duart pas kurrizit – nuk mund t’i përdorni duart derisa të keni gjetur “Haribo”-t – dhe bëhuni gati. Nëse gjeni një “Haribo”, ma tregoni dhe ngrijeni lart që ta shoh. A jeni të emocionuar? Kur të them: “Nisu!”, mund të filloni.
3. Shpërndaju nxënësve tasat me puding, që ishin në frigorifer.
4. Pyet: “A i **besoni** këtij mesazhi të veçantë? Sa “Haribo” në formë krimbash janë fshehur? (Pesë!) A mendoni se është e vërtetë se kushdo që gjen një “Haribo”, do të marrë një dhuratë të veçantë? A jeni të emocionuar? Atëherë le të fillojmë! Përgatituni! Gati, nisu!
5. Vazhdo të përsërisësh fjalën **besim,** ndërsa nxënësit hanë pudingun.
6. Në fund të Kohës së zbulimit, hap kutinë e dhuratave dhe jepu nxënësve që kanë gjetur “Haribo”-t, një qese të vogël me “Haribo”.

Këshillë për Kohën e zbulimit: Çelësi për ta bërë të suksesshme KZ-në është t’i lësh me frymën pezull në fillim. Nëse i lejon nxënësit ta hanë pudingun që në fillim, do të humbasësh aspektin edukativ të kësaj përvoje.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i artit

Mjetet:



- Kartona bosh për poster (nga një për çdo skuadër)
- Konë për skuadrat (nga një për secilën)
- Kova/kuti me lapustila
- Shembull posteri me ngjyra për Fjalët e Urta 3:5-6 (në disa raste mund të përdorësh simbole si një zemër apo një shteg, të vizatuara në vend të fjalëve)
- Një zarf me ngjyra të ndezura brenda të cilit gjendet ky mesazh: "Skuadra që bën posterin më krijues për të ilustruar vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6, do të marrë një dhuratë të veçantë në fund të Kohës së zbulimit." (burim i printueshëm)
- Një kuti e veçantë dhuratash, shumëngjyrëshe, e mbushur me çmime për skuadrën fituese (çmimi duhet të jetë shpërblim i mirë për mundin e tyre, për shembull një pako me karamele apo çokollata)
- Zile



Udhëzime për ambientin: vendos një karton bosh pranë çdo skuadre. Kova/kutia me lapustila duhet vendosur 6 metra larg nga skuadrat. Kutia e dhuratave dhe zarfi duhet të vendosen në një vend të dukshëm, që të ketë emocion dhe pritshmëri.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra (më së shumti pesë nxënës për skuadër).
2. Kërkoju nxënësve të recitojnë Fjalët e Urta 3:5-6. Nxënësit mund t'i referohen posterit shembull nëse kanë nevojë.
3. Trego habi për faktin që gjendet një zarf dhe një kuti shumëngjyrëshe në një vend të dukshëm. Nxirr mesazhin nga zarfi dhe lexojua nxënësve.
4. Thuaj: "A i **besoni** këtij mesazhi? A mendoni se është e vërtetë që do të zgjedhim posterin e skuadrës më krijuese dhe se skuadra fituese do të marrë një dhuratë të veçantë? Atëherë bëni më të mirën tuaj. Për ta bërë edhe më argëtuese do ta zhvillojmë si një 'stafetë' arti. Kur të them: "Nisuni!", personi i parë nga çdo skuadër do të vrapojë dhe do të marrë një lapustilë, do të kthehet mbrapsht me vrap dhe do të fillojë të vizatojë në poster. Kur të dëgjoni zilen, kalojani lapustilën njërit prej shokëve të skuadrës, i cili më pas do të vrapojë për te koshi/kutia e lapustilave, do të zgjedhë një ngjyrë të re dhe do të vrapojë mbrapsht për të vizatuar. Sa herë të dëgjoni zilen, duhet të ndërroni lapustilën dhe artistin. (Zilja do të bjerë mesatarisht

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

çdo tridhjetë sekonda.) Anëtarët e skuadrës mund të udhëzojnë artistin në lidhje me atë që duhet të shkruajë apo të vizatojë, por nuk mund të prekin lapustilën apo letrën." (Me zgjedhje: me raste mund t'u kërkosh skuadrave të vrapojnë nga dy veta për te koshi i lapustilave.)

5. Pyet: "A jeni të sigurt se i **besoni** këtij mesazhi? A jeni të emocionuar? Atëherë, le të fillojmë. Përgatituni! Gati, nisu!
6. Në fund të aktivitetit, përforcoje mesazhin dhe fjalën **besim**, pastaj zgjidh skuadrën fituese dhe jepu një shpërblim nga kutia e dhuratave.
7. Kërkoju nxënësve t'i varin posterat në një hapësirë ku mund t'i shohin prindërit dhe familjarët.
8. Thekso faktin që ne mund **të besonim** se kishte një çmim në kuti dhe se mesazhi ishte i saktë.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Kur mbërritët në Kohën e zbulimit, morët një mesazh të veçantë për një çmim që mund ta fitonit. A i **besuat** mesazhit? Ishte shumë e qartë se çfarë duhet të bënit për të marrë dhuratën e veçantë. E pashë që shumë prej jush ishit të entuziazmuar për dhuratën. A u pëlqeu dhurata atyre që e morën? Ai mesazh i veçantë ishte i vërtetë, për shkak se ndodhi vërtet.

Në mësimin e sotëm biblik do të mësojmë për disa njerëz që ishin vërtet të gëzuar për një dhuratë të mrekullueshme, që do të merrnin. Fjala e Perëndisë u tregoi specifikisht se çfarë do të ndodhte. Disa që e dëgjuan Fjalën e Perëndisë, **besuan** se ishte e vërtetë. Ata pritën dhe u entuziazmuan. Dhe e dini çfarë ndodhi? Dhurata më në fund erdhi! Mund **të besojmë** gjithmonë se Fjala e Perëndisë është e vërtetë!

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të luten kur ka njerëz dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre drejtuese frymërore.*

Zbuloje: *Shkruaj referencën e vargut, Luka 1:1, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 1:1. Mësoju se referenca është "adresa" e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Luka është libri, numri i parë është kapitulli dhe numri i dytë është vargu. Ata që janë për herë të parë, dhe moshat më të vogla mund të kenë nevojë për ndihmë. Nëse nxënësit kanë përparuar, mund të përdoret metoda "Stërvitja me shpata".*

Çfarë është "Stërvitja me shpata?" Si mësues, ti thua: "Biblat lart!" Nxënësit duhet t'i shtrijnë krahët lart me Bibla drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet ta përsërisin pas teje. Pasi të gjithë nxënësit të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: "Nisuni!". Nxënësi i parë që vendos gishtin te vargu, do të marrë një etiketë shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: *Drejtoje gishtin për nga periudha historike te figura që përkon në rreshtin e kronologjisë së Biblës. Thekso se Luka është në Dhiatën e Re.*

Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla: Përpara se të hidhemi në mësimin e ditës, le të mendojmë pak se ku gjendeshim javën e kaluar në Dhiatën e Vjetër dhe ku gjendemi këtë javë në Dhiatën e Re. Si lidhen Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re me njëra-tjetrën? Njerëzit në Dhiatën e Vjetër po prisnin me entuziazëm dhe me **besim** që Shpëtimtari i premtuar po vinte. Edhe Adami dhe Eva, njerëzit e parë, e dinin se një Shpëtimtar po vinte për t'i shpëtuar nga mëkati i tyre. Ata **besonin** se ajo që Perëndia tha, ishte e vërtetë. Sot do të lexojmë për një premtim që u dha në Dhiatën e Vjetër dhe u përmbush në Dhiatën e Re.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 1

Prezantim me Lukën

Parafrazim i Luka 1:1-4:

Gjejeni se kush e shkroi librin e Lukës... (Luka). Luka ishte një doktor që besonte se Jezusi ishte Shpëtimtari, dhe ai donte që edhe njerëzit e tjerë të besonin në Jezusin. Prandaj e shkroi librin e Lukës. Le të dëgjojmë se çfarë shkroi Luka për Jezusin.

Zakaria zbulon se do të ketë një djalë

Parafrazim i Luka 1:5-17:

Ishte një prift i quajtur Zakaria, i cili kishte një grua të quajtur Elizabeta. Të dy e donin dhe e ndiqnin Perëndinë. Nuk kishin fëmijë dhe, megjithëse ishin të vjetër, vazhdonin të luteshin për një fëmijë. Kur ishte radha e Zakarias të shërbente në tempull, diçka e mrekullueshme ndodhi! Engjëlli i Perëndisë, Gabrieli, erdhi te Zakaria me një mesazh të veçantë. Mesazhi ishte që ai dhe Elizabeta do të kishin një fëmijë shumë të veçantë, dhe do ta quanin Gjon. Gabrieli tha se Gjoni do t'i përgatiste njerëzit për të shumëpriturin Shpëtimtar. A e dini se kujt po i referohej engjëlli? (Jezusit!) Jezusi po vinte!

Sa të entuziazmuar mendon se ishin njerëzit kur morën vesh se Jezusi po vinte? Mendoni pak se sa të entuziazmuar ishit për dhuratën që mund të fitonit gjatë Kohës së zbulimit. Ata ishin shumë më tepër të entuziazmuar se aq. A e dëgjove se çfarë shkroi Luka? Shpëtimtari i premtuar nuk u shfaq nga hiçi. Perëndia kishte një plan. Ai do të dërgonte Gjonin për të përgatitur rrugën për Jezusin. Dhe çudia më e madhe ishte se Gjoni do të lindte nga dy njerëz shumë të vjetër! Kur ne i besojmë Perëndisë, Ai bën gjëra të mrekullueshme!

A e gjeni dot se çfarë i tha Zakaria engjëllit?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Zakaria vë në dyshim fjalët e engjëllit

Lexo Luka 1:18-20

Përmbledhje: Oh jo! Zakaria nuk i besoi Gabrielit dhe tani nuk do të mund të fliste derisa foshnja të lindte! Çfarë na thotë të bëjmë pjesa 'Mendo si duhet'? Le ta themi tani. Recitoni Fjalët e Urta 3:5-6.

Zakaria nuk mund ta kuptonte se si ai dhe Elizabeta mund të kishin një fëmijë, sepse ishin shumë të vjetër. Ai po mbështetej në të kuptuarit e tij, kur në fakt duhet të besonte në Fjalën e Perëndisë. Perëndia e bën gjithmonë atë që thotë se do të bëjë. A ju kujtohet ndonjë çift tjetër, të cilit Perëndia i tha se do të bëheshin me fëmijë, kur ishin të vjetër? (Abrahami dhe Sara) A ishte Fjala e Perëndisë e vërtetë atëherë? (Po) A do t'i besosh Fjalës së Perëndisë?

Për nxënësit më të rritur: Kjo pjesë e Biblës na ndihmon të kuptojmë rëndësinë e të besuarit tek Ai. A ka raste kur je mbështetur në të kuptuarit tënd, në vend që t'i besoje Fjalës së Perëndisë? A mund të japësh një shembull? Lër kohë për diskutime të shkurtra dhe bëj sugjerime, kur është e nevojshme, p.sh., probleme familjare, sfida në shkollë, një mik që të ka lënduar, sëmundje, humbja e punës së një prindi, shpërngulje, humbja e një kafshe shtëpiake apo humbja e një personi të afërt etj. Pavarësisht çfarë ndodh, ne duhet të drejtohemi te Perëndia për ndihmë dhe pastaj duhet t'i besojmë Atij dhe Fjalës së Tij. Kur po përballesh me një problem, mendo rreth Fjalëve të Urta 3:5-6 dhe kujto se mund ta vendosësh shpresën dhe besimin te Perëndia!

Elizabeta mbetet shtatzënë

Parafrazim i Luka 1:21-25:

Kur Zakaria doli nga tempulli, njerëzit e kuptuan se diçka e rëndësishme kishte ndodhur, për shkak se nuk mund të fliste dhe po u drejtohej atyre me shenja. Zakaria u kthye në shtëpi dhe Elizabeta mbeti shtatzënë. Ishte një mrekulli! Ajo do të kishte një fëmijë, pikërisht siç kishte thënë engjëlli! Fëmija i tyre do të ishte ai që do të përgatiste rrugën për Jezusin!

Maria zbulon se do të lindte një djalë

Parafrazim i Luka 1:26-27:

Pas kësaj, engjëlli Gabriel shkoi te një vajzë e re e quajtur Mari dhe i tha se do të kishte një fëmijë që do të ishte Biri i Perëndisë! Kjo do të ishte një mrekulli, për shkak se fëmija nuk do të kishte një njeri si babain e Tij të vërtetë. Gabrieli i tha Marisë ta quante Birin e saj "Jezus". Gabrieli i tha gjithashtu Marisë se edhe e afërmja e saj Elizabeta do të kishte një fëmijë. Dëgjoni se çfarë tha Maria:

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo Luka 1:38

Përmbledhje: A besoi Maria në Fjalën e Perëndisë që ia tha Gabrieli? (Po)

Maria viziton Elizabetën

Parafrazim i Luka 1:39-56:

Maria shkoi të takonte Elizabetën dhe, sapo e përshëndeti, foshnja e Elizabetës u hodh nga gëzimi. Edhe Elizabeta, edhe foshnja që ende s'kishte lindur, Gjoni, e dinin se Jezusi po vinte! A nuk është entuziazmuese kjo?

A e imagjinon dot të jesh një nga njerëzit që pritën e pritën për të parë e për të takuar Jezusin, Shpëtimtarin e vetëm të vërtetë, të kësaj bote? Kur Perëndia thotë se do ta bëjë diçka, Ai do ta bëjë! Ashtu siç ju i besuat mesazhit në Kohën e zbulimit, ashtu mund të besoni se ajo që Perëndia thotë është e vërtetë.

Gjoni lind

Parafrazim i Luka 1:57-79:

Rreth tre muaj më vonë lindi foshnja e Elizabetës. Kur ajo dhe Zakaria e quajtën Gjon, Zakaria mundi të flasë sërish. Zakaria ishte shumë i lumtur! Ai kishte një djalë dhe e dinte se Shpëtimtari, Jezusi, po vinte për t'i shpëtuar njerëzit nga mëkati i tyre. A i besonte tani Zakaria mesazhit të Perëndisë? (Po!)

Gjoni rritet

Lexo Luka 1:80

Përmbledhje: Gjoni u rrit dhe jetoi në shkretëtirë derisa Perëndia vendosi që ai të kryente punën e Tij të veçantë. Puna ishte të përgatiste njerëzit, sepse Jezusi po vinte! Gjoni u bë i njohur si Gjon Pagëzori, sepse ai pagëzonte njerëzit që pendoheshin, për mëkatet e tyre. Çfarë do të thotë fjala "pendim"? (Të largohesh nga mëkati dhe të pranosh që ke nevojë për Jezusin.) Më pas Gjon Pagëzori pagëzoi edhe Jezusin!

Përfundimi

Perëndia kishte një plan të veçantë dhe dërgoi Fjalën e Tij te Zakaria dhe te Maria përmes engjëllit Gabriel. Gjithçka që Perëndia tha, u përmbush. Zakaria dhe Elizabeta u bënë me një fëmijë edhe pse ishin shumë të vjetër. Javën e ardhshme do të zbulojmë se çfarë ndodhi me Marinë. Kujtoni se çfarë tha engjëlli: "Jezusi po vjen!"

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Perëndia kishte një punë të veçantë për Gjonin. Puna e Gjonit ishte të përgatiste njerëzit, sepse Jezusi po vinte t’i shpëtonte nga mëkati. Perëndia ka një punë të veçantë edhe për ty. Së pari, Ai dëshiron që ti të besosh në Jezusin që të të shpëtojë nga mëkati dhe ta bësh Atë udhëheqësin e jetës tënde. *Shpall Ungjillin përmes “Librit pa fjalë”.* Pasi ta kesh bërë këtë, Ai dëshiron që ti të ndihmosh të tjerët të besojnë në Jezusin gjatë kohëve të mira dhe të këqija në jetën e tyre. A e di përse?

Fjala e Perëndisë na thotë se Jezusi do të kthehet sërish. Një ditë, Ai do të kthehet dhe njerëzit që besojnë në Jezusin do të kenë jetë të përjetshme me Të. Por njerëzit që nuk besojnë tek Ai, do të ndahen nga Perëndia përgjithmonë. A beson se Fjala e Perëndisë është e vërtetë? A beson se Jezusi do të kthehet një ditë, siç na thotë në Fjalën e Tij? Mund të jetë çfarëdo dite, prandaj, le të bëjmë punën që Perëndia dëshiron që ne të bëjmë, dhe t’u tregojmë njerëzve për Jezusin! A je i gëzuar? Nëse nuk ke besuar në Jezusin për shpëtim nga mëkati, a do të doje të besoje sot? Ne do të sigurohemi që të kuptosh se si të besosh tek Ai dhe do të të japim mundësinë ta bësh tani. *Mundësi për të prezantuar qartësisht Ungjillin dhe gjithashtu për t’u dhënë mundësinë të luten për shpëtim.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë i tha engjëlli i Perëndisë, Gabrieli, Zakarias në tempull? (Ai dhe Elizabeta do të kishin një fëmijë dhe do ta quanin Gjon.)
2. A i besoi Zakaria mesazhit të Perëndisë nga Gabrieli? (Jo.)
3. Çfarë i ndodhi Zakarias për shkak se nuk i besoi mesazhit të Perëndisë? (Ai nuk do të mund të fliste derisa të lindte foshnja dhe ta quanin Gjon.)
4. Cila do të ishte puna e Gjonit, kur të rritej? (Të përgatiste njerëzit për Jezusin.)
5. Çfarë i tha Gabrieli Marisë? (Ajo do të lindte Birin e Perëndisë dhe do ta quante Jezus.)
6. A i besoi Maria mesazhit të Perëndisë nga Gabrieli? (Po.)
7. Çfarë bëri foshnja në barkun e Elizabetës, kur Maria e përshëndeti? (U hodh nga gëzimi në barkun e Elizabetës.)
8. Përse u hodh nga gëzimi Gjoni në barkun e Elizabetës? (Sepse Jezusi po vinte!)
9. A u përmbushën premtimet e Perëndisë ndaj Zakarias, Elizabetës dhe Marisë? (Po.)
10. A mund të besosh ti se Fjala e Perëndisë është e vërtetë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 2
Luka 2:1-20

Kupto si duhet:	Jezusi lind.
Mendo si duhet:	"Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mencurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua." Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë mund tu tregoj të tjerëve se Jezusi lindi për të qenë Shpëtimtari ynë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar kur u tregoj të tjerëve se Jezusi lindi për të qenë Shpëtimtari ynë.

PËRGATITU!

Nëse do të kishe kurën për një virus që ndikon mijëra njerëz, sa i gëzuar do të ishe t'u tregoje të tjerëve për të? Sa e gëzueshme është që mund të ndajmë shpresën e përjetshme që kemi në Jezusin? Le të lutemi që Perëndia të na japë mundësi për t'ia shpallur Ungjillin dikujt këtë javë!

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer, lutu që Perëndia t'i mësojë nxënësit përmes Frymës së Shenjtë, dhe që nxënësit të kuptojnë me të vërtetë nevojën e miqve të tyre për një Shpëtimtar. Mësuesit: Lutuni që Perëndia t'ju japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit.

Lexo: Luka 2:1-20

Kupto si duhet: Jezusi lind.
Pikërisht siç kishte premtuar Perëndia, Zakaria dhe Elizabeta patën një djalë të quajtur Gjon, dhe Maria pati një djalë të quajtur Jezus. Kur Jezusi lindi, Perëndia foli sërish përmes engjëllit të Tij me disa barinj që po ruanin delet në fusha. Ishte lajmi më i mirë i historisë njerëzore: Shpëtimtari i botës kishte lindur në Bethlehem! Kur dëgjuan atë që shpallën engjëjt, barinjtë nxituan të shihnin Shpëtimtarin foshnjë, dhe kur e panë, ua treguan të tjerëve Lajmin e Mirë. Sepse, si mund të mos e tregonin? Ne kemi të njëjtin Lajm të Mirë, ndaj duhet t'u tregojmë të tjerëve se Jezusi lindi për të qenë Shpëtimtari ynë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Përdor figura, kartonë apo letra për të ilustruar mësimin.
2. Për nxënësit më të rritur: Jepu nxënësve një copë letër dhe kërkoju të listojnë gjërat e reja që do të mësojnë sot. Sa më e gjatë lista, aq më shumë mundësi kanë për të fituar një shpërblim. Në fund të mësimit, jepi çdo nxënësi një etiketë të vogël për çdo pikë të listës. Afro disa nga fituesit dhe jepu nga një etiketë shpërblyese ose një shpërblim të vogël.
3. Shpjegoju që Bethlehemi ekziston edhe sot, duke ua treguar në hartë.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Lajm i Mirë

Qëllimi: T'u japim nxënësve mundësinë t'ua shpallin Lajmin e Mirë të Jezusit njerëzve në komunitetin e tyre.

Ide bonus: Vendosni muzikë Krishtlindjeje në sfond gjatë *Kohës së zbulimit.*

Aktiviteti 1: Stacioni i artit ose i plastelinës

Mjetet:

- Kartolina ku shkruhet vargu nga Gjoni 14:6 (burim i printueshëm)
- Krijoni disa kartolina shembuj që do tu japin nxënësve ide për vizatimet
- Lapustila, lapsa dhe/ose bojëra dhjami (crayons)



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Tregoju nxënësve se kanë një mundësi të jashtëzakonshme për t'u treguar ____ (shkruaj numrin e nxënësve në klasën tuaj) njerëzve për Jezusin sot!
2. Ndihmoji nxënësit të krijojnë kartolina që tregojnë kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes. Nxënësit duhet të vizatojnë në faqen e parë dhe të shkruajnë në pjesën e brendshme. Kartolinat do t'u jepen _____ (personave në një azil, policëve, zjarrfikësve, infermierëve, mësuesve, etj.). Kujtoni që, njerëzit që do të marrin këto kartolina do t'i konsiderojnë vërtet të shtrenjta.
3. Inkurajoji nxënësit të marrin kohë dhe të bëjnë më të mirën e tyre!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Stacioni i kutive ose hapësirë e madhe

Mjetet:

- Tabak
- Bojëra dhe penela
- Materiale për pastrim

Planifikim paraprak: krijo një ose më shumë postera apo banderola (ide për të shkruar: "Festojmë Jezusin!" ose "Jezusi është dhurata më e mirë!" ose "Jezusi sjell gëzim të vërtetë!") Duke përdorur një lapustilë bëj disa shkronja të mëdha që mund të mbushen me vizatime brenda tek tabakët (mat vendin ku do vendoset banderola para se ta krijoni). Vizato lehtësisht në ngjyrën që duhet të ketë çdo shkronjë.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Tregoju nxënësve se qëllimi i ditës është t'u tregojmë njerëzve të komunitetit kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes.
2. Nxënësit do të vizatojnë një banderolë që do të varet në dritaret e kishës, që njerëzit ta shohin ndërsa kalojnë, ose do të varet në korridorin brenda kishës.
3. Inkurajoji nxënësit të jenë të përqendruar. Kujtoju se ata po pikturojnë banderolat për të treguar kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes.

Ide alternative: Krijoni postera të vegjël dhe varini në muret e kishës, në dritaret e kishës, ose nxënësit mund t'i marrin me vete dhe t'i vendosin në shtëpi.

Këshillë për Kohën e zbulimit: Çelësi për ta bërë të suksesshme KZ-në është t'i lësh me frymën pezull në fillim. Nëse i lejon nxënësit ta hanë pudingun që në fillim, do të humbasësh aspektin edukativ të kësaj përvoje.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Sa e rëndësishme është t'u tregojmë të tjerëve për Jezusin? A mendon se ka njerëz në komunitetin tonë që nuk e dinë të vërtetën për Jezusin? Bëj një pyetësor me klasën: duart lart – jo të gjithë e dinë; duart ngritur deri te mesi – nuk jam i sigurt; duart poshtë – të gjithë e dinë. Përse është kaq e rëndësishme që të tjerët të njohin Jezusin? Si do të ishte jeta pa Jezusin? Nuk do të kishim një Shpëtimtar që të na falë mëkatet; do të na duhej të paguanim vetë për mëkatin tonë. Nuk do të mund të shkonim te Perëndia në çdo kohë, duke ditur se kemi marrë falje. Nuk do ta kishim pranë nesh në kohë të vështira për të na dhënë shpresë. Prandaj duhet të festojmë për Jezusin dhe t'u tregojmë të tjerëve për Të!

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Në bazë të aktivitetit të KZ-së:
A.1: Sot, gjatë KZ-së, keni treguar kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes duke bërë kartolina për të tjerët. A të kujtohet se çfarë shkruhej te kartolinat? (Gjoni 14:6 – Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta, askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.")
A.2: Sot, gjatë KZ-së, pikturuat një banderolë gjigante që do ta shohin shumë njerëz. A ju kujtohet çfarë keni shkruar? (teksti nga banderola)

Sot, gjatë mësimit, ne do të dëgjojmë për disa njerëz që panë foshnjën Jezus dhe ua treguan lajmin të tjerëve.

Lutu: Mendo pak se si do të ishte ta shihnim Perëndinë përballë. A do të ishte nder? A do t'ia mbathje apo do ta falënderoje për atë që ka bërë për ty? Kur ne lutemi, jemi duke folur me Perëndinë. Ai na sheh. Ai na dëgjon. Kur lutemi së bashku, ne zgjedhim një person të dalë përpara Perëndisë dhe të flasë në emër të të gjithëve. Ata që nuk po luten me zë të lartë duhet të dëgjojnë dhe të bien dakord në mendjen e tyre me personin që po lutet. Kush do të donte ta drejtonte klasën në lutje sot?

Zbuloje: Pyeti nxënësit nëse Luka gjendet në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. (DH.R.) Shkruaj Luka 2:1 në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat tek ai varg. Mësoju se referenca është "adresa" e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Luka është libri, numri i parë, 2, është kapitulli dhe numri i dytë, 1, është vargu. Nxënësit më të vegjël dhe ata për herë të parë mund të kenë nevojë për ndihmë. Nxënësit që kanë përparuar më shumë mund të përdorin metodën "Stërvitje me shpata".

Kronologjia: *drejtoje gishtin te periudha biblike.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam sesi Zakaria dhe Elizabeta, madje edhe foshnja e tyre që ende s'kish lindur, Gjoni, e dinin se Jezusi po vinte. Mamaja e Jezusit, Maria, e dinte gjithashtu se Ai po vinte. A e dini se kush tjetër e dinte? Bashkëshorti i ardhshëm i Marisë, Jozefi. Engjëlli i Perëndisë i tha Jozefit se Maria do të kishte një djalë, dhe Jozefi duhet ta quante Jezus, sepse Ai do të shpëtonte popullin e Tij nga mëkatet e tyre. Perëndia do të ishte babai i vërtetë i Jezusit, por Jozefi do të ishte babai tokësor i Tij. Jozefi dhe Maria jetonin në një vend të quajtur Nazaret. Le të zbulojmë se çfarë u ndodhi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Luka 2:1-20

Bëhet censusi

Parafrazim i Luka 2:1-3:

Vendi i Izraelit ishte pushtuar nga drejtuesit romakë. Perandori romak ishte Cezar Augusti. Ai ishte në njëfarë mënyre mbreti i tyre. Ai i urdhëroi të gjithë në Izrael të ktheheshin në vendin e tyre që të numëroheshin dhe të regjistroheshin për t'i paguar taksa perandorisë romake. Ky quhet census.

Jozefi dhe Maria shkojnë në Bethlehem

Lexo Luka 2:4

Trego te Kronologjia ndërsa jep informacionin e mëposhtëm.

Përmbledhje: Maria ishte gati të lindte foshnjën e saj, Shpëtimtarin e botës, i cili do t'u jepte jetën e përjetshme atyre që do të besonin në Të. (Veprat 16:31) Për shkak të censusit, Maria dhe Jozefi duhej të shkonin në Bethlehem. Kjo është e mrekullueshme. Përse? Rreth 700 vite para se Jezusi të lindte, profeti Mikea kishte thënë se Shpëtimtari do të lindte në Bethlehem. (Mikea 5:2) Bethlehemi njihej gjithashtu si qyteti i Davidit. A ju kujtohet kush ishte Davidi? Ai ishte mbreti i dytë i Izraelit. Ai ishte djali që vrau gjigantin, Goliathin. Vendi i mbretit David ishte Bethlehemi. Rreth 1 000 vite para se Jezusi të lindte, Perëndia i tha Davidit se Shpëtimtari do të vinte nga familja e tij. Jozefi dhe Maria ishin të dy nga familja e mbretit David. Prandaj iu desh të shkonin në Bethlehem, në qytetin e Davidit, për censusin. Tani, pikërisht siç kishte thënë Perëndia, Jezusi do të lindte në familjen e mbretit David në qytetin e Bethlehemit! Perëndia bën gjithmonë atë që ka thënë se do të bëjë! Le të shohim se çfarë ndodhi kur Jozefi dhe Maria shkuan në Bethlehem.

Jezusi lind

Lexo Luka 2:5-7

Përmbledhje: Nuk kishte vend për Marinë dhe Jozefin në fjetore. Vendi i vetëm ku Jozefi dhe Maria mund të kalonin natën ishte një strehë ku mbaheshin kafshët. Aty lindi Jezusi – në vendin ku jetonin kafshët! Maria e mbështolli Jezusin me pelena dhe e vendosi në grazhd. Grazhdi është një kazan ushqimi për kafshët. Kazani i ushqimit të kafshëve nuk është vend për një foshnjë, apo jo? Por, në një minutë, do të zbulosh se si Perëndia e përdori këtë si shenjë! Le të vazhdojmë të lexojmë!

Engjëlli i Perëndisë u tregon barinjve për Jezusin

Lexo Luka 2:8-12

Përmbledhje: Engjëlli u tregoi barinjve Lajmin e Mirë! Ishte Lajmi më i mirë në botë! Shpëtimtari i botës kishte lindur. Ai është i vetmi që mund t'u japë jetë të

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

përjetshme njerëzve që besojnë në Të. Pa prit pak! Çfarë do të thotë jetë e përjetshme, dhe përse është Jezusi rruga e vetme për të marrë jetën e përjetshme? *Përsërit Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë".* Engjëlli u dha barinjve një shenjë, për të dalluar se cili ishte fëmija: ai ishte i mbështjellë me pelena dhe qëndronte në një grazhd! Pastaj...

Engjëjt lavdërojnë Perëndinë

Lexo Luka 2:13-14

Përmbledhje: Një numër i madh engjëjsh lavdëruan Perëndinë për shkak se Ai i deshi kaq shumë njerëzit sa dërgoi Birin e Tij të Vetëm për të qenë Shpëtimtari ynë. Le të zbulojmë se çfarë bënë barinjtë pasi dëgjuan këtë Lajm të Mirë!

Barinjtë shohin Jezusin dhe u tregojnë të tjerëve për Të

Lexo Luka 2:15-20

Përmbledhje: A gëzoheni kur dëgjoni për Jezusin dhe se si Ai është Shpëtimtari i botës? Dua të them, mendojeni mirë... lindja e Tij ishte gjëja më e jashtëzakonshme në botë! Sa i guximshëm je t'u tregosh të tjerëve për Jezusin? Apo ndoshta mësimi i sotëm është thjesht një histori për ty – diçka që e lidh me periudhën e Krishtlindjes, por që nuk ka shumë kuptim?

Nëse je i krishterë, duhet të të gëzojë shumë! Kjo është periudha ku festojmë për Shpëtimtarin tonë! Javën e ardhshme do të festojmë lindjen e Jezusit. Do të doja t'ju sfidoja të sillnit një mik. Përse? Që të dëgjojnë Lajmin e Mirë për Jezusin!

Përfundimi

Informacioni që engjëlli i Perëndisë u kishte dhënë barinjve ishte i vërtetë. Në një grazhd qëndronte i mbështjellë me pelena një foshnjë. Barinjtë shkuan ta shihnin dhe pastaj ua treguan të tjerëve Lajmin e Mirë se ky fëmijë ishte Shpëtimtari.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A e ke dëgjuar Lajmin e Mirë se Perëndia të deshi aq sa dërgoi Birin e Tij, Jezusin, për të qenë Shpëtimtari yt? Përsërit Ungjillin përmes "Librit pa fjalë". A ndien që Perëndia të do dhe a je mirënjohës që Ai e bëri këtë për ty? A ke besuar në Jezusin për faljen e mëkateve? A e ke bërë Atë udhëheqësin e jetës tënde? Nëse po, a ua tregon të tjerëve Lajmin e Mirë? Le ta themi bashkë vargun nga Gjoni 3:16 për të kujtuar saktësisht se çfarë ka bërë Ai për ne. Recitoni Gjonin 3:16. A dëshiron dikush t'i kërkojë Jezusit të bëhet Shpëtimtari i tij? Nëse po, le të flasim më tepër. Merri këta nxënës mënjanë dhe përsërisni "Librin pa fjalë" ose fletushkën "E beson apo jo". Nëse vërtet e kuptojnë dhe duan të marrin një vendim për t'i besuar Krishtit si Shpëtimtarin e tyre, jepu mundësinë të luten për shpëtim.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Përse shkuan në Betlhehem Jozefi dhe Maria? (Për censusin)
2. Ku tha profeti Mikea se do të lindte Shpëtimtari? (Bethlehem)
3. Çfarë ndodhi me Marinë pasi mbërritën në Bethlehem? (Lindi foshnja)
4. Si u kujdes Maria për Jezusin pasi Ai lindi? (Ajo e mbështolli me pelena dhe e shtriu në një grazhd)
5. Përse iu desh ta vendoste Jezusin në një grazhd? (Sepse hani nuk kishte vend për ta)
6. Kujt u tregoi engjëlli i Perëndisë se kishte lindur Shpëtimtari? (Barinjve në fushë)
7. Çfarë shenje u dha Perëndia barinjve që të mund të gjenin Shpëtimtarin e porsalindur? (Do ta gjenin të mbështjellë me pelena, të shtrirë në një grazhd)
8. Çfarë bënë barinjtë pasi gjetën foshnjën Jezus, Shpëtimtarin? (Ata u treguan të tjerëve për Të)
9. Përse e dërgoi Perëndia Birin e Tij, Jezusin, që të lindte në tokë? (Për të qenë Shpëtimtari që jep jetën e përjetshme për ata që besojnë në Të)
10. A ndihesh i lumtur që mund t'u tregosh të tjerëve për Jezusin?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 3

Kupto si duhet:	Festojmë për Jezusin!
Mendo si duhet:	"Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme." Gjon 3:16 (12 Vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të festoj ditëlindjen e Jezusit.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar ndërsa festoj ditëlindjen e Jezusit.

PËRGATITU!

Këtë javë do të festojmë për Jezusin! Ndërsa përgatitemi për të festuar me nxënësit, le të ndalemi pak për të reflektur mbi vargun nga 'Mendo si duhet': Gjoni 3:16. Kur Perëndia dha Birin e Tij të vetëm, Ai po na jepte dhuratën më të madhe. Jezusi është arsyeja që mund të mbushemi me shpresë, gëzim dhe paqe ketë periudhë Krishtlindjeje.

Lutu: Lutu që nxënësit të jenë të guximshëm dhe të ftojnë miqtë e tyre në mësimin e kësaj jave, dhe lutu që kuptimi i vërtetë i Krishtlindjes të shpallet, që ta dëgjojnë të gjithë nxënësit, si dhe ata që vijnë për herë të parë.

Kupto si duhet: Festojmë për Jezusin!

BËHU GATI! (për të gjithë drejtuesit)

Ideja bazë: Nxënësit do të kalojnë nëpër tre stacione dhe në fund do të kthehen te klasa për tortën ose për të ngrënë diçka. Nxënësit duhet të formojnë tre grupe. Secili grup duhet të nisë në një stacion të ndryshëm dhe pastaj rrotullohen.



- **Stacioni A:** Drama e pyetjeve rrufe të Krishtlindjes: Mësimi i Krishtlindjes do të tregohet përmes një drame argëtuese dhe ndërvepruese. Drama do të zhvillohet në formën e pyetjeve rrufe, ku prezantuesi jep përgjigjen, dhe konkurrentët duhet të gjejnë pyetjen. Mund të gjeni kolona zanore të pyetjeve rrufe, të vendosni disa kuti si podiume për konkurrentët dhe zile si buton. Mund të përdorni edhe një ekran për të shfaqur PowerPoint-in e lojës (burim i printueshëm).
- **Stacioni B:** Dhurata më e madhe: Loja/Aktiviteti i Librit pa Fjalë: Ambienti duhet të mbushet me tullumbace në ngjyrat e Librit pa fjalë.
- **Stacioni C:** Galeria e Artit: kuti të mëdha kartoni të mbuluara me letër të bardhë.
- **Klasa:** Një tortë ditëlindjeje ose gjëra për të ngrënë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Programi:
5 min – një këngë adhurimi dhe përgatitja për të lëvizur
15 min – mbërritja dhe aktiviteti në stacionin e parë
15 min – mbërritja dhe aktiviteti në stacionin e dytë
15 min – mbërritja dhe aktiviteti në stacionin e tretë
15 min – mbërritja te ambienti i përbashkët
Përfundimi

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca. Shënim: Për shkak të festës "Gëzuar ditëlindjen, Jezus!", sot do të këndohet vetëm një këngë.

Koha e zbulimit

Shënim: Nuk do të ketë Kohë zbulimi këtë javë për shkak të festës "Gëzuar ditëlindjen Jezus".

Festa "Gëzuar ditëlindjen, Jezus!"

Stacioni A: Drama e pyetjeve rrufe të Krishtlindjes

Prezantuesi: Mirë se vini në garë! Do të zbulojmë nëse konkurrentët e sotëm e njohin vërtet kuptimin e Krishtlindjes!
Garuesit 1. 2 dhe 3: *Nxitojnë pranë podiumeve; paraprakisht duhen shkruar emrat e tyre tek podiumet.*

Prezantuesi: Mirë se erdhët! Sot kemi 3 konkurrentë: Koha, Kristi dhe Lindi. Emra të çuditshëm, por i përshtaten rastit shumë mirë. *Konkurrentët duhet të jenë të habitur.* Le të fillojmë... këto janë kategoritë: dhurata, njerëz, e kuqe dhe e vërtetë.
Kristi: Unë zgjedh kategorinë "Njerëz" për 100 pikë.
Prezantuesi: Ky person është arsyeja përse festojmë Krishtlindjen!
Lindi: Kush është Babagjyshi?
Prezantuesi: E pasaktë.
Kristi: Kush është Jezusi?
Prezantuesi: E saktë.
Kristi: Zgjedh kategorinë "Njerëz" për 200 pikë.
Prezantuesi: Ky person është Biri i Perëndisë.
Koha: Kush janë elfët e vegjël?
Prezantuesi: E pasaktë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kristi: Kush është Jezusi?
Prezantuesi: E saktë!
Kristi: Zgjedh kategorinë "Njerëz" për 300 pikë.
Prezantuesi: Ky person ishte nëna e Jezusit.
Lindi: Kjo është shumë e thjeshtë... Kush është Maria?
Prezantuesi: E saktë.
Lindi: Zgjedh kategorinë "dhurata" për 100 pikë.
Prezantuesi: Është dhurata më e çmuar që njeriu mund të marrë.
Koha: Çfarë është një Xbox seria X? Hidhet përreth dhe gëzon.
Prezantuesi: E pasaktë! E po, koha mbaroi. Duhet të bëjmë raundin e fundit. Do t'ju jap një ndihmë të fundit dhe duhet të shkruani pyetjen. Ja ndihma: Ai ishte një dhuratë për ne, që ne të shpëtonim nga mëkati dhe të merrnim shpresë për këtë jetë dhe jetë të përjetshme me Të.
Fillon muzika. Hej nxënës... po ju çfarë do të thonit? *Përfundon muzika.* Koha, cila është përgjigjja jote?
Koha: Ahhh... nuk e di!
Prezantuesi: Më vjen shumë keq, Koha. Padyshim që është përgjigje e gabuar. Sa ke rrezikuar? - 300. Më vjen keq. - Lindi, cila është përgjigjja jote?
Lindi: Përse donte ta eksploronte Jezusi planetin Tokë?
Prezantuesi: Më vjen keq Lindi, por edhe kjo përgjigje është e pasaktë. Sa rrezikove ti? - 500. - Ohhh, më vjen shumë keq! Krist, shpresoj të shkojë më mirë për ty sesa për dy të tjerët. Cila është përgjigjja jote?
Kristi: Cila është arsyeja që Perëndia dërgoi Jezusin si foshnjë në tokë?
Prezantuesi: Përgjigje e saktë! Krist, kjo ishte e shkëlqyer! Sa ke rrezikuar? - 2 000. Uau, paske qenë i sigurt se ishte përgjigje e saktë!
Kristi: E po, ndërsa shihja edhe kategoritë e tjera, lidhja u bë e qartë. Jezusi është Biri i përsosur i Perëndisë dhe Ai është "dhurata" e Perëndisë për ne. Kategoria "e kuqe" më kujtoi se Jezusi u rrit dhe zgjodhi të vdiste për mëkatin tonë. E gjitha kjo është "e vërteta", sepse gjendet në Bibël. Besoj se pyetja që kam për ju është: A e besoni vërtet këtë..., apo jo?
Prezantuesi: Kaq kishim për kohën tonë sot. Shihemi javën e ardhshme! *Prezantuesi dhe konkurrentët duhet të largohen.*

<u>**Stacioni B:** Dhurata më e madhe: Loja/aktiviteti i "Librit pa fjalë"</u>



Alternativa 1: Hapësirë e madhe me tavolina
Mjetet:

- Mjete për bërë një ose më shumë punime të "Librit pa fjalë"
- Fletushkat 'E beson apo jo' (nga një për çdo nxënës)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Nxënësit mund të zgjedhin të bëjnë një punim me ngjyrat e “Librit pa fjalë”. Projekti mund të jetë një byzylyk, varëse apo zbukurim për pemën e Krishtlindjes. Jepi secilit nxënës një fletushkë “E beson apo jo” që ta marrin me vete në shtëpi bashkë me punimin.

Alternativa 2: Hapësirë e madhe
Mjetet:

- Pesë kartona të mëdhenj – secili në një nga ngjyrat e “Librit pa fjalë”, të shpërndarë nëpër dhomë
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime:

1. Nxënësit mblidhen të gjithë në qendër të dhomës.
2. Përsërit me nxënësit fjalët kyç dhe vargjet kyç që lidhen me secilën ngjyrë.
3. Thuaju nxënësve se ti do të përmendësh një varg, referencë ose fjalë kyç dhe ata duhet të vrapojnë drejt ngjyrës së duhur. Dy personat që arrijnë të fundit, eleminohen.
4. Përsëriteni derisa të mbetet vetëm një nxënës.
5. Shpërbleje nxënësin që fiton me dhjetë etiketa shpërblyese.
6. Përsëriteni nëse keni kohë.

Stacioni C: Galeria e artit

Mjetet:

- Kuti të mëdha kartoni
- Tabak të bardhë ose bojë e bardhë
- Lapustila me ngjyra

Planifikimi paraprak: Për të bërë një galeri arti, mblidhni kuti të mëdha kartoni dhe mbulojini me letër të bardhë ose ngjyrosini me bojë të bardhë.

Udhëzime:

1. Thuaj: Çfarë do të vizatonit apo shkruanit në një kartolinë për Jezusin? Kjo është mundësia juaj t’i shkruani apo vizatoni Atij diçka në galerinë e artit.
2. Jepu nxënësve lapustila me ngjyra dhe kërkoju të shkruajnë vargun e tyre të parapëlqyer që lidhet me Krishtlindjen, të vizatojnë diçka që për ta prezanton kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes ose të shkruajnë një shënim falënderues ndaj Jezusit.
3. Caktojeni galerinë e artit në një vend në kishë, ku edhe të tjerët mund ta shohin.

Klasa

Nxënësit kthehen te klasa e tyre për tortën ose për të ngrënë diçka tjetër.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 4
Luka 2:21-40

Kupto si duhet:	Maria dhe Jozefi prezantojnë Jezusin në tempull.
Mendo si duhet:	"Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin." 1 e Korintasve 15:58 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do ta pres me durim Perëndinë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem në paqe ndërsa pres me durim Perëndinë.

PËRGATITU!

Kur i ke kërkuar diçka Perëndisë, me sa durim e pret përgjigjen? Mund të jetë sfiduese të presësh me durim! Shpeshherë tundohemi të nxitojmë ose të krijojmë përgjigjet tona. Këtë javë, përmes jetës së Anës dhe Simeonit, do të mësojmë vlerën e të priturit me durim. Kur e presim me durim Perëndinë, mund të përjetojmë paqen e Tij të përsosur në jetët tona.

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer, lutu për çdo nxënës. Lutu që ata të jenë të sigurt frymërisht, emocionalisht dhe fizikisht këtë vit. Lutu gjithashtu që të jenë të ndjeshëm ndaj drejtimit të Frymës në jetën e tyre dhe të presin me durim Perëndinë.

Lexo: Luka 2:21-40

Kupto si duhet: Maria dhe Jozefi prezantojnë Jezusin në tempull
Pasi lindi Jezusi, Maria dhe burri i saj, Jozefi, bënë atë që thoshte Ligji i Perëndisë. E rrethprenë Jezusin në ditën e tetë dhe më vonë e prezantuan të sapolindurin, Birin e Perëndisë, në tempullin e Jerusalemit. Në tempull ata patën dy takime të mrekullueshme. I pari ishte një njeri i quajtur Simeon, i cili kishte pritur me durim të shihte Shpëtimtarin para se të vdiste. Takimi i dytë ishte një profeteshë e vjetër e quajtur Ana, e cila e njohu foshnjën Jezus si Shpëtimtarin. Siç mund ta shohim, Perëndisa shpërbleu durimin e tyre dhe nga ata mësojmë të presim me durim Perëndinë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Vizato paraprakisht një rrjetë me katrorë në tabelë. Ndërsa shpjegon, shkruaj emrat ose vendos fotot e njerëzve në këtë mësim te kolona e parë, në kolonën tjetër vendos atë që ata po prisnin dhe në kolonën e fundit vendos kur e panë përmbushjen. Thekso që Perëndia vepron në kohën e Tij, dhe ne duhet ta presim me durim.
2. Bëje situatën pak më teatrale duke sjellë kostume dhe një kukull. Shndërroje klasën në tempull për ta sjellë mësimin në jetë.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi


Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Prit me durim…

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të jenë të duruar ndërsa punojnë me një galeri arti njerëzor.

<u>Aktiviteti për të gjithë:</u> Hapësirë e madhe

Mjetet:



- Letra shumëngjyrëshe (nga një letër për çdo nxënës)
- Copëza të imëta letrash shumëngjyrëshe (ang: confetti)
- Kamera
- Shkallë
- Konë
- Një foto në formë kornize ku në fund ka të shkruar vargun nga 1 e Korintasve 15:58 (burim I printueshëm)

Udhëzime për ambientin: Përdori konët për të krijuar kornizën që nxënësit të dinë sa hapësirë kanë për t'u shpërndarë pa dalë nga kamera. Vendos kufij që numrat të kenë përmasa të njëjta.



 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Nxënësit do të punojnë së bashku për të formuar numrin e Vitit të ri me trupat e tyre. (Shënim: për grupe më të vogla, nxënësit mund të shtrihen për t'i formuar numrat, ndërsa për grupet më të mëdha ata mund të ulen këmbëkryq.) Kujtoju nxënësve të bashkëpunojnë me durim për të formuar numrin. Secili prej tyre do të mbajë në duar një letër me ngjyrë.
2. Pasi të gjithë të jenë në vendet e tyre, bëj një foto nga lart duke përdorur shkallën. Fotoja duhet të tregojë formën e Vitit të ri. Ndërsa shkrepet fotoja, argëtohuni – kërkoju nxënësve të marrin "poza" të ndryshme ose të bërtasin numrin e vitit të ri) etj. Në foton e fundit, lëshoni copëzat e imëta të letrave shumëngjyrëshe në mënyrë që copëzat të duken në ajër në foto. Thuaju nxënësve të mos i prekin, por të presin me durim që të gjitha të bien në tokë. Alternativë: nxënësit mund t'i marrin copëzat shumëngjyrëshe në shtëpi ose mund të ndihmojnë me pastrimin e tyre. Por, sigurohu që të presin me durim derisa ti të thuash "Nisu!" përpara se t'i prekin.
3. Nëse e lejon koha, pasi të bëhet fotoja, sfidoji nxënësit të ulen dhe të qëndrojnë në heshtje me durim për rreth një minutë, e të mendojnë rreth asaj që mund të ketë përgatitur për ta Perëndia në vitin e ri. Përfundoni me një lutje.
4. Nëse është e mundur, printojini fotot dhe jepuani nxënësve.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Bëtë një punë të shkëlqyer duke bashkëpunuar me durim për të formuar numrin 2024! Pasi bëmë foton, u sfiduat të mendonit pak se çfarë mund të ketë përgatitur Perëndia për këtë vit. Çfarë menduat? A menduat për diçka që ju entuziazmoi? Po sikur Jezusi të kthehet këtë vit? Të menduarit për këtë është entuziazmuese. Mezi pres ta shoh Jezusin përballë... çfarë dite e mrekullueshme do të jetë! Fjala e Perëndisë thotë se Ai do të kthehet dhe Fjala e Perëndisë është e besueshme. Prandaj mund ta presim me durim ardhjen e Tij. E njëjta gjë është e vërtetë për njerëzit në mësimin e sotëm biblik.

Lutu: *Kërkoji njërit nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Nxite t'i kërkojë Perëndisë t'i ndihmojë të mësojnë nga mësimi biblik dhe të luten për një nga vendet që kanë studiuar në "Stacionin e misionit".*

Zbuloje: Shkruaj referencën e vargut, Luka 2:21, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 2:21. Ndihmo ata që janë të rinj për ta gjetur dhe inkurajoji se do t'i ndihmosh derisa të ndihen të sigurt se mund ta gjejnë vetë.

Kronologjia: *Drejtoje gishtin te periudha biblike.*

Prezantim me mësimin nga Bibla: Mendoje pak, Jezusi – Shpëtimtari i botës – më në fund lindi! Shumë njerëz që besuan në Perëndinë e kishin pritur prej shumë kohësh, dhe ja ku ishte – thjesht një foshnjë! Le të zbulojmë se çfarë ndodhi pasi Ai lindi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Luka 2:21-40

Jozefi dhe Maria i binden Ligjit të Perëndisë

Parafrazim i Luka 2:21-24:

Pasi lindi foshnja e tyre, Jozefi dhe Maria iu bindën Perëndisë duke e quajtur atë Jezus. Ata iu bindën të gjitha ligjeve të veçanta që Perëndia kishte bërë për izraelitët kur lindi i parëlinduri i tyre. Një nga këto ligje thoshte se Jozefi dhe Maria duhet ta çonin foshnjën në tempullin e Jerusalemit dhe t'ia prezantonin Perëndisë. Diçka e mrekullueshme ndodhi kur ata mbërritën atje.

Simeoni pret me durim që Perëndia të dërgojë Jezusin

Lexo Luka 2:25-26

Përmbledhje: Simeoni e donte dhe e ndiqte Perëndinë. Ai e dinte nga Dhiata e Vjetër se Perëndia do të dërgonte një Shpëtimtar. Fryma e Shenjtë e Perëndisë i tha Simeonit se ai do ta shihte Shpëtimtarin para se të vdiste. Prandaj Simeoni priti me durim që Perëndia të bënte atë që kishte thënë se do të bënte.

Le ta mendojmë pak këtë. Ne e dimë se Jezusi do të kthehet një ditë, apo jo? Si e dimë këtë? (Perëndia na e ka thënë në Bibël; Gjoni 14:2-3). Imagjino pak sikur Fryma e Shenjtë e Perëndisë të të tregonte se do të jesh gjallë kur Jezusi të kthehet mbi re dhe do ta shohësh personalisht! A do të gëzoheshe? A do të filloje ta kërkoje Jezusin? A do ta prisje Atë me durim? Unë po!

Cili varg na ndihmon të kujtojmë të presim **me durim** Perëndinë? *Recitoni 1 e Korintasve 15:58.* Simeoni qëndroi dhe priti **me durim** që Perëndia të dërgonte Shpëtimtarin. Ma merr mendja se mezi ka pritur ta shihte Jezusin. Le të shohim se çfarë ndodhi më pas.

Simeoni mban në krahë Jezusin

Lexo Luka 2:27-32

Përmbledhje: Jo vetëm që Simeoni e pa foshnjën Jezus, Shpëtimtarin, por ai e mbajti në krahë! Kur Simeoni lavdëroi Perëndinë, ai i tha çdokujt që dëgjonte se foshnja e vogël që mbante në duar ishte Shpëtimtari i gjithë botës – një Shpëtimtar jo vetëm për izraelitët por për këdo!

Pyes veten se çfarë mund të kenë menduar Jozefi dhe Maria. Le të vazhdojmë leximin.

Jozefi dhe Maria u mahnitën

Lexo Luka 2:33

Përmbledhje: Jozefi dhe Maria kuptuan se edhe njerëzit e tjerë e dinin se foshnja ishte Shpëtimtari i botës! Por Simeoni nuk tha vetëm aq.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Simeoni i jep një profeci Marisë

Parafrazim i Luka 2:34-35:

A ju kujtohet se çfarë është një profeci? (është një mesazh nga Perëndia që na tregon për të ardhmen) Pasi Simeoni lavdëroi Perëndinë që kishte dërguar Shpëtimtarin, ai i tha Marisë një profeci për tre gjëra që do të ndodhnin për shkak të Jezusit.

1. Disa njerëz në Izrael do të besonin në Jezusin, por disa jo. A ndodhi kjo? (Po)
2. Njerëzit do të thoshnin gjëra të këqija për Jezusin që ishin të pavërteta. A ndodhi kjo? (Po)
3. Maria do të trishtohej shumë për diçka që do t'i ndodhte Jezusit. A e mendoni dot se çfarë ishte? (Maria pa që njerëzit e refuzuan Jezusin dhe e kryqëzuan) A ndodhi kjo? (Po)

Perëndia përdori Simeonin në mënyrë shumë të veçantë. A mendoni se Simeoni ishte i lumtur që e kishte pritur me durim Perëndinë? Por prit pak. Edhe dikush tjetër e kishte pritur me durim dërgimin e Shpëtimtarit.

Ana pret me durim që Perëndia të dërgojë Jezusin

Lexo Luka 2:36-38

Përmbledhje: Ana ishte profeteshë, që do të thotë se u tregonte njerëzve atë që Perëndia kishte thënë se do të ndodhte në të ardhmen. Ashtu si Simeoni, ajo e dinte nga Dhiata e Vjetër se Perëndia do të dërgonte një Shpëtimtar. Ajo kaloi pjesën më të madhe të jetës duke agjëruar e duke u lutur në tempull, dhe tani mund të shihte Shpëtimtarin me sytë e saj dhe tu tregonte të tjerëve se kjo foshnjë e vogël ishte Shpëtimtari i botës!

A mendoni se Ana ishte e gëzuar që kishte pritur me durim Perëndinë? Çfarë mendoni se ndodhi me Jezusin pas kësaj?

Jezusi fillon të rritet

Parafrazim i Luka 2:39:

Pas pak kohësh Jozefi dhe Maria u kthyen bashkë me Jezusin në Nazaret.

Lexo Luka 2:40

Përmbledhje: Jezusi u bë më i madh e më i gjatë, siç po rriteni ju, dhe Ai u rrit gjithashtu në mençuri.

Përfundimi

Ndonjëherë duket sikur Perëndia po vonohet shumë për të bërë atë që ka thënë se do të bëjë, por Bibla na thotë te 2 e Pjetrit 3:8 se për Perëndinë një ditë është si një mijë vjet dhe një mijë vjet si një ditë. Perëndia ka kohën e Tij dhe ajo është e përsosur. Simeoni dhe Ana i besuan Perëndisë dhe e pritën Atë me durim. Në kohën e Tij të përsosur, Perëndia dërgoi Jezusin në botë si një foshnjë e vogël për të na shpëtuar nga mëkati.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

A po pret që Perëndia të bëjë diçka? A ka një problem në jetën tënde për të cilin je lutur, por që duket sikur Perëndia nuk të ka dhënë një përgjigje? Ndoshta është një problem në shkollë – me një mësues, një person që të tall apo me një mik që të ka lënduar. Ndoshta është një problem në familje – prindërit debatojnë apo janë divorcuar, dikush është sëmurë ose ka humbur punën. Zakonisht duam që Perëndia të zgjidhë çdo problem që kemi, në mënyrën që ne duam të zgjidhet. Por është e rëndësishme që të kujtojmë se plani i Perëndisë është i përsosur, gjithashtu edhe koha e Tij. Ndërsa presim, Ai po na rrit që të bëhemi më të ngjashëm me Jezusin. Kur e ke të vështirë të presësh, kujto Simeonin dhe Anën. Ata pritën një kohë të gjatë, por Perëndia bëri atë që Ai kishte thënë se do të bënte në kohën e Tij të përsosur. Duke qenë se pritën me durim Perëndinë, e panë Jezusin me sytë e tyre. Kur e mendojmë pritjen me durim si Simeoni dhe Ana, mund të ndiejmë paqen që na jep besimi në Perëndinë. Cili varg nga *Mendo si duhet* na ndihmon të kujtojmë pritjen me durim në Perëndinë? (1 e Korintasve 15:58) Le ta themi tani. *Recitoni 1 e Korintasve 15:58.* A e dini se Bibla na tregon se Jezusi do të kthehet një ditë për të marrë të gjithë ata që besojnë në Të? A po e pret me durim atë ditë? A je gati për të? Si e kupton se je gati? Je gati nëse ke besuar në Jezusin për shpëtimin nga mëkati dhe e ke bërë Atë udhëheqësin e jetës tënde. Nëse nuk e ke bërë këtë, atëherë nuk je gati. Por ne mund të të tregojmë se si ta bësh tani. *Shpallni Ungjillin përmes “Librit pa fjalë” dhe ofroni një ftesë për shpëtim.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Kush priti me durim që Perëndia të dërgonte Shpëtimtarin? (Simeoni dhe Ana)
2. Si e dinin Simeoni dhe Ana që Perëndia do të dërgonte një Shpëtimtar? (Dhiata e Vjetër/Bibla)
3. Çfarë besonte Simeoni se do të ndodhte para se të vdiste? (Ai do të shihte Shpëtimtarin)
4. Çfarë bëri Simeoni me foshnjën Jezus? (E mbajti në krahë)
5. Cilat janë tre gjërat që Simeoni i tha Marisë në profecinë e tij? (1. Disa njerëz në Izrael do të besonin në Jezusin dhe disa jo; 2. Njerëzit do të thoshnin gjëra të këqija për Jezusin që nuk ishin të vërteta; dhe 3. Maria do të trishtohej nga diçka që do t’i ndodhte Jezusit)
6. A u përmbushën të trija pjesët e profecisë së Simeonit? (Po)
7. A u treguan Simeoni dhe Ana të tjerëve për Jezusin Shpëtimtar apo e mbajtën lajmin për vete? (Ata u treguan të tjerëve)
8. Çfarë ndodhi me Jezusin pasi Simeoni dhe Ana e panë? (Maria dhe Jozefi e morën dhe u kthyen në Nazaret, dhe Ai filloi të rritej)
9. A e pret ti me durim Perëndinë?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 5
Luka 2:41-52

Kupto si duhet:	Jezusi mëson në tempull.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht" 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të rritem në urtësi.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i urtë kur afrohem me Perëndinë.

PËRGATITU!

Këtë javë do të studiojmë se si Jezusi mësoi në tempull kur ishte fëmijë dhe u rrit në urtësi. Si mund ta ndjekin nxënësit tanë shembullin e Krishtit dhe të rriten në urtësi? Duke pasur një themel të fortë në Fjalën e Perëndisë. Si udhëheqës, ne luajmë rol të rëndësishëm në hedhjen e këtij themeli! Le të lutemi që do të mund të modelojmë një dashuri të thellë për Fjalën e Perëndisë dhe që, edhe ne gjithashtu, do të rritemi në urtësi të perëndishme.

Lutu: Lutu për bashkëdrejtuesit dhe ata që do të aktrojnë gjatë aktivitetit të KZ-së. Kërkoji Perëndisë të mundësojë kohë për familjet që fëmijët të vijnë këtë javë.

Lexo: Luka 2:41-52

Kupto si duhet: Jezusi mëson në tempull
Edhe pse Perëndia nuk na ka zbuluar shumë nga fëmijëria e Jezusit, Ai na informon për një ngjarje shumë të rëndësishme. Jozefi dhe Maria ishin besnikë në pjesëmarrjen e përvitshme të festës së Pashkës në Jerusalem. Kur Jezusi ishte 12 vjeç qëndroi në tempull pas festës, duke mësuar nga mësuesit e tempullit dhe duke u rritur në urtësi. Megjithëse prindërit e tij u tronditën nga zhdukja e menduar e tij, Ai u siguroi me qetësi se shtëpia e Atit të Tij ishte pikërisht vendi ku duhet të ishte. Fjala e Perëndisë na thotë se Jezusi vazhdoi të rritej në urtësi dhe na thotë të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë. Prandaj duhet t'i përkushtohemi studimit të përditshëm të Fjalës së Perëndisë, që të mund të rritemi në urtësi.

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor: Përkufizimi i urtësisë – përdorimi i Fjalës së Perëndisë për të kuptuar botën dhe për të marrë vendimet e duhura. (Thjeshtimi për nxënësit më të vegjël – përdorimi i asaj që dimë nga Fjala e Perëndisë për të marrë vendimet e duhura.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Për nxënësit më të rritur: Vizato një grafik rritjeje. Ndërsa shpjegon, shëno sesi u rrit Jezusi frymërisht në njërën anë, dhe se si mund të rriten nxënësit frymërisht në anën tjetër.
2. Krijo një hartë të vendeve ku Jezusi dhe prindërit e Tij shkuan gjatë këtij pasazhi nga Shkrimi: Festa e Pashkës, rikthimi i Marisë dhe Jozefit në Nazaret, rikthimi i Jezusit në tempull, etj. Shto hollësira të hartës ndërsa jep mësimin, duke shpjeguar se çfarë po bënin tek secila vendndodhje.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Ta vëmë Biblën në praktikë!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të imagjinojnë sesi ishte jeta për Jezusin si foshnjë.

Këshilla për Kohën e zbulimit:

- Për t'u mundësuar nxënësve përjetimin e plotë të kësaj KZ-je, mund të shkurtohet koha e adhurimit me pesë minuta.
- Drejtuesi i KZ-së i çon nxënësit e vet tek stacioni përkatës kur të bjerë zilja. Duke qenë se ka tre stacione, duhet t'i ndani nxënësit në tre grupe. Secili stacion duhet të zgjasë pesë minuta.
- Aktorët e çdo stacioni do të "luajnë rolin" ndërsa vijnë nxënësit dhe ulen në stacionin e tyre. Aktorët do të vazhdojnë aktrimin dhe do të përfshijnë edhe nxënësit në biseda. Aktorët duhet të jenë përfshirës dhe të guximshëm. Bëj më të mirën për të krijuar një përvojë autentike, duke e bërë Biblën të gjallë për nxënësit.

Stacioni 1: Ku jetoi Jezusi?

Vendndodhja: hapësirë e madhe
Aktorët: burri, gruaja, foshnja, fëmijë i vogël

Mjetet:

- Një shtëpi e thjeshtë e kohëve të Biblës
- Ide për objektet që mund të përdorni: mjete pastrimi, një lojë e thjeshtë, kavanozë, pergamenë, mjete për punimin e drurit, etj.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për aktorët:
1. Ndërsa mbërrijnë nxënësit, mirëpritini në shtëpinë tuaj.
2. Informojini nxënësit se keni një ditë shumë të zënë, prandaj do të punoni e përgatisni ushqimin ndërsa flisni me ta. Biseda duhet të përfshijë sfidat dhe gëzimet e të jetuarit në vitin 5 para Krishtit. Diskutoni se si të përgatisni një vakt, si të lani rrobat, si të rregulloni krevatin, etj.
3. Tregoni se sa e shumë e çmoni kohën në tempull dhe leximin e pergamenëve. Kujtoni, nxënësit do të largohen pas katër minutash, kështu që biseda duhet të jetë e shpejtë.

Stacioni 2: Çfarë gjuhe fliste Jezusi?

Vendndodhja: hapësirë e madhe
Aktorët: një mësues

Mjetet:
- Një tapet i madh (ku të ulen nxënësit dhe të mësojnë)

Udhëzime për aktorin:
1. Mirëpriti nxënësit në klasë dhe shpjegoju se zakonisht vetëm djemtë vijnë në shkollë për të mësuar gjuhën hebraike.
2. Mësoju nxënësve disa fjalë hebraisht.

Stacioni 3: Çfarë ushqimesh hante Jezusi?

Vendndodhja: kuzhinë ose hapësirë e madhe
Aktorët: disa gra të zëna në kuzhinë

Mjetet:
- Tasa të vegjël ose kupa racionesh (nga një për çdo nxënës)
- Lugë plastike (një për çdo nxënës)
- Supë me thjerrëza (pak për çdo nxënës, dhe duhet të jetë gati sapo të vijnë ata)
- Pjata me ushqime për t'i vënë në tavolinë – rrush, ullinj, kastravecë

Udhëzime për aktorët:
1. Mirëpritini nxënësit në kuzhinë me një tas të vogël me thjerrëza.
2. Tregojuani nxënësve thjerrëzat dhe shpjegoni se si përgatiten. Jepini çdo nxënësi pak për t'i provuar dhe pyetini se si iu dukën.
3. Tregojini nxënësve një pjatë me ushqim, që ishte e zakonshme për Jezusin ndërsa rritej.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: A nuk është argëtuese të imagjinosh se si ka qenë jeta kur Jezusi ishte thjesht djalosh, para 2000 vitesh? Disa gjëra ishin shumë ndryshe – nuk kishte televizor, kompjutera apo telefona. Flisnin një gjuhë ndryshe nga e jona. Por, disa gjëra ishin të ngjashme. Njerëzit punonin, hanin dhe pastronin shtëpitë e tyre. Fëmijëve u pëlqente të luanin. Familjet hebreje shkonin në sinagogë dhe tempull, pak a shumë siç shkojmë ne në kishë. Ama, diçka ishte shumë shumë ndryshe te Jezusi kur ishte djalosh. Ai nuk ishte thjesht një djalosh; Ai ishte Biri i Perëndisë! Në mësimin e sotëm do të shohim sesi ndonjëherë prindërit e Tij e kishin të vështirë ta kuptonin dhe ta kujtonin atë fakt.

Lutu: Përse duhet të lutemi përpara se të fillojmë mësimin? Ne po mësojmë nga Bibla, Fjala e Perëndisë. Ne kemi nevojë për ndihmën e Perëndisë që ta kuptojmë. Ne kemi nevojë për ndihmën e Tij që të bindemi për mëkat dhe të pendohemi, që të mund ta nderojmë Perëndinë me jetën tonë. Inkurajo një nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje.

Zbuloje: Shkruaj referencën e vargut, Luka 2:41, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 2:41. Mësoju se referenca është "adresa" e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Luka është libri, numri i parë, 2, është kapitulli dhe numri i dytë, 41, është vargu. Nxënësit më të vegjël ose ata për herë të parë mund të kenë nevojë për ndihmë. Nëse nxënësit kanë përparuar mund të përdoret metoda "Stërvitja me shpata".

Kronologjia: *drejtoje gishtin te periudha biblike dhe* përsërisni mësimet që keni marrë deri në atë pikë.

Prezantim me mësimin nga Bibla: Pasi Jezusi lindi, Jozefi dhe Maria e morën në Nazaret, në Galile, ku jetuan. Nazareti është vendi ku Jezusi u rrit. Bibla nuk na tregon shumë për fëmijërinë e Jezusit, por na tregon këtë: "Jezusi rritej në urtësi dhe në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve." Luka na tregon gjithashtu për diçka që ndodhi kur Jezusi ishte dymbëdhjetë vjeç.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 2:41-52

<u>Familja e Jozefit dhe Marisë shkojnë në festën e Pashkës në Jerusalem</u>

Lexo Luka 2:41-42 (shpjego që Ai dhe Atij i referohet Jezusit)

Përmbledhje: A e dini/kujtoni se përse e kishin festën e Pashkës judenjtë?

Thekso informacionin e mëposhtëm në kronologjinë e Biblës: Shumë kohë më parë, kur izraelitët ishin skllevër në Egjipt, Perëndia donte që faraoni t'i çlironte. Kur faraoni nuk i çliroi izraelitët, Perëndia dërgoi dhjetë plagët. Plaga e dhjetë ishte e tmerrshme – vriste djemtë e parëlindur. Por Perëndia u tha izraelitëve të vendosnin gjakun e qengjave në shtalkat e dyerve që të mos vdisnin të

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

parëlindurit e tyre. Faraoni më në fund i la izraelitët të lirë. Perëndia ndau Detin e Kuq, kështu izraelitët ia mbathën në tokë të thatë. Çdo vit judenjtë (izraelitët) shkonin në Jerusalem për të festuar që Perëndia i kishte shpëtuar nga engjëlli i vdekjes dhe nga skllavëria e Egjiptit.

Pasi Jozefi dhe Maria shkuan në festën e Pashkës, diçka e frikshme ndodhi në rrugën e kthimit për në Nazaret.

Jezusi ka humbur

Lexo Luka 2:43-46

Përmbledhje: Oh, jo! Në vend që të kthehej në Nazaret me prindërit e tij, Jezusi kishte qëndruar në Jerusalem! Jozefi dhe Maria kërkuan thuajse kudo për Jezusin. Mendoni pak sa të frikësuar duhet të kenë qenë.

A ka ndodhur ndonjëherë që prindërit e tu nuk e kanë ditur ku ke qenë? A janë trembur? *Jepu mundësinë të ndajnë shkurtimisht.*

Pas tri ditësh, Jozefi dhe Maria më në fund gjejnë Jezusin. Ai ishte në tempull. Tempulli ishte si kisha për izraelitët. Ishte vendi ku izraelitët shkonin për të adhuruar Perëndinë dhe për të mësuar për Të. Priftërinjtë dhe mësuesit e Ligjit të Perëndisë ishin atje. Jezusi po dëgjonte mësuesit dhe po u bënte pyetje. Dëgjojeni pak këtë:

Lexo Luka 2:47

Përmbledhje: Si reaguan njerëzit që e njihnin Jezusin? Ata u mahnitën nga të kuptuarit e Tij dhe nga përgjigjet e Tij! Sa vjeç ishte Ai? (vetëm 12 vjeç!) Si mendoni se u ndien Jozefi dhe Maria kur e gjetën Jezusin?

Jozefi dhe Maria mërziten me Jezusin

Lexo Luka 2:48

Përmbledhje: Maria dhe Jozefi u mërzitën me Jezusin – ashtu siç do të mërziteshin prindërit e tu nëse ti do të bëje diçka të tillë! Është shumë e qartë se Maria mendonte që Jezusi kishte bërë diçka të gabuar. Por, a bëri ndonjëherë Jezusi diçka të gabuar? Çfarë dini nga Bibla? A mëkatoi ndonjëherë Jezusi? (Jo! Ai ishte i përsosur dhe nuk mëkatoi kurrë) Dhe kush ishte Jezusi? A ishte një 12 vjeçar i zakonshëm? Apo tek Ai ishte diçka e jashtëzakonshme? Përse ishte i veçantë Jezusi? (Jezusi ishte Biri i Perëndisë!) Kjo do të thotë se Ai nuk ishte thjesht një djalosh, apo thjesht një qenie njerëzore – Ai ishte gjithashtu Perëndia! Perëndia është tre persona në një – kjo quhet Trini. Do të mësojmë më shumë për këtë në mësimet e ardhshme. A e dinin Maria dhe Jozefi se Jezusi ishte Biri i Perëndisë? (Po) A mendoni se mund ta kishin harruar disi sesa i veçantë ishte Jezusi? Le të shohim se si iu përgjigj Jezusi Marisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi rritet në urtësi

Lexo Luka 2:49-50

Përmbledhje: Përse e quante Jezusi tempullin "shtëpia e Atit tim"? Përse gjendej Ai në tempull? Një arsye është se Ai po rritej në urtësi. Ai ishte ulur midis mësuesve, i dëgjonte dhe u bënte pyetje. A e dini se çfarë është urtësia?

Nxënësit më të vegjël: Urtësi është të përdorim atë që dimë nga Fjala e Perëndisë për të marrë vendimet e duhura. Lidhe urtësinë me 4 pikat 'si duhet'. Për të qenë i urtë duhet të "kuptosh" dhe të "mendosh" për Fjalën e Perëndisë, pastaj të "veprosh" si duhet. Kjo është urtësia.

Nxënësit më të rritur: Urtësia është përdorimi i Fjalës së Perëndisë për të kuptuar botën dhe për të marrë vendimet e duhura. Për të qenë i urtë duhet të "kuptosh" dhe të "mendosh" për Fjalën e Perëndisë. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh Perëndinë, veten dhe të tjerët, dhe pastaj mund të "veprosh" si duhet. Kjo është urtësi.

Nëse Jezusi kaloi kohë duke u rritur në urtësi, a nuk duhet ta bësh edhe ti? Cilin varg nga "Mendo si duhet" na kujton kjo? Kërkoju nxënësve të recitojnë 2 e Pjetrit 3:18a.

Mendo për këtë: përse i tha Jezusi prindërve të tij: "A nuk e dinit se më duhet të merrem me punët e Atit tim?" Ai po u kujtonte prindërve se ishte Biri i Perëndisë. Ata duhej ta kishin ditur se i vetmi vend ku mund të ishte, qe shtëpia e Atit të Tij, duke mësuar e duke u rritur në urtësi.

Kush mendoni se gaboi? A gaboi Jezusi që qëndroi në shtëpinë e Atit të Tij duke u rritur në urtësi, apo Jozefi dhe Maria gabuan sepse nuk e kishin kuptuar se ku do të ishte Jezusi? Jozefi dhe Maria gabuan. Jezusi nuk gaboi kurrë. Por Maria dhe Jozefi ende nuk e kuptonin. Gjejeni pak se çfarë bëri Jezusi pas kësaj.

Lexo Luka 2:51-52

Përmbledhje: Jezusi nuk u ndal kurrë së mësuari. Po ti?

Përfundimi

Bibla na tregon se kur Jezusi ishte shumë i ri, si ne, Ai hëngri dhe mësoi. Me shumë mundësi edhe luante, edhe ndihmonte me punët e shtëpisë. Ai gjithashtu kalonte kohë me familjen e Tij, edhe në shtëpinë e Atit të Tij. Ai e bëri prioritet rritjen në urtësi. Nëse Bibla na e tregon këtë ngjarje, do të thotë se është e rëndësishme që ne ta dimë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Atëherë, si rritemi në urtësi? Gjëja e parë që duhet të bëjmë është t’i besojmë Jezusit që të na shpëtojë nga mëkati dhe ta bëjmë Atë udhëheqësin e jetës sonë. Le të sigurohemi që të gjithë e kemi kuptuar se çfarë do të thotë. Kërkoji njërit prej nxënësve të shpëtuar të të ndihmojë me shpalljen e Ungjillit përmes “Librit pa Fjalë” dhe ftoji të tjerët për shpëtim. Nëse Jezusi të ka shpëtuar nga mëkati, atëherë Ai të ka dhënë Frymën e Shenjtë që të ndihmon të rritesh. Cilat janë disa nga gjërat që mund të bëjmë për t’u rritur si të krishterë? Lejoji nxënësit të përgjigjen: leximi i Biblës, lutja, të shkojmë në kishë, adhurimi, shërbimi, shpallja e Ungjillit tek të tjerët, mësimi i vargjeve nga Bibla, bindja ndaj gjërave që thotë Perëndia, koha me të krishterë të tjerë, etj. Nëse i bëjmë këto gjëra mund të ndihemi të urtë, ndërsa rritemi dhe afrohemi me Perëndinë dhe mësojmë se çfarë do Ai që ne të bëjmë!

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Përse shkoi familja e Jezusit në Jerusalem? (Për festën e Pashkës)
2. Sa vjeç ishte Jezusi kur ndodhi kjo? (Dymbëdhjetë vjeç)
3. Çfarë zbuluan Maria dhe Jozefi gjatë kthimit në Nazaret? (Jezusi kishte humbur)
4. Ku e gjetën Jezusin pas tre ditësh Maria dhe Jozefi? (Tek tempulli në Jerusalem)
5. Çfarë po bënte Jezusi në tempull? (Ishte ulur midis mësuesve, duke dëgjuar e duke u bërë pyetje)
6. Si reaguan njerëzit që dëgjonin Jezusin? (Ata u mahnitën nga të kuptuarit e Tij dhe nga përgjigjet e Tij)
7. Si u ndien Maria dhe Jozefi kur e gjetën Jezusin? (Ata u mërzitën me Të)
8. Çfarë tha Jezusi se duhej të kishin ditur prindërit e Tij? (Ai duhej të merrej me punët e Atit të Tij)
9. Shëno gjëra që po bën për t’u rritur në urtësi. (Leximi i Biblës, të shkosh në kishë, lutja, dëgjimi i të krishterëve të tjerë, etj.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 6

Luka 3:21-23a, 4:14-30

Kupto si duhet:	Jezusi pagëzohet dhe refuzohet.
Mendo si duhet:	Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje." Gjoni 14:6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të zgjedh Jezusin si Shpëtimtarin tim.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt kur zgjedh Jezusin si Shpëtimtarin tim.

PËRGATITU!

Gjëja më e rëndësishme në botë është marrëdhënia jonë me Jezu Krishtin. Pasi kemi vendosur të besojmë në Krishtin, Fryma e Shenjtë na mbush, ne fitojmë shpresë që na mban të themeluar në të gjitha rrethanat, dhe mbushemi me gëzim që vetëm Jezusi mund të japë. Çfarë nderi është t'i ndihmojmë nxënësit të mësojnë për Shpëtimtarin tonë!

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer, lutu me fjalët e Fjalëve të Urta 4:20-27 për nxënësit e tu. Kërkoji Perëndisë të veprojë në jetën e tyre në mënyrë të fuqishme këtë javë. Lutu specifikisht për ata që janë për herë të parë, që të dëgjojnë Ungjillin dhe të zgjedhin Jezusin si Shpëtimtarin e tyre.

Lexo: Luka 3:21-23a, 4:14-30

Kupto si duhet: Jezusi pagëzohet dhe refuzohet
Jezusi u rrit dhe erdhi koha e Tij për të filluar shërbesën. Në bindje ndaj Atit të Tij Qiellor, Jezusi shkoi të pagëzohej nga Gjon Pagëzori. Pak kohë pas pagëzimit të Tij dhe tundimit nga Satani në shkretëtirë, Jezusi shkoi të jepte mësim në sinagogë në qytetin e Tij, Nazaret. Përmes mësimit atë ditë, Ai u tha njerëzve në sinagogë se Ai ishte Shpëtimtari që kishin pritur. Por në vend që ta pranonin, ata e refuzuan. Në vend që të zgjidhnin Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, judenjtë në Nazaret e refuzuan dhe u përpoqën ta vrasin. Por, prej atij refuzimi dhe vdekjes së Tij në kryq, secili prej nesh ka mundësinë ta zgjedhë Jezusin si Shpëtimtar.

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:
1. Përdor objekte për ta vënë mësimin në praktikë; siguro një hapësirë që mund të përdoret si shembull për pagëzimin, një pergamenë, tempull, etj.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Përqendrohu në tonin e zërit ndërsa shpjegon mësimin. Pyeti nxënësit se si mund t'i thoshte gjërat Jezusi: me butësi, me zë të lartë, me siguri, etj.
3. Për nxënësit më të rritur: shkruaj "pse" në mes të tabelës. Pas leximit të pjesës nga Shkrimi sfidoji nxënësit të mendojnë se përse ndodhi, përse ishte aq e rëndësishme dhe/ose pse zbatohet në jetën e tyre.
4. Krijo kronologjinë e ngjarjeve në një tavolinë, duke përdorur objekte si: akuarium me ujë, pëllumb, sandale, hartë të Nazaretit, pergamenë, hartë të Kapernaumit dhe një kuti me ilaçe.
5. Për nxënësit më të rritur: duke përdorur një hartë, trego vendndodhjet gjeografike që përmenden në mësim. Nëse është e mundur, printo një hartë të madhe, vare në klasë dhe shëno vendet ku shërbeu Jezusi.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Me cilën skuadër je?

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të zgjedhin, të përkushtohen dhe të jenë të sigurt me skuadrën e tyre.

Shënim për mësuesit kryesorë dhe barinjtë: *Do të jeni kapitenë skuadre gjatë "Kohës së zbulimit" dhe është shumë e rëndësishme të ndërtoni frymën e skuadrës. Kjo do të thotë se duhet të krijoni ndjesinë e të qenët pjesë e skuadrës dhe duhet t'i mbani të përfshirë të gjithë nxënësit. Nëse një nxënës tundohet të ndërrojë skuadër, duhet të jeni të vendosur që t'i tërhiqni përsëri në skuadrën e tyre. Gjithashtu, ju lutem lexoni udhëzimet e "Kohës së zbulimit" me kujdes, që të siguroheni që i dini dhe i kuptoni përgjegjësitë tuaja në aktivitet.*

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:



- Objekte për çdo nxënës që t'i mbajnë dhe të tregojnë qartësisht se cilës skuadre i përkasin (p.sh. byzylykë me ngjyra, shirita me ngjyra që mund t'i lidhin në kokë, jelekë me ngjyra, kapele, syze dielli, etj.)
- Tabakë
- Një listë e pikave "Kupto si duhet" të gjashtë muajve të fundit (burim i printueshëm) dhe/ose disa shembuj
- Lapustila
- Etiketa shpërblyese

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndërsa nxënësit nisin adhurimin, kërkoji secilit të zgjedhë një skuadër dhe jepi objektin dallues të skuadrës. Ndoshta duhet t'i ndihmosh në vendimmarrje që të ndahen në mënyrë të barabartë.
2. Kur skuadrat të arrijnë në stacionin e artit, thuaju: "Sfida juaj është të plotësoni këtë vepër arti nga mësimet biblike që keni studiuar gjatë gjashtë muajve të fundit. Skuadra fituese do të shpallet në bazë të numrit të vizatimeve dhe përpjekjes së skuadrës. Fituesit do të marrin pesë etiketa shpërblyese!"
3. Kërkoju kapitenëve të skuadrave të drejtojnë skuadrën për të gjetur një emër, për t'u lidhur me njëri-tjetrin, për të nxitur skuadrën dhe për t'u dhënë ide se çfarë të vizatojnë, si ta bëjnë dhe t'i inkurajojnë të bashkëpunojnë.
4. Filloni sfidën.
5. Gjatë sfidës, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet t'u kërkosh anëtarëve të skuadrës të ndërrojnë skuadër. Thuaj gjëra si: "Unë mendoj se skuadra tjetër po ia del më mirë, përse nuk ndryshoni skuadër?" ose "Unë mendoj se skuadra tjetër ka lapustila më të mira."
6. Në këtë pikë, kapitenët e skuadrave duhet të thonë me bindje: "Jo... ju jeni në skuadrën tonë. Le të mbetemi të përkushtuar dhe të zgjedhim të vazhdojmë punën së bashku!"
7. Kur të ketë përfunduar koha, ndërsa ti cakton fituesin, kërkoju kapitenëve të mbledhin skuadrën dhe të brohorasin për skuadrën e tyre duke thënë: "Ju zgjodhët këtë skuadër dhe bëtë mirë që qëndruat të përkushtuar ndaj saj! Bravo skuadra!
8. Shpall fituesin, duke marrë parasysh numrin e pikturave dhe përpjekjen që u bë për to. Shpërble me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës fituese.
9. Thuaj: "Jam krenar për ju të gjithë. Ju zgjodhët skuadrën dhe qëndruat të përkushtuar ndaj saj."
10. Kërkoju të dyja skuadrave të brohorasin për skuadrën e vet.

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Lapustila që pastrohen, në ngjyra të ndryshme (nga një ngjyrë për çdo skuadër me nga katër nxënës)
- Përbërësit për të ndërtuar një "vilë me biskota me kripë" (biskota me kripë, krem pasticerie, karamele, drithëra me ngjyrë, etj.)
- Tabaka (nga një për çdo skuadër me nga katër nxënës, që të përdoret si bazë për vilën; vendosini paraprakisht përbërësit në tabakatë e çdo skuadre)
- Etiketa shpërblyese
- Mjete për të pastruar duart

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndërsa nxënësit fillojnë adhurimin, jepi mundësinë secilit të zgjedhë një ngjyrë skuadre dhe të shënojë kyçin e dorës me atë ngjyrë. Çdo skuadër duhet të ketë rreth 4 nxënës; sigurohuni që të jenë skuadra në numër të barabartë.
2. Kur skuadrat të mbërrijnë në stacionin e ushqimit, thuaj: sfida juaj sot është të punoni si skuadër për të ndërtuar vilën më të bukur me biskota me kripë. Duhet të bashkëpunoni! Skuadra fituese do të marrë pesë etiketa shpërblyese për secilin anëtar!
3. Sigurohu që të gjithë nxënësit të lajnë duart para se të filloni.
4. Filloni sfidën.
5. Gjatë sfidës, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet t'u kërkosh anëtarëve të skuadrave të ndërrojnë skuadrën. Thuaj fjali si: "Unë mendoj se disa nga skuadrat e tjera po ia dalin mbanë më mirë, përse nuk ndërroni skuadër?" ose "Unë mendoj se skuadra tjetër ka krem më të mirë pastiçerie."
6. Mësuesi kryesor dhe Bariu duhet t'i inkurajojnë nxënësit të qëndrojnë në skuadrën e tyre, të mbeten të përkushtuar dhe të zgjedhin të vazhdojnë bashkëpunimin!
7. Kur të përfundojë koha, ndërkohë që ti përcakton fituesin, mësuesi kryesor dhe Bariu duhet të nxisin skuadrat duke thënë: "Ju zgjodhët skuadrën tuaj dhe bëtë shumë mirë që qëndruat të përkushtuar ndaj saj! Bravo skuadra!"
8. Shpall vilën më të bukur të krijuar nga skuadrat! Shpërble me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës që fitoi.
9. Thuaj: "Jam krenar për të gjithë ju. Ju zgjodhët skuadrën dhe i qëndruat besnikë asaj."
10. Nxënësit të brohorasin me bindje për skuadrën e vet.
11. Skuadrat mund të konsumojnë krijimin e tyre.

Aktiviteti 3: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Lapustila që pastrohen, në katër ngjyra të ndryshme (nga një ngjyrë për çdo skuadër)
- Katër sete me forma për plastelinë
- Karta me 12 vargjet kyç (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndërsa nxënësit fillojnë adhurimin, jepi mundësinë secilit të zgjedhë një ngjyrë skuadre dhe të shënojë dorën me atë ngjyrë. Përdor katër lapustila me ngjyra të ndryshme për katër skuadrat. Sigurohuni që skuadrat të jenë në numër të barabartë.
2. Kur nxënësit të mbërrijnë në stacionin e plastelinës, thuaju skuadrave: "Sfida juaj sot është të punoni si skuadër për të formuar me plastelinë tre nga 12 vargjet kyç. Mund t'i zgjidhni vetë tre vargjet që do të formoni. Duhet të bashkëpunoni! Skuadra

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

fituese do të marrë pesë etiketa shpërblyese për secilin anëtar! Skuadra në vend të dytë do të marrë nga dy etiketa shpërblyese për secilin.

3. Kërkoju skuadrave të mblidhen dhe të gjejnë një emër për skuadrën. Duhet t'i nxisni dhe t'i inkurajoni që të punojnë së bashku si skuadër.
4. Filloni sfidën.
5. Gjatë sfidës, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet t'u kërkosh anëtarëve të skuadrave të ndërrojnë skuadrën. Thuaj fjali si: "Unë mendoj se disa nga skuadrat e tjera po ia dalin mbanë më mirë, përse nuk ndërroni skuadër?" ose "Unë mendoj se skuadra tjetër ka plastelinë më të mirë."
6. Mësuesi kryesor dhe Bariu duhet t'i inkurajojnë nxënësit të qëndrojnë në skuadrën e tyre, të mbeten të përkushtuar dhe të zgjedhin të vazhdojnë bashkëpunimin!
7. Shpërble me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës fituese dhe me dy etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës në vendin e dytë.
8. Thuaj: "Jam krenar për të gjithë ju. Ju zgjodhët skuadrën dhe i qëndruat besnikë asaj."
9. Nxënësit të brohorasin me bindje për skuadrën e vet.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – **Lidhja e KZ-së me mësimin**: KZ-ja ishte argëtuese sot. Në cilën skuadër zgjodhët të ishit? Lëri nxënësit të përgjigjen. Mësuesi kryesor dhe Bariu duhet të nxisin skuadrat e tyre! Kur bëhet fjalë për sporte apo lojëra të tilla, shpeshherë jemi shumë shumë të bindur dhe të përkushtuar ndaj skuadrës sonë. A e di që, kur një person zgjedh të besojë në Jezusin, ai bëhet pjesë e skuadrës më të mirë – skuadrës së Perëndisë – dhe duhet të jetë i përkushtuar dhe i bindur! Në mësimin e sotëm do të shohim Jezusin. Ai ishte shumë i bindur për Atë që ishte, dhe ishte shumë i përkushtuar ndaj Perëndisë. Le të dëgjojmë se çfarë ndodh sot. Në fund të mësimit, unë do t'ju pyes se pjesë e cilës skuadre jeni. Filloni të mendoni për këtë ndërsa hapim Biblat.

Lutu: Çdo javë e kemi nisur mësimin duke u lutur njëri nga nxënësit. Kush do të donte të kishte nderin për të nisur mësimin me një lutje, duke i kërkuar Perëndisë të na ndihmojë të mësojmë?

Zbuloje: *Shkruaj referencën e vargut, Luka 3:21, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 3:21. Kujto se, për disa nxënës është e lehtë të gjejnë referencën dhe për disa të tjerë është më e vështirë. Bariu dhe drejtuesi i KZ-së duhet të jenë duke ndihmuar nxënësit që kanë vështirësi dhe ata që janë për herë të parë.*

Kronologjia: *Rishikoni mësimin e këtij tremujori deri te pagëzimi i Jezusit.*

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantim me mësimin nga Bibla: Disa javë më parë mësuam për djalin që lindën Zakaria dhe Elizabeta kur ishin të moshuar. A ju kujtohet se si e quajtën foshnjën? (Gjon) Ky Gjon ishte Gjon Pagëzori. Puna e tij ishte të përgatiste njerëzit sepse Jezusi po vinte për t'i shpëtuar nga mëkatet e tyre. Edhe Gjoni edhe Jezusi u rritën e u bënë burra. Gjoni filloi t'u predikonte njerëzve pendimin për mëkatet. A ju kujtohet se çfarë do të thotë të pendohesh? (të largohesh nga mëkati dhe të pranosh që ke nevojë për Jezusin). Gjoni u predikoi njerëzve për t'i përgatitur për Jezusin. Njerëzit vinin tek ai për t'u pagëzuar në lumin Jordan. Kjo shërbente për t'u treguar të tjerëve se ishin të përkushtuar ndaj Perëndisë. Një ditë, ndërsa Gjoni po pagëzonte njerëzit, diçka shumë e veçantë ndodhi.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 3:21-23a, 4:14-30

Jezusi pagëzohet

Lexo Luka 3:21a

Përmbledhje: Përse u pagëzua Jezusi? A kishte nevojë Ai të pendohej për mëkat? (Jo! Jezusi nuk mëkatoi kurrë) Përse erdhi Ai në tokë? (Për të na shpëtuar nga mëkati)

Shënimi për mësuesin kryesor*: Ne mësojmë se pagëzimi është një shenjë e jashtme e një ndryshimi të brendshëm. Kur Jezusi u pagëzua, Ai e bëri vetëm që të identifikohej me mëkatarët, në mënyrë që ata të identifikoheshin me Jezusin në jetën e tyre.*

Triniteti

Lexo Luka 3:21-22 (rileximi i Luka 3:21a)

Përmbledhje: Kur Gjoni pagëzoi Jezusin, tre personat e Perëndisë ishin atje. Perëndia Atë i tha Jezusit: "Ti je Biri im i dashur, ty të kam pëlqyer." Perëndia Frymë e Shenjtë zbriti mbi Jezusin nga qielli në formën e një pëllumbi. Dhe sigurisht që Perëndia Bir (Jezusi) ishte aty. Kur flasim për Perëndinë Atë, Perëndinë Bir dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë, e quajmë Trinitet sepse trinitet do të thotë tre.

Jezusi nis shërbesën e Tij

Lexo Luka 3:23a *(Nuk do të merremi me gjenealogjinë)*

Përmbledhje: Sa vjeç ishte Jezusi kur nisi shërbesën? (tridhjetë vjeç) Menjëherë pak kësaj, Jezusi kaloi dyzet ditë në shkretëtirë ku Satani e tundoi.

Për nxënësit më të rritur: A ju kujtohet se çfarë përdori Jezusi për të luftuar tundimet e Satanit? (Ai përdori atë që dinte nga Fjala e Perëndisë) Më në fund Satani e la të qetë. Nëse Jezusi përdori Fjalën e Perëndisë për të luftuar tundimin, çfarë duhet të përdorim ne? (Ne duhet të përdorim atë që dimë nga Fjala e Perëndisë për të bërë atë që është e drejtë)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Për të gjithë nxënësit: Satani e la Jezusin në shkretëtirë për shkak se Jezusi nuk do t'i dorëzohej atij. Pas kësaj Jezusi filloi të mësojë e të predikojë.

***Shënim për mësuesin kryesor**: Mësimi mbi tundimin në shkretëtirë do të mbulohet plotësisht vitin e ardhshëm, në tremujorin e dytë, te Mateu 4:1-11 (ngjarje paralele me atë te Luka 4:1-13).*

Jezusi predikon dhe mëson

Lexo Luka 4:14-15

Përmbledhje: Në fillim, të gjithë e lavdëruan Jezusin, sepse mendonin se ishte një mësues i shkëlqyer. Pastaj, një ditë...

***Shënim për mësuesin kryesor:** Komentuesit supozojnë se ngjarja e mëposhtme në Nazarat ndodhi një vit pas tundimit të Jezusit; dhe ngjarja te Gjoni 1:19-4:42 ndodhi diku midis ngjarjeve nga Luka 4:13 dhe Luka 4:14.*

Jezusi shkon në qytetin e tij të Nazaretit

Lexo Luka 4:16-17a

Përmbledhje: Jezusi u bë gati të lexonte diçka që kishte shkruar profeti Isaia. A ju kujtohet se çfarë është një profet? (Dikush që u jep njerëzve mesazhin e Perëndisë) Isaia jetoi rreth 700 vite para Jezusit. Tregoje te kronologjia e Biblës. Isaia u tha njerëzve se Perëndia do të dërgonte një Shpëtimtar një ditë. Le të dëgjojmë se çfarë shkroi Isaia.

Jezusi deklaron se është Shpëtimtari i botës

Lexo Luka 4:17b-21

Përmbledhje: Jezusi u thotë hebrenjve në sinagogë se Ai ishte Shpëtimtari për të cilin kishte shkruar Isaia!

Jezusi i përball njerëzit me të vërtetën

Lexo Luka 4:22-27

Përmbledhje: Në fillim, njerëzve u pëlqente çfarë thoshte Jezusi. Pastaj, Jezusi u tha se populli hebre kishte zgjedhur të mos i besonte profetëve të Perëndisë në të shkuarën dhe tani ata do të zgjidhnin të mos besonin tek Ai si Shpëtimtar. Perëndia do ta dërgonte Atë te johebrenjtë, që ata të mund të shpëtonin nga mëkati i tyre.

Hebrenjtë përpiqen të vrasin Jezusin

Lexo Luka 4:28-30

Përmbledhje: Edhe pse hebrenjtë u përpoqën ta vrasin Jezusin në atë moment, Ai shpëtoi, sepse nuk ishte ende koha që Perëndia kishte zgjedhur që Ai të vdiste. Ajo që Jezusi u tha hebrenjve në Nazaret ishte e vërtetë. Pjesa më e madhe e tyre nuk do të besonin tek Ai si Shpëtimtar. Në fakt, ata do të kërkonin kryqëzimin e Tij një ditë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Kur Jezusi mësoi në sinagogë atë ditë, hebrenjtë në Nazaret kishin mundësinë e zgjedhjes. Ata mund të kishin besuar në Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, por nuk e bënë. Në fakt, ata e urryen dhe u përpoqën vazhdimisht ta vrisnin. Por Jezusi na deshi aq shumë, sa zgjodhi të vdiste në kryq, që ne të shpëtonim nga mëkati.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A e di dhe a e beson se Jezusi është Shpëtimtari? Çfarë do të thotë kjo? Shpall Ungjillin përmes "Librit pa fjalë". A ju kujtohet aktiviteti i *Kohës së zbulimit*? Duhet të zgjidhnit se cilës skuadre t'i përkisnit, pastaj qëndruat të përkushtuar ndaj asaj skuadre. E njëjta gjë vlen kur zgjedh të besosh në Jezusin. Je i përkushtuar ndaj Tij gjithë jetën! Ti je fëmijë i Perëndisë dhe pjesë e familjes së Perëndisë përgjithmonë! Në cilën skuadër je? A beson vërtet në Jezusin dhe në atë që Ai ka bërë për ty?

A njeh njerëz që zgjedhin të mos besojnë se Jezusi është Shpëtimtari? A lutesh për ta? A je përpjekur t'u tregosh se Jezusi i do aq shumë sa vdiq në kryq për ta? Pavarësisht se çfarë zgjedhin të besojnë të tjerët, ti mund të jesh i sigurt se Jezusi është vërtet Shpëtimtari. Cili është vargu nga *Mendo si duhet* që mund ta përdorim për të kujtuar se Jezusi është Shpëtimtari? Kërkoji nxënësve të recitojnë Gjonin 14:6.

Nëse ju mbetet kohë, shpërndani disa copa letrash dhe kërkojuni nxënësve të shënojnë emrin e dikujt për të cilin po luten, dikush që ka nevojë të njohë Jezusin. Kaloni pak kohë për t'u lutur në heshtje dhe pastaj kërkoju t'i vendosin copat e letrës brenda Biblës që të kujtohen vazhdimisht për t'u lutur për atë person.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Përse shkoi Jezusi te Gjon Pagëzori? (Për t'u pagëzuar)
2. Cilët persona të Perëndisë ishin në pagëzimin e Jezusit? Si e quajmë këtë? (Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë; Trinitet)
3. Sa vjeç ishte Jezusi kur filloi shërbesën e Tij? (Rreth tridhjetë vjeç)
4. Çfarë lexoi Jezusi te sinagoga në Nazaret? (Ai lexoi atë që profeti Isaia kishte shkruar për Shpëtimtarin)
5. Kush tha Jezusi se ishte përpara njerëzve në sinagogë? (Shpëtimtari)
6. A u tha Jezusi hebrenjve se do të besonin apo nuk do të besonin tek Ai si Shpëtimtar? (Ata nuk do të besonin)
7. Çfarë u përpoqën hebrenjtë t'i bënin Jezusit atë ditë? (Ata u përpoqën ta vrisnin)
8. A u përmbush ajo që Jezusi u tha njerëzve? Si e dimë këtë? (Po, ata e kryqëzuan Jezusin)
9. A e ke zgjedhur Jezusin si Shpëtimtarin tënd?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 7
Luka 4:31-44

Kupto si duhet:	Jezusi shëron vjehrrën e Pjetrit.
Mendo si duhet:	"A nuk të urdhërova unë? Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse ZOTI, Perëndia yt është me ty kudo që të shkosh." Jozueu 1:9 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se Jezusi mund të më shërojë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i inkurajuar kur besoj se Jezusi mund të më ndihmojë.

PËRGATITU!

Jezusi ka shumë, shumë cilësi të mrekullueshme, përfshirë të qenët një shërues. Ai përdor doktorët dhe mjekësinë e kohëve moderne për ta plotësuar vullnetin e Tij, por kur këto gjëra nuk janë në dispozicion, fuqia e Tij është ende e mjaftueshme për të shëruar. Ai vazhdon të bëjë mrekulli siç bëri kur ecte në tokë, dhe shëroi vjehrrën e Pjetrit. Kjo është entuziazmuese!

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer, lutu që sytë e nxënësve të tu të hapen nga fuqia e Perëndisë për të shëruar probleme fizike dhe frymërore. Lutu për nxënësit të cilët kanë nevojë për shërim dhe për ata që kanë familjarë që kanë nevojë për shërim.

Lexo: Luka 4:31-44

Kupto si duhet: Jezusi shëron vjehrrën e Pjetrit
Jezusi shpëtoi nga hebrenjtë në Nazaret dhe vazhdoi shërbesën e Tij. Përveç mësimit dhe predikimit, Jezusi bëri shumë mrekulli. Mrekullitë e Tij të shërimit kanë qenë prova që u duhej njerëzve për të besuar se Ai ishte Biri i Perëndisë, Shpëtimtari i botës. Edhe pse shumë njerëz në kohën e Jezusit erdhën tek Ai për shërim fizik, qëllimi i Tij në botë ishte të vdiste në kryq dhe të ringjallej, që ata të mund të shëroheshin frymërisht nga mëkati i tyre. Ata që janë shëruar frymërisht nga Jezusi e dinë që, ose tani ose në të ardhmen, Ai do të na shërojë edhe fizikisht. Ne ecim në këtë jetë duke besuar se Jezusi mund të na shërojë.

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor: Për mësuesit me nxënës më të rritur: Si do të përgjigjemi nëse fëmijët na pyesin për pushtimin nga demonët? Demonët janë frymëra të liga që drejtohen nga Satani, ashtu siç drejtohen engjëjt nga Perëndia.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Si të krishterë, ne nuk duhet të kemi frikë nga demonët apo të shqetësohemi nga pushtimi i tyre, sepse Fryma e Shenjtë banon në ne. Perëndia është më i fuqishëm se Satani dhe demonët. Nuk duhet të luajmë apo të argëtohemi nga demonët. Demonët janë armiq të Perëndisë.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Audio drama – kërkoju drejtuesve të ndryshëm ta lexojnë pasazhin duke përdorur zëra teatralë.
2. Fto një aktore të portretizojë vjehrrën e Pjetrit dhe të ndajë përvojën e saj me Jezusin. Pastaj lexoje pjesën nga Shkrimi.
3. Për nxënësit më të rritur: vizato dy palë sy në tabelë ose priji në pjata plastike. Shikojeni mësimin përmes syve të Jezusit. Shikojeni mësimin përmes syve të njerëzve. Në ç'pika ndryshon dhe në ç'pika është e njëjtë.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: I shëruar

Qëllimi: Të prezantojmë mësimin e shërimit fizik.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Kartolina me mesazhe inkurajuese si: "Lutemi për shërim të shpejtë", në pjesën e parme dhe vargun nga Jozueu 1:9 brenda (burim i printueshëm)
- Lapustila
- Leukoplastë (nga tre për çdo nxënës)
- Sy plastikë
- Ngjitës
- Letër për punëdore
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Udhëzojini nxënësit të bëjnë një kartolinë (duke përdorur leukoplastët, sytë plastikë dhe lapustilat) për të inkurajuar dikë që është sëmurë dhe po merr veten nga një dëmtim apo ndërhyrje.
2. Informoji se të gjitha kartolinat e mira do të blihen me pesë etiketa shpërblyese. (kartolinat nuk do të vlejnë nëse kanë gjak apo detaje të pakëndshme në to.)
3. Kartolinat duhet të jenë shumëngjyrëshe dhe inkurajuese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Drejtuesi i shërbesës së fëmijëve duhet t'i mbajë kartolinat në kishë dhe t'i dërgojë gjatë vitit te njerëzit në kishë që janë sëmurë ose që po marrin veten nga një dëmtim a ndërhyrje.

Aktiviteti 2: Stacioni i kutive ose hapësirë e madhe

Mjetet:

- Kapëse rrobash (nga dy për çdo nxënës)
- Garza (nga dy për çdo nxënës)
- Spango ose konë (për të caktuar një zonë ku nxënësit mund të vrapojnë)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi çdo nxënësi dy kapëse rrobash dhe dy garza.
2. Pyeti nxënësit se për çfarë përdoren garzat. (për të lidhur plagët, për ta mbajtur plagën të pastër dhe për të ndihmuar shërimin)
3. Kërkoju nxënësve t'i kapin garzat te rrobat e tyre, në një vend të dukshëm, duke përdorur kapëset e rrobave.
4. Sfida për nxënësit do të jetë të vrapojnë përreth dhe të përpiqen të heqin garzat e njëri-tjetrit.
5. Nxënësi i fundit që i mbetet garza, fiton.
6. Shpërbleje fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
7. Përsëriteni, por herën e dytë nxënësit mund të përdorin vetëm njërën dorë për të kapur garzat, duke e mbajtur dorën tjetër pas kurrizit. Nëse i përdorin të dyja duart, eleminohen.
8. Nëse keni kohë përsëriteni prapë dhe kësaj here nxënësit duhet të hidhen me një këmbë.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit **-** *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 1-rë, tremujori i 2-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Përse mendoni se e bëmë aktivitetin e sotëm gjatë KZ-së? Për çfarë mendoni se do të flasim sot? (Dikush do të shërohet) A besoni se Perëndia mund t'i shërojë njerëzit? Përse i shëron Ai njerëzit? A ka lloje të ndryshme shërimi? Në mësimin e sotëm do të zbulojmë disa gjëra fantastike për shërimin!

Shënim: nëse KZ-ja ishte në stacionin e misionit, ju lutem bëni një lidhje me mësimin nga Bibla.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: Në fillim të çdo mësimi inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të luten në vende publike dhe të zhvillojnë aftësi udhëheqësie frymërore.

Zbuloje: Shkruaj referencën e vargut, Luka 4:31, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 4:31. Mësoju se referenca është "adresa" e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve që Luka është libri, numri i parë, 4, është kapitulli dhe numri i dytë, 31, është vargu.

Kronologjia: *Drejtohuni te periudha p*ërkatëse në kronologjinë biblike. Kujtoju nxënësve se Bibla nuk është thjesht histori individuale. Është plani i tërë i Perëndisë.

Prezantim me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam se si Jezusi u tha hebrenjve në Nazaret se Ai ishte Shpëtimtari. Ai u tha gjithashtu se pjesa më e madhe e hebrenjve nuk do të besonin tek Ai. Ai u tha se njerëzit që nuk ishin judenj (johebrenjtë) do të mund të shpëtoheshin nga mëkati i tyre. Njerëzit në sinagogë u zemëruan aq shumë saqë u përpoqën ta hidhnin Jezusin nga shkëmbi për ta vrarë. Jezusi shpëtoi, sepse ende nuk ishte koha e Perëndisë që Ai të vdiste.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 4:31-44

Jezusi mëson me autoritet

Parafrazimi i Luka 4:31-37

Pasi Jezusi shpëtoi, Ai shkoi në një qytet tjetër në Galile të quajtur Kapernaum. Kapernaumi ishte vendi ku jetuan dishepujt e Jezusit, Simon Pjetri dhe Andrea. Jezusi shkoi në sinagogën e Kapernaumit për të mësuar njerëzit dhe për të dëbuar demonë. Të gjithë njerëzit e dinin se Ai kishte autoritet dhe fuqi të madhe. Ja çfarë ndodhi pasi Jezusi u largua nga sinagoga.

Jezusi shkon në shtëpinë e Pjetrit

Lexo Luka 4:38-39

Përmbledhje: Vjehrra e Pjetrit ishte sëmurë me temperaturë. A ke pasur ndonjëherë temperaturë? Si të bën të ndihesh? Shumë i këputur, apo jo? Në varësi të sa e lartë është temperatura, mami ose babi mund të të çojnë te doktori ose të japin ndonjë ilaç që ndihmon në rënien e temperaturës. Edhe nëse temperatura bie, zakonisht vazhdon të ndihesh keq për pak kohë. Vjehrra e Pjetrit nuk kishte nevojë të shkonte te një doktor. Jezusi i tha temperaturës të largohej, dhe ashtu ndodhi! A e dini se Jezusi është aq i fuqishëm saqë mund të shërojë ashtu, në çast? Ai mundet! Dëgjojeni këtë.

Jezusi është ende Shëruesi

Si pastor, më thirrën të takoja një çift në spital. Vajza e tyre kishte kaluar një krizë dhe nuk merrte frymë. Kur arrita te spitali, as prindërit e as doktori nuk ishin me fëmijën. Një infermiere po hiqte makineritë që e mbanin në jetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Fryma e Shenjtë më nxiti të bëj diçka që nuk e kisha bërë kurrë – të lutesha për trupin e pajetë të vajzës. E pyeta infermieren nëse mund të lutesha një minutë dhe ajo m'u përgjigj: "E dini që ka vdekur", por megjithatë më lejoi. I kërkove Perëndisë ta ripërtërinte vajzën e vogël. Pastaj shkova në dhomën tjetër dhe gjeta prindërit që po i dëshmonin doktorit. Rreth një minutë më vonë dëgjojmë një ulërimë, pastaj vajza e vogël filloi të kërkonte të ëmën me të qara. Nuk më ka ndodhur kurrë më parë dhe kurrë më vonë. Por Jezusi është ende shëruesi. - *Rev. Jon F. Soper, https://www.cmalliance.org/about/beliefs/healer*

Jezusi shëron sot dhe Ai shëroi vjehrrën e Pjetrit. Ma merr mendja që disa po pyesin veten: "Përse disa njerëz nuk shërohen nga Jezusi?" Perëndia nuk përgjigjet gjithmonë "Po" kur i kërkojmë të shërojë dikë. Ne mund të besojmë se Ai e di çfarë është më e mira. Ai mund t'i përdorë sëmundjet dhe sfidat që ne të afrohemi më shumë me Të. Dhe mund të dimë se, një ditë, të gjithë ata që kanë besuar në Jezusin do të kenë trupat e shëruar dhe të përsosur në qiell! Qielli është i bukur dhe i përsosur – nuk ka sëmundje apo vdekje!

Vjehrra e Pjetrit mundi të ngrihej menjëherë dhe t'u shërbente Jezusit dhe dishepujve.

Shënim për mësuesin kryesor: Mateu 8:15 thotë se Jezusi e preku dorën e saj dhe Marku 1:31 thotë se Ai e kapi për dore dhe e ndihmoi të ngrihej.

Por vjehrra e Pjetrit nuk ishte e vetmja e sëmurë. Dëgjojeni këtë.

<u>Njerëzit vinin te Jezusi për t'u shëruar</u>

Lexo Luka 4:40 dhe 4:42 (mos e lexon 4:41)

Përmbledhje: Jezusi është Zot dhe Ai ka fuqinë të shërojë çdo lloj sëmundjeje. Njerëzit që erdhën te Jezusi donin që Ai të shëronte sëmundjet e tyre. Kur Jezusi i shëronte këta njerëz, vërtetonte se Ai ishte Shpëtimtari. (Gjoni 10:25, Gjoni 10:38, Gjoni 14:11, Gjoni 15:24, Veprat 2:22). Por, shërimi i njerëzve nga sëmundjet fizike nuk ishte arsyeja kryesore për të cilën Jezusi erdhi në tokë. Përse erdhi Jezusi në tokë?

<u>Jezusi vjen për t'i shëruar njerëzit nga mëkati i tyre</u>

Lexo Luka 4:43-44

Përmbledhje: Arsyeja përse Jezusi erdhi në tokë ishte t'u tregonte njerëzve se Ai është Shpëtimtari dhe gjithashtu që të vdiste në kryq për mëkatet e tyre. Ja përse Jezusi vazhdoi t'u predikonte dhe t'i mësonte njerëzit. Ai donte t'i shihte njerëzit të shëruar nga mëkati. Trupat tanë tokësorë zgjasin pak, por shpirtrat tanë do të jetojnë përgjithmonë. Çfarë është një shpirt? Mendo pak për një karamele. Mbështjellja e jashtme është njësoj si mishi ose trupi (flokët, lëkura, etj.). Pjesa prej çokollate që është brenda mbështjellëses është

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

personaliteti yt dhe të gjitha karakteristikat abstrakte (jofizike) që të bëjnë unik. Kur të vdesësh, trupi do të mbetet mbrapa dhe shpirti yt do të jetojë përgjithmonë.

Përfundimi

Çfarë është më e rëndësishme – të shërohesh nga sëmundja në këtë jetë, apo të marrësh falje për mëkatet dhe të shërohesh frymërisht që të mund të jetosh përgjithmonë në qiell me Perëndinë, ku nuk do të ketë as sëmundje e as vdekje? Të shërohesh frymërisht që të kesh jetë të përjetshme është më e rëndësishme sesa të shërohesh nga një sëmundje në këtë jetë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A ke besuar në Jezusin për faljen e mëkateve dhe shërimin frymëror? Nëse nuk e ke bërë, Ai mund të të falë tani. Le të sigurohemi që e kupton se si. Shpalle Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe jep ftesë për shpëtim.

Jezusi erdhi të na falë mëkatin dhe të na shërojë frymërisht, por Ai ka gjithashtu fuqinë të na shërojë nga çdo sëmundje. A je sëmurë ti ose dikush që njeh? Mund të lutesh dhe t'i kërkosh shërim Perëndisë. Nëse je i krishterë nuk duhet të kesh frikë nga sëmundjet e as nga vdekja! Cili varg nga "Mendo si duhet" na ndihmon të kujtojmë se nuk duhet të kemi frikë? Kërkoju nxënësve të recitojnë Jozueu 1:9.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë nuk shkonte me vjehrrën e Pjetrit? (Ajo ishte sëmurë me temperaturë)
2. Çfarë bëri Jezusi për vjehrrën e Pjetrit? (Ai e shëroi)
3. Çfarë bëri vjehrra e Pjetrit menjëherë pasi Jezusi e shëroi? (Ajo i shërbeu Jezusit dhe dishepujve)
4. Përse vinin njerëzit në Kapernaum që ta takonin Jezusin? (Që të shëroheshin nga sëmundjet)
5. Çfarë bëri Jezusi për këta njerëz të sëmurë? (Ai i shëroi)
6. Kur Jezusi i shëroi këta njerëz, çfarë vërtetoi? (Ai është Shpëtimtari)
7. A mund të të shërojë Jezusi ty apo njerëzit që ti do nga sëmundjet? (Po)
8. Përse erdhi Jezusi në tokë? (Të falte mëkatet e njerëzve dhe t'i shëronte frymërisht)
9. Çfarë është më e rëndësishme – të shërohesh nga sëmundjet apo të marrësh falje për mëkatet dhe të shërohesh frymërisht (Të marrësh falje dhe të shërohesh frymërisht)
10. A ke besuar në Jezusin për faljen e mëkateve dhe shërimin frymëror?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 8
Luka 7:36-50

Kupto si duhet:	Një grua mëkatare vajos Jezusin.
Mendo si duhet:	"Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë" Romakëve 3:23 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të di se jam mëkatar.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i përulur kur e di se jam mëkatar.

PËRGATITU!

Është përulëse të dish se Jezusi do dhe fal mëkatarët... kjo do të thotë se Ai na do dhe na fal të gjithëve! Le të kalojmë pak kohë sot duke e falënderuar Perëndinë me përulësi që ka dërguar Jezusin për të na falur. Vetëm për shkak të Jezusit mund të marrim falje dhe të çlirohemi nga mëkati dhe vdekja. Në Jezusin kemi shpresë për sot dhe për përjetësinë!

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer, lutu që Perëndia të të bindë ty dhe nxënësit e tu për mëkate në jetën tënde, që i ke lënë të parrëfyera dhe nuk je marrë me to.

Lexo: Luka 7:36-50

Kupto si duhet: Një grua mëkatare vajos Jezusin
Gjatë kohës së Jezusit në tokë, drejtuesit fetarë u përpoqën shumë herë ta zhvlerësonin dhe të kundërshtonin faktin se Ai ishte Shpëtimtari. Këta burra të vetëdrejtësuar i anashkalonin shumë lehtësisht mrekullitë e Tij dhe urtësinë e Tij, dhe me keqdashje sulmonin dashurinë dhe mëshirën e Tij. Kjo sjellje u bë shumë e dukshme një mbrëmje, kur Simoni fariseu e ftoi Jezusin për darkë. Një grua mëkatare erdhi dhe adhuroi Jezusin, duke larë këmbët e Tij me lotët dhe flokët e saj, duke i puthur e duke i vajosur me parfum. Simoni e përqeshi në vend që të përulej e të kuptonte se ishte po aq mëkatar sa ajo. Ky kontrast i errët na ndihmon të pranojmë me përulje se jemi mëkatarë.

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:
1. Vizatoje skenën në tabelë – thekso personazhet e ndryshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Krijo skenën e një vakti formal. Njerëzit në kohët biblike, zakonisht uleshin në tavolina të ulëta, mbi jastëkë dhe duke u mbështetur me bërryla. I drejtonin këmbët larg tavolinës dhe e hanin ushqimin me duar.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Mëkati i kujt është më i madhi?

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se asnjë mëkat nuk është më i madh se tjetri.

Aktiviteti 1: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Dy grupe me nga 15 kuti, me foto mëkatesh të ngjitura në to – fotot mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga njerëz që nuk pranojnë të tregohen të sinqertë me njëri-tjetrin e deri te njerëz që vjedhin shtëpi (printoje çdo grup në letra me ngjyra të ndryshme) (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra. Caktoji mësuesin kryesor dhe bariun si kapitenë skuadrash.
2. Sfidoji skuadrat t'i vendosin kutitë mbi njëra tjetrën, sipas radhës së mëkatit. Kapitenët e skuadrave duhet t'i ndihmojnë nxënësit t'i mendojnë mirë fotot. Mëkati më i "keq" duhet të jetë më lart dhe mëkati "jo aq i keq" duhet të jetë në fund. Sfidoji nxënësit të mendojnë si skuadër ndërsa vendosin kutitë mbi njëra-tjetrën.
3. Pasi të jenë vendosur kutitë, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet të sillesh sikur po kontrollon nëse kutitë janë vendosur sipas rendit të saktë. Pyeti nëse është përgjigjja e tyre përfundimtare (lejoji ta ndryshojnë vendndodhjen nëse duan). Ndalo pranë çdo kulle me kuti dhe bëj sikur po mendon. Pastaj, dalëngadalë hidhi kutitë dhe thuaj: "Kjo është radha e duhur. Janë të gjitha të barabarta." Mësuesi kryesor dhe bariu mund të ndihmojnë që të gjitha kutitë të jenë në tokë.
4. Nxënësit mund të duken të hutuar, por tregoju atyre se, kur Perëndia sheh mëkatin, të gjithë janë njësoj në sytë e Tij, dhe çdo mëkat çon në të njëjtin ndëshkim – në ndarje nga Perëndia.
5. Nëse keni kohë: Vendosini kutitë në rresht të drejtë. Skuadra e parë që e përfundon rreshtimin fiton nga një etiketë shpërblyese për secilin anëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Një aktor që ka veshur kostumin e personazhit negativ, i cili do të hiqet si hajdut (zgjidh dikë që nxënësit nuk e njohin; duhet të jetë e kuptueshme që nuk është një drejtues, por një aktor) *Shënim: vendose paraprakisht se kush do të vrapojë për të ndjekur hajdutin.*
- Përbërës për të përgatitur diçka të thjeshtë për të ngrënë,p.sh. një sanduiç, (hajduti do të "vjedhë" përbërësin e fundit)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Nxënësit do të përgatisin diçka për të ngrënë. Kur të jetë koha për t'u hedhur përbërësi i fundit, një hajdut do të vijë dhe do ta marrë!
2. Nxënësit dhe drejtuesit duhet të drejtohen nga hajduti dhe të bërtasin: "Hajdut!" ndërsa largohet.
3. Një drejtues duhet ta ndjekë hajdutin. Drejtuesit që kanë mbetur mbrapa me nxënësit duhet të tregojnë shqetësimin e tyre dhe të shprehin sa e gabuar është që dikush të marrë diçka që nuk i përket! Aftësitë teatrale duhet të shkëlqejnë.
4. Për shkak të përbërësit që mungon, aktiviteti i KZ-së do të përfundojë dhe nxënësit do të kthehen në klasë të zhgënjyer e të mërzitur.
5. Pasi të largohen nxënësit, skuadra e stacionit të ushqimit mund të përfundojë ushqimin dhe t'ua shpërndajnë nxënësve në fund.

Aktiviteti 3: Stacioni i artit ose hapësirë e madhe

Mjetet:

- Kartolina inkurajuese me vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6 të shkruara në pjesën e brendshme dhe dy mundësi për pjesën e jashtme: "Të dërgojmë gëzim!" dhe "Perëndia të do!" (burim i printueshëm)
- Lapustila dhe bojëra dhjami (kontaktoni paraprakisht një kapelan/dikush që shërben në burg, për të marrë specifika se çfarë mund të dërgoni ose jo nëpër burgje)
- Tavolina
- Me zgjedhje: kërkojini një kapelani që shërben në burgjet e të miturve të vijë dhe të ndajë shkurtimisht me nxënësit për burgjet dhe të rinjtë atje.



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Thuaj: Përse përfundojnë njerëzit në burg? (Zakonisht për shkak të një mëkati që kanë kryer) A kanë nevojë për inkurajim njerëzit në burg? (Po) A duhet të dëgjojnë për Jezusin? (Po) Perëndisë nuk i pëlqejnë gjërat e këqija që ata kanë bërë – në fakt, Ai e urren mëkatin! Por Ai gjithsesi e do mëkatarin dhe Ai dëshiron që ata të

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

vijnë tek Ai. Ndodh gjithashtu që dikush të përfundojë padrejtësisht në burg. Edhe të krishterët janë futur në burg për shkak se u kanë treguar të tjerëve për Jezusin. Le të krijojmë disa kartolina që do të inkurajojnë një person në burg dhe t'u tregojmë për Jezusin!

2. Nxënësit duhet të shënojnë emrin brenda kartolinës (mos e shënoni mbiemrin).
3. Mblidhini kartolinat dhe lutuni për personat që do t'i marrin.
4. Gjatë javës, dërgojini kartolinat te një nga burgjet e të rriturve apo të miturve. Nëse në kishë keni një kapelan, dërgojini kartolinat me të për shpërndarje.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Cili mëkat është më i madh në sytë e Perëndisë? Të jesh hajdut apo të gënjesh prindërit? Të tallesh me një nxënës në shkollë apo të marrësh para nga çanta e mamit? Kur mendojmë për një person që është në burg, zakonisht e mendojmë si njeri të keq/mëkatar. A e ke menduar ndonjëherë se ka njerëz në burg që njohin Jezusin ndërsa janë aty? Nxënës, a e kuptoni se, mëkati që bëni ju dhe mëkati që bëjnë ata na ndajnë njësoj nga Perëndia? Ndëshkimi i drejtë për çdo mëkat është ndarja nga Perëndia përgjithmonë (Romakëve 3:23; Romakëve 6:23). Sot do të flasim për një grua të cilës i referoheshin si një që grua që jetonte një jetë mëkatare. Le të hapim Biblat dhe të zbulojmë se përse po rrinte pranë Jezusit!

Lutu: Në fillim të mësimit, kërkoji secilit prej nxënësve të ulin kokën dhe të falënderojnë në heshtje Perëndinë për atë që Ai është. Pastaj lutu që Perëndia t'u mësojë diçka të re sot.

Zbuloje: Pyeti nxënësit nëse Luka është në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. (Dh.R.) Shkruaj referencën e vargut, Luka 7:36, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 7:36. Pyeti nxënësit se përse është kaq e rëndësishme t'i gjejmë vargjet në Bibël. (Që ata të mund ta lexojnë Biblën vetë; që të mund të vërtetojnë se diçka është vërtet në Bibël; që të mund t'u tregojnë të tjerëve se çfarë thotë vërtet Bibla)

Kronologjia: *Drejtohuni te periudha përkatëse në kronologjinë biblike. Përsërisni mësimet e kaluara dhe tregoju se ku jemi këtë javë.*

Prezantim me mësimin nga Bibla: Pasi Jezusi u pagëzua, Ai zgjodhi dymbëdhjetë dishepujt e Tij. Ai shëroi njerëzit dhe bëri mrekulli të tjera. Ai predikoi dhe u mësoi njerëzve të vërtetën për Mbretërinë e Perëndisë. Shumë njerëz e dëgjuan Jezusin dhe besuan në Të, por kishte të tjerë që nuk besuan. Disa drejtues fetarë, të quajtur farisenj, duhet të ishin ekspertë, dhe ata ua mësonin njerëzve Ligjin e Perëndisë. Shumë prej tyre nuk u besuan fjalëve të Jezusit. A e imagjinon dot? Ata mendonin se dinin më tepër për Ligjin e Perëndisë sesa Jezusi!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ndodhi që Jezusi shkoi për darkë në shtëpinë e Simon fariseut. A shkon ndonjëherë familja jote për darkë në shtëpinë e dikujt tjetër? Zakonisht, shkojmë te shtëpia, kalojmë pak kohë duke folur e duke u argëtuar dhe pastaj ulemi në tavolinë për të darkuar së bashku. Janë gjëra të zakonshme, në mos qoftë ndonjë darkë feste apo diçka e veçantë.

Por gjërat ishin ndryshe në kohën kur jetonte Jezusi. Kur shkoje në shtëpinë e dikujt për darkë, zakoni ishte që mikpritësi ta përshëndeste të ftuarin me një puthje. Mikpritësi i kërkonte shërbëtorit më të parëndësishëm të lante këmbët e të ftuarve dhe mbi kokën e të ftuarve vendosej pak vaj për të treguar se ishin të nderuar dhe të veçantë për mikpritësin. Të ftuarit thuajse shtriheshin rreth tavolinës duke mbajtur këmbët larg saj. Vizato një diagramë në tabelë për t'i ndihmuar nxënësit ta imagjinojnë skenën. Shtëpia ndonjëherë rrinte me dyert e hapura në mënyrë që, njerëzit të cilët nuk ishin të ftuar, të vinin dhe të shikonin. Ishte shumë ndryshe atëherë! Kështu ndodhi edhe kur Jezusi shkoi të darkonte në shtëpinë e Simon fariseut. Le t'i hapim Biblat dhe të zbulojmë se si u trajtua Jezusi kur shkoi në shtëpinë e Simonit.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 7:36-50

<u>Një grua mëkatare adhuron Jezusin</u>

Lexo Luka 7:36-38

Përmbledhje: A nuk duket sikur kjo grua ka kuptuar se sa mëkatare ishte dhe sa nevojë kishte për një shpëtimtar? A nuk duket sikur ka besuar në Jezusin si Shpëtimtarin e saj? (Po, ashtu duket) Po Simon fariseu? Çfarë po mendonte ai ndërsa shikonte këtë grua që adhuronte Jezusin? Bibla na e thotë...

<u>Simoni nuk beson se Jezusi është Shpëtimtari</u>

Lexo Luka 7:39

Përmbledhje: Simoni po mendonte me vete. Ai nuk po shprehej me zë. Çfarë po mendonte? Ai nuk besonte se Jezusi ishte vërtet profet nga Perëndia. Ai nuk besonte se Jezusi mund të ishte vërtet Shpëtimtari. Përse? Nëse Jezusi do të ishte vërtet profet, padyshim që nuk do ta lejonte këtë grua mëkatare ta prekte. A mendoni se Simoni e shihte veten si mëkatar? (Jo) Çfarë dimë ne nga Romakëve 3:23? Kërkoju nxënësve të recitojnë vargun. Pikërisht. Simoni nuk besonte se ishte mëkatar si kjo grua. Por ishte.

Disa prej nesh mendojnë se nuk jemi aq mëkatarë sa njerëzit në burg... por jemi! Mëkati është mëkat. Pavarësisht përmasës, mëkati është ai që na ndan nga Perëndia dhe të qenët me Të në qiell një ditë! (Romakëve 6:23) Le të zbulojmë se çfarë bëri Jezusi.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi tregon një shëmbëlltyrë për faljen

Lexo Luka 7:40-43

Përmbledhje: Përse do të ishte e vërtetë kjo? Le të vazhdojmë të lexojmë.

Jezusi krahason Simonin dhe gruan mëkatare

Lexo Luka 7:44-50

Përmbledhje: Jezusi shpjegoi se gruaja e dinte se ishte një mëkatare që kishte nevojë për falje. Për shkak se Jezusi ishte Ai që do të falte mëkatet e saj, ajo e donte shumë Atë. Por Simoni nuk e donte Jezusin si ajo grua, sepse ai nuk mendonte se kishte nevojë për faljen e ndonjë mëkati.

Përfundimi

Kjo grua e dinte se ishte mëkatare, ajo besonte në Jezusin si Shpëtimtari i saj, dhe mori faljen për mëkatin. Për shkak se mori falje, jeta i ndryshoi dhe ajo mësoi ta donte vërtet Jezusin. Prandaj shkoi në shtëpinë e Simonit, për të bërë gjithçka bëri për Jezusin. Simoni nuk besonte se kishte vërtet nevojë për një Shpëtimtar. Për shkak të kësaj, ai hiqej sikur e kishte qejf Jezusin, por nuk e donte vërtet si Shpëtimtarin e Tij.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Kujt i ngjan më shumë ti, gruas apo burrit? A e kupton vërtet se je mëkatar dhe, a e ke kuptuar se sa i tmerrshëm është mëkati yt? Ky mëkat është ai që na ndan nga Perëndia. A ke besuar në Jezusin si Shpëtimtari yt, që të të hiqet ndëshkimi për mëkatin? A dëshiron ndonjëri të lutet dhe t'i kërkojë Jezusit falje për mëkatin dhe ta bëjë udhëheqësin e jetës së vet? Jep mundësinë të luten për shpëtim.

E di që shumë prej jush i kanë kërkuar tashmë Jezusit falje për mëkatin. Si e ndryshon kjo jetën tënde? Ja disa pyetje për të cilat mund të mendosh:

- Kur vjen në kishë dhe adhuron Perëndinë, për çfarë mendon më shumë, veprimet e këngëve apo fjalët që po i këndon Perëndisë?
- Kur hapim Biblat, a pret me padurim të dëgjosh për Perëndinë që të do shumë, apo mendon gjëra të tjera?
- Kur ke mundësinë të mësosh vargje përmendsh, a ankohesh apo je i gëzuar që mund ta njohësh më shumë Perëndinë?

Le të lutemi në heshtje dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë të jemi të përulur, të kuptojmë se duam t'i bëjmë gjërat me mënyrën tonë dhe jo siç i pëlqen Perëndisë, dhe që ta duam më shumë se çdokush apo çdo gjë tjetër. Jep pak kohë për lutje në heshtje dhe pastaj mbylleni me një lutje.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë ishte një farise? (një drejtues fetar që duhet të ishte ekspert dhe mësues i Ligjit të Perëndisë)
2. Përse ishte Jezusi në shtëpinë e Simon fariseut? (Simoni e ftoi Jezusin për darkë)
3. Çfarë bëri gruaja mëkatare për Jezusin në shtëpinë e Simonit? (Ajo i lau këmbët me lotët e saj dhe flokët e saj; ajo i puthi këmbët dhe i hodhi parfum)
4. Përse i bëri gruaja mëkatare të gjithë këto gjëra për Jezsuin? (Ajo e dinte se ishte mëkatare dhe ajo besoi në Jezusin si Shpëtimtarin e vet)
5. Përse nuk e besonte Simoni se Jezusi ishte profet nga Perëndia? (Sepse Jezusi e la gruan mëkatare ta prekte)
6. A besonte Simoni se ishte mëkatar si gruaja? (Jo)
7. Për kë tha Jezusi se do ta donin Atë më shumë – njerëzit që kishin nevojë për falje apo njerëzit që nuk besonin se ishin mëkatarë? (Njerëzit që e dinin se kishin nevojë për falje)
8. A e beson ti se je mëkatar?
9. A i ke kërkuar Jezusit të të shpëtojë nga mëkati? Cilat janë disa nga mënyrat që ti i tregon Atij se e do?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 9
Luka 9:18-26

Kupto si duhet:	Jezusi u mëson dishepujve të mos kenë turp.
Mendo si duhet:	"Sepse, unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson." Romakëve 1:16a
Vepro si duhet:	Unë nuk do të kem turp për Jezusin.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i guximshëm kur nuk kam turp për Jezusin.

PËRGATITU!

A e tregon me guxim lidhjen tënde me Jezusin? Shumica prej nesh, të paktën me raste, hezitojnë të flasin për besimin. Madje, ndodh që edhe të kemi turp nga Ungjilli. Na mësohet në Bibël që, si të krishterë, nuk duhet të kemi turp. Nuk kemi pse – ne kemi vetë fuqinë e Perëndisë me ne! Le të entuziazmohemi për shpalljen e guximshme të Krishtit tek një botë e humbur, ndërsa përgatitemi për mësimin e kësaj jave.

Lutu: Lutu që nxënësit e tu, pas këtij mësimi, të marrin një përkushtim për të qenë të guximshëm dhe për të shpallur lajmin e mirë të Jezusit.

Lexo: Luka 9:18-26

Kupto si duhet: Jezusi i mëson dishepujt e Tij të mos kenë turp
Ndërsa Jezusi vazhdonte shërbesën e Tij, njerëzit që dëshmonin mrekullitë e Tij të mëdha dhe dëgjonin mësimet e Tij me autoritet, pyesnin veten se kush ishte Ai dhe diskutonin mes tyre mundësitë. Jezusi i dinte hamendësimet e tyre, dhe një ditë, ndërsa kalonte kohë me dishepujt e Tij, Ai i përballi me një pyetje: "Kush thoni ju se jam Unë?" Kur Pjetri iu përgjigj se Ai ishte Mesia i Perëndisë, Jezusi i paralajmëroi dishepujt të mos kishin turp prej Tij, duke u shpjeguar se, nëse duam këtë jetë më shumë se Atë, do ta humbasim. Ky paralajmërim na ndihmon të jemi të guximshëm dhe të mos kemi turp për Jezusin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Nxënësit më të rritur: këtë pjesë shkruajeni në formën e dialogut dhe aktrojeni. Përfshiji të gjithë nxënësit duke i caktuar si dishepuj (vargjet 18, 23). Dërgojua nxënësve skenarin që të mund të praktikojnë leximin e pjesëve.
2. Ndërkohë që zhvillohet drama, herë pas here ngri lart një "tabelë stop" (aktorët duhet të ngrijnë) dhe bëju pyetje si: "Çfarë kuptimi kanë këto fjalë?". "A e patë çfarë ndodhi?", "Si mund ta vëmë në praktikë në jetën tonë sot?", "Si lidhet kjo me *Kohën* tonë *të Zbulimit*?", etj.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Pa turp!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të shpallim me guxim dhe të mos kenë turp për Jezusin.

Përkufizime:

- i guximshëm: pa frikë, i sigurt dhe me kurajë
- shpall: deklaroj ose them përpara njerëzve
- me turp: i turpëruar

Aktiviteti 1: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Plastelinë
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Shpjego që po kërkon një artist të madh, kampion të plastelinës! Nxënësit duhet të krijojnë katër vepra arti duke përdorur plastelinë. Për çdo sfidë do të kenë vetëm disa minuta në dispozicion. Duhet të punojnë shpejt dhe të bëjnë më të mirën me atë që kanë. Do të shohësh dhe do të shpallësh fituesin për çdo raund. Fituesi i çdo raundi do të marrë pesë etiketa shpërblyese.
2. Është thelbësore të kesh biseda me nxënësit, ndërsa japin ide vendndodhjeje dhe fillojnë të ndërtojnë. Mund të bësh pyetje si: "A do t'u tregoje të tjerëve në skuadrën e sportit për Jezusin?" dhe "A është e vështirë të flasësh për Jezusin në një shkollë publike?"

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Sfida 1: Kërkoju nxënësve të krijojnë një skenë të një vendi dhe kohe kur mund ta shpallin me guxim Jezusin përpara të tjerëve. (Të gjithë drejtuesit duhet të nxitojnë përreth dhe me qetësi t'u japin nxënësve ide nëse e kanë të vështirë të gjejnë një situatë, si për shembull: skuadra e sportit, shtëpia e tyre, parku, kisha etj.) Kur të përfundojë koha, shiko veprat e artit dhe cakto një fitues. Shpërbleje fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
4. Sfida 2: Kërkoju nxënësve të krijojnë një skenë të një situate ku mund të kenë turp, qoftë edhe pak, t'u tregojnë të tjerëve për Jezusin. (Të gjithë drejtuesit duhet të nxitojnë përreth dhe me qetësi t'u japin nxënësve ide nëse e kanë të vështirë të gjejnë një situatë, si për shembull: shtëpia e një miku, shkollë publike, festë ditëlindjeje, etj.) Kur të përfundojë koha, shiko veprat e artit dhe cakto një fitues. Shpërbleje fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
5. Sfida 3: Kërkoju nxënësve të krijojnë një fytyrë që reflekton se si ndihen ata kur shpallin me guxim Jezusin! Kur të përfundojë koha, shiko veprat e artit dhe cakto një fitues. Shpërbleje fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
6. Sfida 4: Kërkoju nxënësve të krijojnë një fytyrë që reflekton se si ndihen kur kanë turp për të folur për Jezusin. Kur të përfundojë koha, shiko veprat e artit dhe cakto një fitues. Shpërbleje fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
7. Cakto kampionin e madh dhe shpërbleje me pesë etiketa shpërblyese të tjera.

Shënim për mësuesin kryesor: Është shumë e rëndësishme të ecësh pranë nxënësve dhe t'i dëgjosh ndërsa krijojnë skenën. Përgjigjet dhe komentet mund të përdoren në mësimin e sotëm!

Aktiviteti 2: Stacioni i murit prej shkumësi

Mjetet:

- Shkumësa me shumë ngjyra (ndaje tabelën në dy pjesë, emërtoji gjysmat "djem" dhe "vajza")
- Shkallë e vogël (nëse duhet të arrijnë në majë të murit prej shkumësi)
- Ujë, sfungjerë, etj., për të pastruar tabelën me shkumës

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra – djemtë përballë vajzave.
2. Pyeti nxënësit se sa miq kanë dhe se sa njerëz njohin.
3. Sfidoji skuadrat të mbushin gjysmën e tyre të tabelës me emrat e miqve që kanë në shkollë, kurse, sporte apo në aktivitete të tjera (emrin dhe mbiemrin nëse është e mundur). Duhet ta bëjnë argëtuese... të përdorin shkronja të mëdha, të vogla, lloje të ndryshme shkrimi.
4. Pasi tabela të jetë plot, ose pasi të kenë kaluar tetë minuta, pyet nëse u kanë mbetur emra pa shkruar.
5. Kërkoju nxënësve të ulen dhe t'i shohin të gjithë emrat.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Pyet: “Cilët prej këtyre kanë dëgjuar për Jezusin në kishë?”
7. Kërkoju nxënësve të ngrihen dhe t’u vënë një vizë atyre emrave. Jepu dy minuta kohë për ta bërë këtë.
8. Kërkoju nxënësve të ulen dhe t’i shohin emrat përsëri.
9. Pyeti: “Sa prej fëmijëve të tjerë të kanë dëgjuar ta shpallësh me guxim lajmin e mirë të Jezusit?”
10. Kërkoju të ngrihen edhe njëherë dhe të vendosin një yll përreth emrave, të cilëve u kanë shpallur Jezusin me guxim. Jepu dy minuta kohë për ta bërë këtë.
11. Kërkoju nxënësve të ulen dhe të shohin tabelën.
12. Pyeti: “Po fëmijët që nuk kanë as një vizë e as një yll? A i do Perëndia ata? A kanë nevojë ata për lajmin e mirë të Jezusit?”
13. Cakto se kush ishin më të guximshëm në bazë të yjeve, djemtë apo vajzat. Inkurajoji të dyja grupet të luten për miqtë dhe familjarët e tyre dhe të jenë gati për të shpallur me guxim Jezusin.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit **-** *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 1-rë, tremujori i 2-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Kur mendon për shpalljen me guxim të lajmit të mirë të Jezusit, si ndihesh? A je i gëzuar që mund të ndash lajmin e mirë të Jezusit, apo je i frikësuar ose i trembur? Trego posterin e *Ndihu si duh*et dhe lejoji nxënësit të ndajnë shkurtimisht. Mendo për KZ-në. Në jetën e përditshme, sa i guximshëm je ti për të qenë i krishterë? A ka njerëz që ti mendon se nuk duhet ta njohin Jezusin? Përse? Le të mendojmë për këtë ndërsa studiojmë mësimin nga Bibla.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, krijo një lidhje me mësimin biblik.

Lutu: Kush do të donte të lutej me guxim dhe t’i kërkonte Perëndisë të na sfidojë të mësojmë më shumë dhe të afrohemi me Të këtë javë? Kërkoju dy nxënësve të luten.

Zbuloje: Pyeti nxënësit nëse Luka është në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. (Dh.R.) Shkruaj referencën e vargut, Luka 9:18, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t’i hapin Biblat te Luka 9:18. Mësoju se referenca është “adresa” e vargut në Bibël.

Kronologjia: Përdor kronologjinë për të rishikuar mësimet e kaluara deri tek i sotmi.

Prezantim me mësimin nga Bibla: Çfarë bëri Jezusi ndërsa ishte në tokë? Ai mësoi, predikoi dhe bëri shumë mrekulli të mëdha. Ai madje u dha dymbëdhjetë dishepujve të Tij fuqinë të shkonin dhe të bënin mrekulli ndërsa u tregonin njerëzve për Mbretërinë e Perëndisë! Disa njerëz, si gruaja për të cilën mësuam javën e kaluar, besuan se Jezusi ishte Shpëtimtari i dërguar nga Perëndia, dhe ajo e adhuroi. Të tjerët nuk e dinin se kush ishte Jezusi. Një ditë, ndodhi kjo...

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Luka 9:18-26

Jezusi pyet se kush mendojnë njerëzit se Ai është

Lexo Luka 9:18-19

Përmbledhje: Çfarë mendon ti? A ua bëri Jezusi dishepujve këtë pyetje sepse nuk e dinte përgjigjen? Apo Ai e bëri pyetjen sepse donte t'u mësonte dishepujve diçka të rëndësishme? (Ai donte t'u mësonte dishepujve diçka të rëndësishme; Jezusi tashmë e dinte përgjigjen e pyetjes) Kush menduan disa se ishte Jezusi? (Gjon Pagëzori, Elia ose një profet prej një kohe të gjatë)

Përse do të mendonin njerëzit se Jezusi ishte Gjon Pagëzori? Gjon Pagëzori ishte vrarë (i qe prerë koka) nga Herodi. Herodi ishte mbret në Jude. Disa njerëz mendonin se Jezusi ishte Gjoni, i ngritur prej së vdekurish. A ishte Jezusi Gjon Pagëzori i ngritur prej së vdekurish? (Jo)

Përse do të mendonin njerëzit se Jezusi ishte Elia? A ju kujtohet Elia nga Dhiata e Vjetër? (Ai ishte profeti i Perëndisë në Izraelin verior rreth 800 vite përpara se Jezusi të lindte) Trego këtë duke iu referuar kronologjisë biblike. A ju kujtohet se çfarë i ndodhi Elias? (Karroca dhe kuajt prej zjarri erdhën, dhe Elia u rrëmbye në qiell) Në Dhiatën e Vjetër, Perëndia tha se do ta dërgonte përsëri një ditë Elian, përpara se Shpëtimtari të vinte (Malakia 4:5). A ishte Jezusi Elia? (Jo)

Të tjerë menduan se Jezusi ishte një profet tjetër që ishte rikthyer në jetë. A ishte Jezusi një profet tjetër prej shumë kohe më parë? (Jo)

Po sikur t'i pyesje njerëzit në shkollë, në kurse, në skuadrën e sportit apo në lagje se kush besojnë ata se është Jezusi? Çfarë do të thonin? Ja disa përgjigje që japin njerëzit: "Ai është një personazh i trilluar. Ai nuk ka jetuar kurrë. Ai ishte një njeri i mirë. Ai ishte një mësues i mirë. Ai ishte një profet." Disa njerëz sot janë njësoj si njerëzit që jetonin në kohën e Jezusit!

Jezusi e dinte se çfarë po thonin njerëzit për Të. Ai e dinte se shumë njerëz nuk e besonin se Ai ishte Shpëtimtari. Por Ai kishte edhe një pyetje për dishepujt e Tij. Dëgjojeni.

Jezusi pyet dishepujt se kush mendojnë ata se është Ai

Lexo Luka 9:20

Përmbledhje: Pjetri tha se Jezusi ishte "Mesia i Perëndisë"! Mesia do të thotë "i zgjedhuri". A kishte të drejtë ai? (Po) Pjetri kishte të drejtë. Jezusi ishte Shpëtimtari i zgjedhur i Perëndisë. Ai ishte i Dërguari për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit tonë. Ishte e rëndësishme për dishepujt e Tij të dinin se çfarë do t'i ndodhte. Ja se çfarë u tha Ai.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi do të kryqëzohet dhe do të ringjallet në ditën e tretë

Lexo Luka 9:21-22

Përmbledhje: Jezusi u tha dishepujve të Tij se shumë nga drejtuesit fetarë nuk do të besonin tek Ai. Në fakt, ishte plani i Perëndisë që Jezusi të vdiste në kryq për mëkatet e njerëzve dhe të ringjallej në ditën e tretë. Dishepujt duhet ta kuptonin se ky ishte plani i Perëndisë dhe do të ndodhte. Pas kësaj, do të vinte koha për t'u treguar të gjithëve se Jezusi ishte Shpëtimtari. Më pas, Jezusi i paralajmëroi dishepujt të mos kishin turp prej Tij.

Jezusi na paralajmëron të mos kemi turp prej Tij

Lexo Luka 9:23-26

Përmbledhje: Çfarë donte të thoshte Jezusi kur tha këtë? Le të mendojmë disa situata në të cilat mund të kemi turp nga Jezusi. A ke ndonjëherë turp t'u tregosh fëmijëve të tjerë në shkollë se beson në Jezusin, për shkak se ke frikë se mund të mendojnë se nuk je "i shkathët"? A ke ndonjëherë turp të lutesh përpara të tjerëve për shkak se ata do të marrin vesh se je ndjekës i Jezusit dhe mund të të tallin? A ke ndonjëherë frikë të lexosh Biblën përpara të tjerëve, për shkak se mund të mendojnë se je i çuditshëm?

Kur dëgjon se një mik ka kaluar një ditë të keqe ose ka ndonjë problem, a ke turp ta pyesësh: "A mund të lutem për ty?" dhe pastaj të lutesh? Nëse mësuesja po shpjegon evolucionin në klasë, a ke turp të thuash: "Unë besoj se Perëndia e krijoi tokën?" Shto një shembull të shkurtër e të thjeshtë të një rasti kur ti mund të kesh pasur turp për Jezusin dhe Fjalën e Tij.

Kjo më kujton një faqe nga "Libri pa fjalë". Si do ta quaje rastin kur ke turp nga Jezus? (Mëkat) pikërisht! Është mëkat të kesh turp nga Jezusi.

Përfundimi

Jezusi tha se, nëse kemi turp prej Tij apo prej Fjalës së Tij për shkak të asaj që mund të mendojnë njerëzit, atëherë edhe Atij do t'i vijë turp prej nesh. Unë dua që Jezusi të jetë i lumtur me mua. Megjithatë, e di se ndonjëherë do të gaboj. Jam mirënjohës që, kur kjo ndodh, Ai më jep përsëri mundësi ta ndjek Atë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Përse është kaq e rëndësishme që ne të mos kemi turp nga Jezusi? Vargu nga *Mendo si duhet* na e jep përgjigjen. Le ta themi tani. Recitoni Romakëve 1:16. Është shumë e rëndësishme të mos kemi turp nga Jezusi, sepse Ai është e vetmja mënyrë që njerëzit të shpëtohen nga mëkati i tyre dhe të kenë jetë të përjetshme. Ai na do aq shumë, saqë mori ndëshkimin tonë dhe vdiq në vendin tonë. Përse të kemi turp nga kjo, pavarësisht se çfarë mund të mendojë dikush? Në vend që të ndiesh turp për Jezusin,

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

si mund të ndihesh që të ndash për Të me të tjerët? Mund të ndihesh i guximshëm! Le të ndalojmë pak dhe të ulim kokën. A je ti i guximshëm apo ke turp? Përse? Le të ndalemi dhe të lutemi në heshtje që Perëndia të na japë kurajë për të qenë të guximshëm për Të.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Kush mendonin disa njerëz se ishte Jezusi? (Gjon Pagëzori, Elia ose ndonjë profet tjetër)
2. Kush besonte Pjetri se ishte Jezusi? (Mesia i Perëndisë)
3. Çfarë tha Jezusi se do t'i ndodhte? (Ai do të vdiste në kryq për mëkatin e njerëzve dhe do të ringjallej në ditën e tretë)
4. Për çfarë i paralajmëroi Jezusi dishepujt e Tij? (Të mos kishin turp prej Tij apo prej Fjalës së Tij)
5. Cilat janë disa mënyra që tregojnë se ke turp për Jezusin? (Ke turp t'u tregosh njerëzve se beson në Të, ke turp të lutesh në publik, ke turp ta lexosh Biblën përpara të tjerëve, etj.)
6. Çfarë thotë Jezusi se do të ndodhë nëse kemi turp prej Tij apo prej Fjalës së Tij? (Ai do të ketë turp nga ne)
7. Përse është kaq e rëndësishme të mos kemi turp nga Jezusi dhe Fjala e Tij? (Sepse Ai është e vetmja mënyrë që njerëzit të shpëtojnë nga mëkati dhe të marrin jetë të përjetshme)
8. A do të kesh ti turp për Jezusin apo do të jesh i guximshëm?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 10
Luka 10:25-37

Kupto si duhet:	Jezusi mëson për samaritanin e mirë.
Mendo si duhet:	"Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!". Ky *është* i pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: "Duaje të afërmin tënd porsi vetveten." Nuk ka urdhërim të tjera më të mëdha se këto". Marku 12:30-31 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'i dua të tjerët.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i bindur kur i dua të tjerët.

PËRGATITU!

Çfarë do të thotë ta duash vërtet dikë? A bazohet në ndjenja? Apo në veprime? Apo në diçka tjetër? T'i duash vërtet të tjerët mund të jetë jashtëzakonisht sfiduese ndërsa kalojmë nëpër ulje-ngritjet e jetës. Në mësimin e kësaj jave, Jezusi përdor një shëmbëlltyrë bindëse për të na mësuar se si t'i duam të tjerët.

Lutu: Lutu që nxënësit e tu ta vënë në praktikë Markun 12:30-31 gjatë gjithë jetës së tyre.

Lexo: Luka 10:25-37

Kupto si duhet: Jezusi mëson për samaritanin e mirë

Përgjatë shërbesës së Jezusit, "ekspertët" në Ligjin e Perëndisë e testuan me pyetje për ta vënë në vështirësi. Një ekspert i tillë i bëri Jezusit pyetjen e drejtë, por me qëllimin e gabuar. Kur e pyeti Jezusin se çfarë duhet të bënte për të fituar jetën e përjetshme, Jezusi e pyeti se çfarë thoshte ligji, që është, të duash Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht. Në vend që, me përulje të pranonte se ishte i paaftë ta bënte këtë, eksperti u përpoq të gjente hapësira boshe në ligj. Jezusi iu përgjigj me shëmbëlltyrën e samaritanit të mirë. Ekperti dukej jo i gatshëm të kuptonte se po fliste me të vetmin që e donte vërtet Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht, dhe se gjithë të tjerët dështojnë në këtë. Vetëm kur besojmë tek Ai që e deshi Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht mund t'i duam vërtet të tjerët.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Fytyra në pjata plastike – vizato secilin prej personazheve në pjata plastike dhe ngjiti në tabelë ndërsa jep mësimin. Ndërsa shpjegon, përdor lapustila për të theksuar fytyrat me trupa, vendndodhje dhe ngjarje.
2. Përdor një hartë në klasë për të treguar rrugëtimin. Nënvizo zona të ndryshme dhe shpjego përse udhëtuan në atë rrugë specifike.
3. Përfshi "drama me zë". Cakto prindër ose drejtues që të përfaqësojnë personazhe të ndryshme në mësim. Përgatit nga një objekt për të përfaqësuar çdo person. Aktorët duhet të përdorin zë ndryshe dhe objekte specifike për secilin personazh. Për ta shtuar entuziazmin, caktoji çdo drejtuesi më shumë se një personazh, që të ndryshojnë zërin vazhdimisht.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: A ke dashuri?

Qëllimi: Për të rishikuar ose mësuar Markun 12:30-31.

Aktiviteti 1: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Postera të Markut 12:30-31 me foto nga fjalët kyç: "DUAJE" (formojeni fjalën duke përdorur plastelinë), një kryq (për Zotin), një zemër (për zemrën) dhe një shtëpi (për të afërmin) (burim i printueshëm)
- Ngjitës shirit (përdore për të ndarë tavolinat, në mënyrë që çdo grup me katër nxënës të ketë një pjesë të tavolinës)
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në grupe me nga katër persona.
2. Pyeti nxënësit nëse e dinë Markun 12:30-31. Jepi dy etiketa shpërblyese nxënësit të parë që reciton vargun pa e parë.
3. Kujtoju nxënësve të dëgjojnë me kujdes ndërsa ua lexon vargun me zë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Sfidoji grupet të krijojnë pamje 3D me plastelinë në “katrorin” e tyre. Pamjet 3D duhet të përfaqësojnë fjalët kyç në varg. Referoji nxënësit te posteri për ide. Për ta bërë më entuziazmuese dhe për të shtuar kuriozitetin, bëj sikur ky është një “emision gatimi” me kohë të kufizuar për krijimin e produktit.
5. Kujtoju nxënësve të jenë krijues dhe të punojnë si skuadër për të përfunduar brenda kufirit kohor.
6. Grupi që bashkëpunon më mirë dhe krijon pamjen më të mirë me plastelinë nga Marku 12:30-31 do të fitojë pesë etiketa shpërblyese për secilin.
7. Herë pas herë kujtoju se sa kohë u ka mbetur.
8. Pasi të ketë përfunduar koha, kërkoju nxënësve të ngrenë duart dhe të duartrokasin për projektin e skuadrës së tyre.
9. Aktro si të ishe juria dhe gjyko artin me plastelinë. Shto komente pozitive ndërsa sheh çdo pamje, zgjidh një fitues dhe shpërble me etiketat shpërblyese.

Aktiviteti 2: Stacioni i kutive



Mjetet:

- Dy grupe me nga 16 kuti, tek të cilat janë ngjitur pjesë nga vargjet e Markut 12:30-31 (printo me ngjyra ose printoje çdo grup në letra me ngjyra) (burim i printueshëm)
- Poster me vargjet e Markut 12:30-31 (burim i printueshëm); ose shkruaje vargun në një poster
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Sfidoji skuadrat ta thonë vargun “me zë të lartë”, Marku 12:30-31; shiko se cila skuadër e thotë me zë më të lartë.
3. Udhëzoji skuadrat t’i vendosin kutitë me fjalë sipas radhës që kanë në varg, duke filluar nga dyshemeja për në tavan, ndërsa inkurajon bashkëpunimin.
4. Skuadra e parë që i radhit siç duhet kutitë, fiton nga tre etiketa shpërblyese për secilin.
5. Përsëriteni nëse keni kohë.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit **-** *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 1-rë, tremujori i 2-të.*

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Kur mendon për Markun 12:30-31, çfarë të vjen në mendje? Përse? Jepu kohë për diskutime të shkurtra. Le të mendojmë pak se si mund ta kishit zbatuar këtë varg në jetën tuaj këtë javë. A është e lehtë apo e vështirë t'i duash të tjerët? Përse? Jepu mundësinë të kenë diskutime të shkurtra. Në mësimin e sotëm, do të mësojmë se çfarë thotë Jezusi për këtë varg.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, krijo një lidhje me mësimin biblik.

Lutu: Kërkoju nxënësve të luten për fokusin e misionit në këtë tremujor, gjithashtu të luten që të mësojnë më shumë nga Fjala e Perëndisë sot.

Zbuloje: Pyeti nxënësit nëse Luka është në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. (Dh.R.) Shkruaj referencën e vargut, Luka 10:25, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 10:25.

Kronologjia: referoju periudhës historike në kronologjinë e Biblës.

Prezantim me mësimin nga Bibla: A ju kujtohet që para dy javësh mësuam për darkën e Jezusit në shtëpinë e Simon fariseut? Gruaja mëkatare erdhi dhe adhuroi Jezusin në shtëpinë e Simonit. Përse i fshiu gruaja këmbët e Jezusit me lotët dhe flokët e saj, dhe pastaj i puthi dhe u hodhi parfum? Sepse ajo e dinte se ishte mëkatare dhe se Jezusi ishte Shpëtimtari. Por Simon fariseu nuk e kuptonte se kush ishte Jezusi, apo jo? Pjesa më e madhe e drejtuesve fetarë, që duhet të ishin "ekspertë" dhe të dinin shumë për Ligjin e Perëndisë, nuk besonin se Jezusi ishte Shpëtimtari.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 10:25-37

<u>Një ekspert i ligjit vë në provë Jezusin</u>

Lexo Luka 10:25

Përmbledhje: Çfarë pyetjeje i bëri burri Jezusit? (Çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetë të përjetshme?) Përse e bëri atë pyetje? A donte vërtet të dinte përgjigjen apo thjesht pyeti për të vënë në provë Jezusin që të shihte se çfarë do të thoshte? (Ai pyeti për të vënë në provë Jezusin) Ky njeri mendonte se ishte ekspert i Ligjit të Perëndisë. Ai mendonte se e njihte Ligjin e Perëndisë më mirë se Jezusi. A njeh ndonjë njeri Ligjin e Perëndisë më mirë se Jezusi? (Jo) Në vend që t'i jepte atij një përgjigje, Jezusi i bën një pyetje. Dëgjojeni.

<u>Jezusi vë në provë ekspertin</u>

Lexo Luka 10:26

Përmbledhje: Jezusi donte që eksperti t'i tregonte Atij Ligjin. Shikoje pak nëse ju duket e dëgjuar përgjigjja e ekspertit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Eksperti citon Dhiatën e Vjetër

Lexo Luka 10:27

Përmbledhje: Vargu është pothuajse njësoj me Markun 12:30-31! Ai shpjegon se për çfarë flet Ligji i Perëndisë. Duhet ta duam Perëndinë dhe të tjerët në çdo kohë! Pastaj Jezusi tha...

Eksperti ka të drejtë

Lexo Luka 10:28

Përmbledhje: Jezusi i tha ekspertit se përgjigjja e tij ishte e drejtë. Ligji i Perëndisë na thotë të duam Perëndinë dhe të duam të tjerët përsosmërisht, me gjithçka kemi, në çdo kohë. Jezusi i tha atij të donte Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht dhe kështu do të kishte jetë të përjetshme.

Pyetje: A ishte e mundur që ai njeri të donte Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht? (Jo) A është e mundur që ne ta duam Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht? (Jo)

Çfarë mendoni se duhej të kishte thënë eksperti në këtë pikë? Ai duhet të ishte treguar i përulur dhe të thoshte: "Por Jezus, unë nuk mund të dua Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht! Askush nuk mund ta bëjë këtë! A do të thotë kjo se nuk mund të kem jetë të përjetshme?" Megjithatë, edhe pse eksperti e dinte se nuk i donte të tjerët përsosmërisht, ai i bën Jezusit një pyetje tjetër.

Eksperti dëshiron të dijë se kush është i afërmi i tij

Lexo Luka 10:29

Përmbledhje: Duke qenë se eksperti e dinte se nuk i donte të tjerët përsosmërisht, ai donte të dinte se kush ishte i afërmi i tij. Duke qenë se ishte jude, ndoshta donte të thoshte se duhej të donte vetëm judenjtë e tjerë që jetonin pranë tij.

Prifti dhe leviti nuk e ndihmojnë burrin e plagosur

Për t'iu përgjigjur pyetjes, Jezusi tregoi një histori për dy judenj dhe një samaritan. Shumë judenj i urrenin samaritanët, sepse ishin vetëm pjesërisht judenj. Edhe shumë samaritanë nuk i pëlqenin judenjtë. Dëgjoni shëmbëlltyrën që tregon Jezusi.

Lexo Luka 10:30-32

Përmbledhje: Jezusi nuk e tregoi se kush ishte i plagosuri – thjesht që e kishin lënë të vdiste. Si mendoni – a duhej ta kishte ndihmuar prifti? (Po) Por nuk e bëri. Po Leviti? Levitët janë ndihmësit e priftërinjve. A duhet ta kishte ndihmuar ai burrin? (Po) Por nuk e bëri. Edhe dikush tjetër kaloi aty pranë. Le të vazhdojmë të lexojmë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Samaritani është i afërmi

Lexo Luka 10:33-37

Përmbledhje: Ishte e vështirë për judeun ekspert të dëgjonte se njerëzit fetarë nuk e ndihmuan të plagosurin, por samaritani, ai që judenjtë urrenin, e ndihmoi. Samaritani ishte ai që e deshi të plagosurin ashtu siç Perëndia do që ne të duam të tjerët. Jezusi ia tregoi ekspertit jude këtë histori që ai të kuptonte se ishte mëkatari që kishte nevojë për një Shpëtimtar. Kur Jezusi tha: "Shko dhe bëj kështu edhe ti", eksperti kishte edhe një mundësi tjetër të pranonte dhe të rrëfente se ishte mëkatar. Ai duhej të ishte penduar për mëkatin e tij dhe të besonte në Jezusin si Shpëtimtarin e tij. Bibla nuk na e tregon nëse ai e bëri këtë.

Përfundimi

Jezusi donte që njerëzit të dinin se standardi i Perëndisë është të duam Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht. Jezusi e di se asnjë prej nesh nuk mund ta bëjmë këtë vetë. Prandaj erdhi Ai dhe e bëri për ne. Ai e deshi Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht.

Tani mendoje veten si personi që u sulmua nga hajdutët dhe u la të vdiste në anë të rrugës. Jezusi është si samaritani. Ai të do përsosmërisht. Ai të gjeti, Ai do të kujdeset për ty dhe Ai pagoi çmimin, që jeta jote të shpëtohet.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Perëndia do që ta duam njëri-tjetrin dhe Ai do të na ndihmojë ta bëjmë. Gjëja e parë që duhet të bëjmë është të besojmë në Jezusin për shpëtim nga mëkati dhe ta bëjmë Atë udhëheqësin e jetës sonë. Kur e bëjmë këtë, ne marrin Frymën e Shenjtë, i cili do të na ndihmojë të duam të tjerët siç bën Jezusi. Kur ne i duam të tjerët me ndihmën e Perëndisë, do të ndihemi të bindur, dhe duke dashur të tjerët ne tregojmë se duam Atë!

A ke besuar në Jezusin për të të shpëtuar nga mëkati? Le të sigurohemi se e kupton çfarë do të thotë kjo. Shpall Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe ftoji nxënësit të luten për shpëtim.

Ata që kanë besuar në Jezusin kanë Frymën e Shenjtë brenda tyre, që na ndihmon të duam të tjerët siç i pëlqen Perëndisë. Le të flasim për disa mënyra se si mund t'i duam të tjerët. Nxit një bisedë të shkurtër me shembuj të përshtatshëm për moshën. Nëse mundesh, jep shembuj personalë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë pyetjeje i bëri eksperti i ligjit Jezusit? (Çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetë të përjetshme?)
2. Çfarë pyetjeje i bëri Jezusi ekspertit të ligjit? (Çfarë thotë Ligji i Perëndisë?)
3. Çfarë thoshte Ligji i Perëndisë? (Duaj Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht)
4. Kush ishte i vetmi që e deshi Perëndinë Atë dhe të tjerët përsosmërisht? (Jezusi)
5. Në historinë e Jezusit për samaritanin, kujt i përngjan ti? (Njeriut që u sulmua dhe u la të vdiste)
6. Kujt i përngjan Jezusi? (Samaritanit që shpëtoi njeriun e plagosur)
7. Çfarë bëri Jezusi për të na shpëtuar? (Ai na deshi përsosmërisht dhe vdiq për mëkatin tonë)
8. Cila është mënyra e vetme si mund t'i duam të tjerët siç i pëlqen Perëndisë? (Duhet të besojmë në Jezusin për shpëtim nga mëkati dhe ta bëjmë Atë Udhëheqësin e jetës sonë)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 11
Dita e përsëritjes (Futbolli i përsëritjes)

Kupto si duhet:	Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht." 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të kujtoj Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i urtë kur kujtoj Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

Ndërsa përgatitemi për mësimin e fundit të këtij tremujori, le të lavdërojmë Perëndinë për mënyrat si e kemi parë të veprojë në jetën tonë dhe në jetën e nxënësve tanë! Çfarë ke mësuar këtë tremujor? Si janë rritur nxënësit në të kuptuarit e Perëndisë dhe Fjalës së Tij këtë tremujor? Çfarë privilegji është të ndajmë Fjalën e Perëndisë me brezin e ardhshëm!

Lutu: Lavdëro Perëndinë që na ka dhënë Fjalën e Tij. Lutu për nxënësit e tu, që të vënë në praktikë atë që kanë mësuar këtë tremujor.

Lexo: Rishiko tremujorin.

Kupto si duhet: Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë
Ndërsa i afrohemi fundit të një tremujori tjetër, ne marrim një ditë për të kujtuar e përsëritur gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Pas dy javësh do të rikthehemi te libri i Lukës, për të vazhduar studimin e jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit, gjithashtu do të nisim studimin e jetës së apostullit Pal në librin e Veprave.

BËHU GATI!

Shënim: *Kur nxënësit të arrijnë në klasë, vëru tek dora një shenjë me dy ngjyra të ndryshme, për t'i ndarë në dy skuadra me aftësi të barabarta. Kjo do të të kursejë kohë kur të arrijnë në klasë për futbollin e përsëritjes.*

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit

Shënim: Nuk do të ketë *Kohë zbulimi* këtë javë. Në fund të adhurimit, kërkoji një aktori të jetë "trajneri kryesor". Trajneri duhet të vijë dhe të pyesë grupin: "A jeni gati për futboll?!" Trajneri i drejton nxënësit të bëjnë dhjetë hedhje, dhjetë pompa dhe dhjetë ushtrime barku. Pasi të kenë përfunduar, kërkoju nxënësve të vrapojnë në vend dhe pastaj të rreshtohen me mësuesen dhe të drejtohen për në klasë.

Futbolli i përsëritjes!

Mjetet dhe ambienti:



- Pyetjet e përsëritjes së mësimit dhe hartës së gjurmuesit (shih shtojcën; mund t'i kthesh pyetjet e thjeshta në pyetje me alternativa, plotësim të hapësirave bosh ose pyetje 'e vërtetë/e gabuar', në bazë të aftësive të nxënësve)
- Fusha e futbollit (një rrugicë e gjatë jeshile me viza ndarëse të bardha)
- Karrige për skuadrat, të vendosura përgjatë dy anëve të fushës së futbollit
- Tabelë për pikët (dërrasa e zezë ose tabelë e vogël)
- Top i vogël futbolli që do të jetë shënuesi i lojës
- Alternativë: kokoshka, pije ose sanduiçë për pushimin

Drejtuesit:

- Vishni fanella futbolli ose uniformë arbitri dhe vendosni muzikë argëtuese në sfond. Bëjeni argëtuese dhe futuni në temë.
- Në faqen e internetit të "Discovery Land" mund të gjeni dy video udhëzuese për këtë lojë. Njëra është video shembull dhe titullohet "Footbal Review Game". Videoja tjetër është një shpjegim hap pas hapi dhe titullohet "Football Review with leaders". Flisni me drejtuesit e shërbesës që të mund t'i siguroni këto video.
- Përpara mësimit, mësuesi kryesor duhet të caktojë rolet në bazë të aftësive. Për shembull: Mësuesi kryesor bën pyetjet, drejtuesi i KZ-së lëviz topin në fushë, motivon skuadrat dhe ndihmon me lëvizjen e nxënësve, Bariu shënon pikët, është arbitër kur ka nevojë dhe mund të ndihmojë nxënësit më të turpshëm.

Udhëzime:

1. Kërkoju nxënësve të ulen në karriget e skuadrës kur të hyjnë në klasë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Emrat e skuadrës do të jenë ngjyrat me të cilat keni shënuar në duart e tyre kur kanë ardhur, siç mund të jetë “e kuqe” përballë “blu”.
3. Vendoseni topin në vijën e parë të fushës, dhe secila skuadër duhet të dijë se cila anë e fushës është e tyre.
4. Drejtuesi që bën pyetjet duhet të qëndrojë në fund të fushës.
5. Dy karriget e vendosura më pranë drejtuesit që bën pyetjet janë “karriget e pyetjeve”. Kur të bëhet pyetja, nxënësit e ulur te këto karrige duhet të hidhen nëse e dinë përgjigjen. Nxënësi që hidhet i pari mund të përgjigjet.
6. Informoji nxënësit se secila përgjigje e saktë nga nxënësit në karrigen e pyetjeve, do ta çojë topin 18 metra përpara në fushë për skuadrën. Nëse përgjigjja nuk është e saktë, përparon skuadra tjetër. Për ta, përgjigjja vlen gjysmën e largësisë (9m). Nëse asnjëri nga nxënësit nuk e di përgjigjen, nxënësi i parë nga pjesa tjetër e nxënësve që hidhet nga karrigia mund të fitojë 4.5 metra për skuadrën e vet.
7. Nëse nxënësi përgjigjet saktë për pyetjen, drejtuesi i KZ-së do ta lëvizë topin në drejtimin e fushës së skuadrës.
8. Kur të përfundojë raundi, drejtuesi i KZ-së duhet të bërtasë “Nisuni!” dhe nxënësit duhet të ndërrojnë karriget. Mënyra e ndërrimit: nxënësit e ulur në karriget e pyetjeve duhet të shkojnë në karrigen e fundit të anës së tyre të fushës. Të gjithë të tjerët afrohen një karrige më pranë karrigeve të pyetjeve. Skuadra e parë që përfundon ndërrimin e karrigeve fiton 1 pikë për skuadrën (jo përparim në fushë, thjesht pikë në tabelë). Kjo i mban nxënësit të përfshirë, e bën lojën argëtuese dhe siguron që të gjithë nxënësit marrin pjesë.
9. Përsëriti pyetjet derisa të arrihet fundi i fushës nga njëra skuadër.
10. Kur të arrihet fundi, jepi skuadrës 7 pikë.
11. Përsërite lojën duke nisur nga pika 3.

Këshilla për personin që bën pyetjet:

1. Gjatë 10 minutave të para, bëj pyetje të shpejta nga harta e gjurmuesit për të bërë nxehjen.
2. Kalo te pyetjet e përsëritjes të mësimeve nga Bibla. Nënvizo paraprakisht pyetjet e tua të preferuara, duke qenë se nuk do të kesh kohë t’i bësh të gjitha.
3. Gjatë pesë minutave të fundit, riktheju pyetjeve të hartës së gjurmuesit për ta bërë lojën më entuziazmuese dhe për të shtuar kureshtjen.
4. Bëj pauza të shkurtra për të shpjeguar pyetjet që nxënësit nuk i kuptojnë mirë.
5. Përpiqu t’i vendosësh nxënësit e rinj përballë njëri-tjetrit. Bëju pyetje të thjeshta ‘e vërtetë/e gabuar’, ose pyetje si: “Në mësim kemi studiuar një libër të saktë historik të quajtur _____.”
6. Gjatë pushimit, kur nxënësit të jenë duke shijuar diçka për të ngrënë, rishikoni “Librin pa fjalë”.
7. Në fund të lojës, mblidhi studentët në rreth dhe thoni njëzëri: “Fitore Jezusi!”

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 12
Dita e testit

PËRGATITU!

Kemi ardhur në këtë periudhë të vitit, ku bëjmë një testim bazë për nxënësit. Duam të gjithë që nxënësit tanë të kenë njohuri biblike, të besojnë në Krishtin për shpëtimin e tyre dhe të vazhdojnë të rriten në marrëdhënien e tyre me Të. Kjo është një mundësi shumë e mirë për të zbuluar se si po vepron Perëndia në jetën e tyre, dhe ku mund të dojë Ai që të përqendrohemi pjesën tjetër të vitit. Javën e ardhshme, do të rikthehemi te libri i Lukës për të vazhduar studimin për jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit; gjithashtu edhe studimin e apostullit Pal te libri i Veprave.

Lutu: Lutu për secilin nxënës me emër. Kërkoji Perëndisë t'i mbrojë frymërisht, fizikisht dhe emocionalisht. Disa nxënës mund të jenë duke kaluar situata të vështira, disa të tjerë kanë jetë të shkëlqyer, megjithatë, pavarësisht situatës, ata duhet të kuptojnë se Perëndia i do dhe ka një plan për jetën e tyre.

BËHU GATI!

Shënim: Fjala "testim" mund të duket pak e frikshme dhe nuk është tipike për ambientin e kishës! Përpara testimit është e rëndësishme të kuptojmë zemrën dhe qëllimin e tij. Së pari, duam të të përgëzojmë ty dhe skuadrën tënde për orët e pafundme që keni kaluar duke planifikuar dhe duke u përgatitur çdo javë. Së dyti, e dimë se çdo javë ju e ftoni Frymën e Shenjtë të lëvizë fuqishëm në klasën tuaj. Perëndia ka vepruar dhe po vepron – inkurajohuni!

Atëherë, përse bëhet testimi?

1. Ndihmon në testimin e efektshmërisë së kurikulës.
2. Ndihmon të zbulojmë se si t'i trajnojmë dhe pajisim më mirë drejtuesit.
3. Për të matur rritjen e nxënësve në njohuritë biblike dhe zbatimin në praktikë të tyre.
4. Vendos një shenjë, një standard për pritshmëritë në klasë.
5. I ndihmon prindërit të dinë dhe të kuptojnë çfarë u mësojmë fëmijëve dhe i inkurajon ata të përforcojnë atë që u mësohet në klasë, duke përdorur "Thesaret e gjurmuesit" në shtëpi. I ndihmon të kuptojnë se si lidhen të gjitha me njëra-tjetrën.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit

Shënim: Nuk do të ketë Kohë Zbulimi këtë javë për shkak të testimit.

Dita e Testimit në klasë

Udhëzime për testimin:
Menjëherë pas adhurimit, të gjithë nxënësit ulen në vendet e tyre për testin.

- Jepu lapsa.
- Mbuloje/hiqe kronologjinë e Biblës dhe posterat e 12 vargjeve kyç. Nxënësit nuk duhet t'i përdorin Biblat.
- Testimi duhet bërë në bazë të nivelit shkollor dhe/ose nivelit të leximit të nxënësve. Testi ka pyetje nga temat e hartës së gjurmuesit, si "Libri pa fjalë", librat e Biblës, Dhiata e Re përballë Dhiatës së Vjetër, gjithashtu edhe pyetje përsëritëse të mësimeve nga ky tremujor dhe nga tremujori i kaluar. Testi përfshin gjithashtu 12 vargjet kyç dhe çështje për zgjidhje nga jeta praktike.
- Inkurajoji nxënësit të bëjnë më të mirën, duke qenë se testi do t'u jepet prindërve. Kujtoju gjithashtu se komunikimi i asaj që kanë mësuar nga Bibla është më i rëndësishëm se shkrimi apo gramatika.
- Shpjegoju nxënësve që testi është nga të dyja faqet.
- Kur nxënësit të përfundojnë testin, mund të punojnë me kërkimin e fjalëve që përfshihet në test.



- Pas testit, bëj një lojë përsëritjeje dhe/ose bëj një festë të vogël.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Ata që janë për herë të parë nuk duhet të bëjnë testin. Ja disa ide alternative për t'i përfshirë:
  - Njihu me ta. Bëju pyetje të thjeshta rreth tyre (familja, shkolla, interesat, kisha, etj). Tregoju gjithashtu edhe për veten tënde.
  - Tregoju hapësirën e shërbesës së fëmijëve.
  - Shpall Ungjillin duke përdorur fletëshkën "E beson apo jo" dhe bëju një byzylyk me ngjyrat e "Librit pa fjalë".



  - Jepu një libërshënues me 12 vargjet kyç, shpjegoju se çfarë janë 12 vargjet kyç dhe përpiqu t'u mësosh vargun nga Gjoni 14:6 në mënyra argëtuese.
  - Pyeti nëse kanë Bibël (jepu një nëse nuk kanë). Mësoju disa mënyra të thjeshta për ta lexuar Biblën (Dhiata e Vjetër dhe e Re, librat/kapitujt/vargjet). Ndihmoji të gjejnë pasazhin nga Bibla që do të studiojnë javën e ardhshme dhe të vendosin aty libërshënuesin.
- Drejtuesit zgjedhin nëse do t'ua japin përgjigjet e testit prindërve, javën e ardhshme.

Ju lutem kini parasysh: E kuptojmë se ka nxënës që e kanë të vështirë të lexojnë dhe të kuptojnë testet. E dimë gjithashtu që ka nxënës që nuk vijnë rregullisht. Këta faktorë, e të tjerë, duhen marrë në konsideratë ndërsa përpiqesh të forcosh trajnimin dhe mentorimin e nxënësve për të qëndruar të fortë për Krishtin në botën tonë.

Ta bëjmë ditën e testit argëtuese dhe të efektshme!

1. Merrni diçka për të ngrënë për nxënësit.
2. Jepuani fletët me radhë nxënësve.
3. Nëse disa nxënës kanë vështirësi në lexim, kërkoji Bariut ose drejtuesit të KZ-së t'i marrë nxënësit në korridor për t'ua bërë pyetjet dhe, nëse është e nevojshme, t'i ndihmojnë t'i shkruajnë përgjigjet.
4. Para se të fillojë testi, bëni disa ushtrime për nxehje.
5. Lejoji nxënësit të bëjnë pyetje gjatë testit nëse kanë nevojë.
6. Rekomandojmë të mos lajmëroni për testin, sepse disa nga nxënësit mund të mos vijnë.
7. Inkurajojini vazhdimisht gjatë testit duke u thënë: "Ju lumtë!" ose "E di që po punoni fort!".
8. Jep etiketa shpërbyese për ata që janë përqendruar vërtet tek testi.
9. Nëse një nxënës ka vështirësi, ji proaktiv dhe kërkoji të punojë me një drejtues në një ambient tjetër. Mos ua jep përgjigjet, por lexo pyetjet dhe ndihmoji t'i kuptojnë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

SHTOJCA

Harta e gjurmuesit

Mësim tematik: Bibla është e vërtetë

Kupto si duhet:	Bibla është e vërtetë, sepse është Fjala e Perëndisë.
Mendo si duhet:	"I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim në drejtësi." 2 e Timoteut 3:16-17
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se Bibla është e vërtetë, sepse ajo është Fjala e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndiej paqe kur besoj se Bibla është e vërtetë.

PËRGATITU!

Ky mësim është përpiluar për t'i ndihmuar nxënësit që të mund të artikulojnë faktin se ajo që gjendet në Bibël është e vërtetë. Kur t'i pyesin se përse besojnë që Bibla është e vërtetë, ata duhet të jenë të sigurt në të vërtetën e saj, dhe të përgatitur për të shpjeguar faktet. Perëndia e orkestroi shumë bukur historinë për të provuar autenticitetin e Biblës. Ai e dinte se njerëzit do të kishin pyetje dhe siguroi mënyra të mrekullueshme që ne të kemi bindjen se Bibla është Fjala e Tij dhe është e besueshme. Këtë javë kalo kohë duke lavdëruar Perëndinë për Fjalën e Tij, Biblën.

Lutu: Lutu që Perëndia të të japë një kuptim të qartë të Shkrimit dhe që nxënësit e tu të kuptojnë vërtet që Bibla është e vërtetë.

Lexo: 2 e Timoteut 3:16-17

Kupto si duhet: Bibla është e vërtetë, sepse ajo është Fjala e Perëndisë

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Shpeshherë nxënësit pyesin: "Si e di ti që Bibla është e vërtetë?" Ky mësim trajton këtë pyetje dhe jep prova që ata të mund t'i përdorin nesër në shkollë.
- Përdor objekte që nxënësit të mbajnë mend çdo pikë kyç. Përsërite shpesh, në mënyrë që nxënësit t'i japin përgjigjet me bindje.
- Inkurajoji t'u përgjigjen njerëzve për arsyet se përse ata besojnë, me një mënyrë respektuese dhe me dashuri.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Përdor këto objekte ndërsa shpjegon mësimin: një pikturë me një set bojërash, një libër historik dhe zhurmën e thyerjes së xhamit (video që gjenden në Youtube). Ndërsa tregon se si u gjetën pergamenat e Detit të Vdekur, kërkoji një nxënësi të të ndihmojë për të vendosur zhurmën e "thyerjes së xhamave"; tingulli do t'i bëjë veprimet e bariut shumë më të vërteta.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Ndërtimi i kullës!

Qëllimi: T'u japim nxënësve mundësinë për të mësuar librat e Biblës.

Aktiviteti 1: Në hapësirë të madhe



Mjetet:

- Ngjitës (skoç)
- Listë e librave të Biblës (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Bëj dy viza paralele me ngjitës në dysheme rreth 30 – 45 cm larg njëra-tjetrës, mjaftueshëm të gjata që midis tyre të qëndrojnë nxënësit.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Kërkoju të gjithë nxënësve të qëndrojnë midis shiritave me ngjitës.
2. Shpjego rregullat: Do të përmendësh me radhë librat e Biblës. Nëse libri është në Dhiatën e Re, të gjithë nxënësit do të hidhen në të djathtë të ngjitësit, duke i mbajtur këmbët mbyllur. Nëse libri është në Dhiatën e Vjetër, të gjithë nxënësit do të hidhen në të majtë të ngjitësit. Ti do të konfirmosh përgjigjen e saktë dhe pastaj nxënësit do të hidhen në qendër përpara se të thuash librin tjetër.
3. Thuaji gjithnjë e më shpejt emrat e librave, duke u bazuar në shpejtësinë e përgjigjes së nxënësve.
4. Pas disa raundesh praktikë, kërkoju nxënësve të hidhen në anën e gabuar.
5. Kur të ketë përfunduar koha, nxënësi/it i/e fundit në lojë, do të marrë/in pesë etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Në hapësirë të madhe (me një tavolinë nëse do të përdorni gota)

Mjetet:

- Posterat e librave të Biblës (burim i printueshëm)
- Kuti ose gota plastike (shkruaj librat e Dhiatës së Re te kutitë apo te gotat plastike; për nxënësit më të rritur, shkruaj edhe librat e Dhiatës së Vjetër) – nga një set për çdo skuadër
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra. Secila skuadër ka nevojë për një set me kuti ose gota plastike.
2. Nxënësit do të garojnë për t'i vendosur librat sipas radhës, te kutitë apo gotat. Nëse kanë nevojë, mund t'u referohen posterave, por kjo do t'i ngadalësojë!
3. Skuadra e parë që fiton, do të marrë nga dy etiketa shpërblyese secila.
4. Përsërite nëse ta lejon koha.
5. Mundësi: Pas raundit të parë, hiq posterat nga muri.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Në aktivitetin e 'Kohës së zbulimit' duhet t'i dinit vërtet mirë librat e Dhiatës së Re (dhe të Dhiatës së Vjetër)! A e dini se Bibla përbëhet nga 66 libra? Perëndia i ndihmoi njerëzit t'i vendosnin librat sipas një rendi specifik, që të drejtojnë te Jezusi dhe që ne të kuptojmë më mirë Perëndinë. Jezusi erdhi në tokë për të na treguar si mund të kemi një marrëdhënie me Perëndinë pasi u ndamë për shkak të mëkatit tonë. Kur Perëndia dërgoi Jezusin për të na shpëtuar, Ai e bëri këtë sepse na do shumë. Bibla është letra e dashurisë së Perëndisë për ne.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Kujtoju se është një privilegj të lutesh dhe të drejtosh në lutje*. Kur ne lutemi, Perëndia i universit dëgjon fjalët e çdo personi. Dhe kur ne lutemi së bashku është një tingull shumë i bukur, si një kor lutjesh për Perëndinë.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Bibla nuk është një thes me përralla apo me histori të trilluara. Njerëzit e Biblës jetuan vërtet. Moisiu, Noeu, Pjetri, Jona dhe Pali ishin njerëz të vërtetë, njësoj si ti dhe unë. Bibla është e vërtetë! Por si ta dimë se është e gjitha e vërtetë? Nëse dikush do të të pyeste se si e di ti që Bibla është e vërtetë, çfarë do t'i thoshe? Është shumë e rëndësishme që të mund të ndajmë me të tjerët se si e dimë se ajo që është shkruar në Bibël është e vërtetë. Çfarë teme interesante! Perëndia na ka dhënë shumë mënyra për të vërtetuar se Fjala e Tij është e vërtetë. Le të shohim pesë mënyra të veçanta.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi

Bibla u shkrua nga shumë njerëz me mënyra të ndryshme jetese, me nivele të ndryshme edukimi, me kultura dhe kombësi të ndryshme.

Imagjino një artist. Artistët përdorin bojëra, lapustila, lapsa apo bojëra dhjami me ngjyra të ndryshme për të krijuar diçka të bukur. Perëndia përdori njerëz të ndryshëm për të krijuar Biblën.

Bibla është ndryshe nga çdo libër tjetër. Është libri për të cilin Perëndia frymëzoi njerëz të caktuar që ta shkruanin, në mënyrë që të gjithë ta njihnin Atë. Librat e tjerë flasin për Perëndinë, ndërsa Bibla është Perëndia që flet me ne përmes këtyre fjalëve. Përmes Frymës së Shenjtë, Perëndia foli në mendimet e çdo shkrimtari, që të mund të komunikonin të njëjtin mesazh që Perëndia donte të jepte. Është i vetmi libër që vërtet është frymëzuar nga Perëndia. Kjo më kujton vargun e "Mendo si duhet". ***Lexo 2 e Timoteut 3:16-17.***

Librat që përdorin fetë e tjera si shkrime të shenjta janë shkruar nga vetëm një person. Një person mund të shkruajë një libër dhe të thotë çfarë të dojë në të. Askush nuk i kërkon llogari. Nuk u kërkohet ta kontrollojnë librin dhe të sigurohen nëse gjithçka kanë thënë është e vërtetë përpara se ta publikojnë. Njerëzit që shkruan Biblën ishin shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Kishin punë të ndryshme. Ishin rritur në mënyra të ndryshme. Jetonin në shtete të ndryshme. Duke qenë se Biblën e shkruan kaq shumë njerëz të ndryshëm – në fakt, 40 persona – pritshmëria është se do të ketë gjëra për të cilat nuk do të binin dakord, por nuk ndodhi ashtu. Në mendje të shkon fakti se mund të kenë debatuar me njëri-tjetrin. Por nuk e kanë bërë. Duke qenë se Biblën e kanë shkruar shumë njerëz, ne mund t'i vendosim përballë njëri-tjetrit. Të gjithë do të jenë dakord me njëri-tjetrin!

Mënyra e parë për të ditur se Bibla është e vërtetë është fakti që 40 njerëz të ndryshëm ishin pjesë e shkrimit të saj. Mënyra e dytë është...

Bibla nuk ka ndryshuar

Sill dhjetë nxënës përpara klasës për të luajtur një lojë me pëshpëritje. Disa e quajnë 'Telefoni i prishur'. Do të pëshpëritësh një fjalë në veshin e nxënësit të parë: "Macja u fut në një kuti dhe pastaj e dërguan me postë jashtë vendit." Nuk u lejohet ta përsërisin fjalinë nëse dëgjuesi nuk e ka dëgjuar mirë. Personi i parë do të kthehet tek i dyti dhe do të përsërisë atë që mendon se dëgjoi. Vazhdoni ta bëni këtë derisa të gjithë ta kenë dëgjuar dhe përçuar mesazhin. Tregoni atë që dëgjoi personi i fundit. Përgatituni për të qeshura.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Në vetëm pak minuta, fjalia origjinale ndryshoi shumë. A e imagjinon dot se çfarë do të ndodhte nëse do të kalonim në të njëjtën mënyrë një mesazh shumë më të rëndësishëm për qindra vite? Ka shumë mundësi që çdo fjalë të jetë ndryshe!

Më lejoni t'ju tregoj se çfarë ndodhi shumë vite më parë. Në vitin 1947, para se prindërit e tu, ndoshta edhe gjyshërit, të kishin lindur, diçka e mrekullueshme ndodhi, diçka që bindi shumë jobesimtarë se Bibla është e vërtetë. Në kodrat shkretinore jashtë Jerusalemit, një bari la tufën e tij për të gjetur një kafshë të humbur. Ai kërkoi ngado, madje edhe te shpellat që ishin hapur jashtë kodrave shkëmbore. Kur arriti te njëra prej shpellave, pyeti veten se mos kafsha e humbur ishte futur brenda. Kështu hodhi një gur brenda shpellës duke menduar se do të nxiste kafshën të lëvizte po të ishte aty. *Bëj sikur po hedh një gur në shpellë.* Por dëgjoi zhurmën e një vazoje që thyhej. *Vendosni zhurmën e thyerjes së xhamave.* Kur bariu hyri në shpellë për të shqyrtuar, gjeti vazo prej argjile. Shumica ishin bosh, por disa kishin pergamena shumë, shumë të vjetra në to.

Si na ndihmon kjo të besojmë se Bibla është e vërtetë? Në pergamenat e gjetura tek ajo shpellë, ishin shkruar pothuajse të gjitha Shkrimet e Biblës. Deri në atë kohë, kur shkrimet e shkruara në pergamena vjetërsoheshin, bëheshin kopje të reja dhe të vjetrat hidheshin. Shkrimet ishin kopjuar qindra herë. Si mund të jesh i sigurt se nuk ndryshonin nga njëra kopje në tjetrën? A ju kujtohet se çfarë ndodhi në lojën e pëshpëritjes? Këto pergamena të veçanta quheshin Pergamenat e Detit të Vdekur. Pergamenat e Detit të Vdekur ishin shkruar gjatë kohës kur Jezusi ecte në tokë, pra mbi 2000 vjet para se të gjendeshin këto pergamena. Ajo që shkruhej në këto pergamena ishte njësoj me atë që kemi në Biblat tona sot. Asgjë nuk ka ndryshuar! E mrekullueshme! Kjo është një mënyrë tjetër si e dimë që Bibla është e vërtetë.

Mënyra e parë për të ditur se Bibla është e vërtetë është fakti që 40 njerëz të ndryshëm ishin pjesë e shkrimit të saj. Mënyra e dytë është fakti që Bibla nuk ka ndryshuar. *Sa herë që i përsërisni arsyet, jepu nxënësve një mundësi për t'i thënë ato, në vend që t'ua thuash ti.* Le të shohim numrin tre.

<u>Historitë e shkruara nga njerëz që nuk ishin të krishterë, e mbështesin atë</u>

Ndoshta është e pritshme që, njerëzit të cilët besojnë në Jezusin të mbështesin faktin se Bibla është e vërtetë. Por kishte njerëz që shkruan historinë, të cilët nuk besonin në Jezusin, por që shkruan për Jezusin dhe mrekullitë që Ai bëri. Gjërat që ata shkruan për Jezusin përkojnë me atë që është shkruar në Bibël.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mënyra e parë për të ditur se Bibla është e vërtetë, është fakti se 40 njerëz të ndryshëm ishin pjesë e shkrimit të saj. Mënyra e dytë është fakti se ajo nuk ka ndryshuar. Mënyra e tretë është që, njerëz të cilët nuk ishin të krishterë shkruan për Jezusin. Le të shohim numrin katër.

Profecitë

Kjo mund të jetë një fjalë e re për ty. Profecia është ajo që thotë Perëndia për të ardhmen. Bibla përmban rreth dy mijë profeci, të cilat tashmë janë përmbushur! Asnjë libër tjetër fetar nuk mund ta thotë këtë. Perëndia i dha një mesazh një profeti. Profeti ia tha njerëzve. Pastaj, vite më vonë – ndoshta qindra apo mijëra vite – ndodhi pikërisht ajo që qe thënë. Të gjitha këto gjëra ndodhën ashtu siç kishte thënë profeti se do të ndodhnin!

- A e di se çfarë do të ndodhë nesër?
- Po se çfarë do të ndodhë pas 100 vjetësh?
- Sa janë mundësitë që të kesh të drejtë?
- Duke ditur se shumë profeci tashmë janë përmbushur, mund të jemi të sigurt se edhe të tjerat do të përmbushen!

Le t'i hedhim një sy vetëm disa prej këtyre profecive të mrekullueshme. Kjo është entuziazmuese kur e mendon. *Referoju kronologjisë ndërsa shpjegon këtë pjesë të mësimit.*

A është Mikea në Dhiatën e Re apo të Vjetër? (Dh.V.) Dhiata e Vjetër u shkrua shumë kohë para se të lindte Jezusi.

Lexo: Mikea 5:2
Përmbledhje: Si tingëllon kjo për ty? Vargu po flet për Jezusin që lind në Bethlehem.

Lexo: Isaia 53:10
Përmbledhje: Edhe Isaia gjendet në Dhiatën e Vjetër. A keni ndonjë ide se për çfarë ishte kjo profeci? Jezusi do të vdiste për mëkatet tona, por do të rikthehej në jetë dhe ky ishte plani i Perëndisë. Isaia e profetizoi këtë 700 vite para se Jezusi të kryqëzohej!

Lexo: Isaia 44:28
Përmbledhje: Kjo profeci e mrekullueshme te Isaia 44:28 thotë se Kiri do të rindërtonte tempullin. Çfarë ka të mrekullueshme kjo? Kiri ende nuk kishte lindur dhe Isaia thotë emrin e atij që do të rindërtonte tempullin – Kiri. Dyqind vite më vonë, Kiri urdhëroi rindërtimin e tempullit!

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Perëndia është i gjithëdijshëm! Ai është i vetmi që e di se çfarë do të ndodhë në të ardhmen – jo biskotat fatsjellëse, jo lexuesit e fatit me një sferë të kristaltë, jo priftërinjtë e feve të tjera. Asnjërit prej tyre nuk u është përmbushur ndonjë profeci.

Mënyra e parë për të ditur se Bibla është e vërtetë është fakti që 40 njerëz të ndryshëm ishin pjesë e shkrimit të saj. Mënyra e dytë është fakti që Bibla nuk ka ndryshuar. Mënyra e tretë është fakti që njerëzit, të cilët nuk ishin të krishterë, shkruan për Jezusin. Dhe mënyra e katërt është fakti që shumë prej profecive të Biblës, tashmë janë përmbushur. Le të shohim të fundit.

Kur jeton sipas saj, je i bekuar

Provoje vetë! Mund të mos jetë provë shkencore si pergamenat, historia dhe profecitë, por mund ta gjykosh vetë nëse jeta është më mirë kur ndjek Fjalën e Perëndisë. Mund ta gjykosh vetë nëse je i bindur se po jeton sipas planit të Tij. Vetëm ti mund ta dallosh vërtet se si ishte jeta jote pa Perëndinë dhe Fjalën e Tij, dhe si është me Perëndinë dhe Fjalën e Tij. Dhe, në fund të jetës tënde, do të kesh kuptuar bekimin e të kaluarit të përjetësisë në qiell. Ti e kupton që Bibla është e vërtetë kur ajo ndryshon jetën tënde.

Le të përsërisim. Mënyra e parë për të ditur se Bibla është e vërtetë është fakti që 40 persona të ndryshëm ishin pjesë e shkrimit të saj. Mënyra e dytë është fakti që Bibla nuk ka ndryshuar. Mënyra e tretë është fakti që, njerëz të cilët nuk ishin të krishterë, shkruan për Jezusin. Mënyra e katërt është fakti që shumë prej profecive të Biblës tashmë janë përmbushur. Dhe në fund, ne e dimë se Bibla është e vërtetë, sepse ajo ndryshon jetën tonë.

Përfundimi

Perëndia na siguroi Fjalën e Tij, gjë që na tregon për dashurinë e Tij të madhe për ne. Përmes njerëzve të ndryshëm, Perëndia dha mesazhin e Tij – letrën e Tij të dashurisë. Duke lexuar Biblën mund të mësosh ta duash Jezusin dhe të zbulosh se si mund të kesh një marrëdhënie me Perëndinë. Edhe pse besojmë se Bibla është e vërtetë, sepse mesazhi i Perëndisë ka ndryshuar jetën tonë, ne e dimë se është e vërtetë edhe sepse ajo është ndryshe nga çdo libër tjetër. Të gjithë shkrimtarët e saj janë dakord me njëri-tjetrin, është njësoj siç ka qenë mijëra vite më parë dhe shumë prej profecive të saj tashmë janë përmbushur. Perëndia siguroi shumë mënyra që ne të kemi besim të plotë se Fjala e Tij është e vërtetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

A beson se Fjala e Perëndisë është e vërtetë? Nëse dikush do të të pyeste: “Si e di që Fjala e Perëndisë është e vërtetë?”, çfarë do të thoshe dhe si do të ndiheshe pasi të jepje përgjigjen? Le të lutemi dhe t’i kërkojmë Perëndisë që të kujtojmë çfarë mësuam sot.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. A është e vërtetë Bibla? (Po.)
2. Si ndryshonin nga njëri-tjetri shkrimtarët e Biblës? (Kishin nivele të ndryshme edukimi, prejardhje të ndryshme, punë të ndryshme.)
3. Sa njerëz e shkruan Biblën? (40.)
4. Çfarë gjeti bariu i ri në shpellë kur hodhi gurin? (Vazo argjile me pergamena që kishin Shkrimet e shkruara në to.)
5. A shkruan për mrekullitë e Jezusit edhe njerëz që nuk besonin se Ai është Biri i Perëndisë? (Po.)
6. Çfarë janë profecitë? (Mesazhe nga Perëndia që na tregojnë për të ardhmen.)
7. Përse është e mrekullueshme që Isaia 44:28 thotë se Kiri do të rindërtojë tempullin? (Sepse Kiri nuk kishte lindur në atë kohë.)
8. A na ndryshon leximi i Biblës dhe të ndjekurit e planit të Perëndisë për jetën tonë? (Po.)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Harta e gjurmuesit

Mësim tematik: Jezusi është Mbreti ynë

Kupto si duhet:	Jezusi është Mbreti ynë.
Mendo si duhet:	"Unë do të të përlëvdoj, o Perëndia im dhe Mbreti im, dhe do të bekoj emrin tënd përjetë." Psalmi 145:1
Vepro si duhet:	Unë do të adhuroj Mbretin.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i përulur kur adhuroj Mbretin.

PËRGATITU!

Gjatë periudhës së Krishtlindjes ndajmë me njëri-tjetrin entuziazmin për lindjen e Jezusit – për faktin se Perëndia vetë erdhi në tokë në formën e një foshnjeje të pafuqishme. Në këtë mësim duam që t'i ndihmojmë nxënësit të shkojnë përtej festës për lindjen e një foshnjeje. Duam që ata të rrokin se kjo foshnje është vetë Krijuesi i universit, Ai që projektoi dhe bëri gjithçka. Duhet të kemi këtë bindje për ta adhuruar Atë, sepse Ai është Mbreti i gjithçkaje. Ai ishte, është dhe gjithmonë do të jetë, më i madh se çdo krijim i Tij. Reagimi ynë duhet të jetë përulje në respekt të madh para Perëndisë sonë mbretëror e të shenjtë.

Lutu: Lutu që Perëndia të të japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe që nxënësit ta kuptojnë vërtet se duhet ta adhurojmë Mbretin.

Lexo: Luka 1:26-38, 2:1-20; Mateu 2:1-11; Psalmi 145:1

Kupto si duhet: Jezusi është Mbreti ynë

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor: Çfarë është në të vërtetë adhurimi? Përkufizimi i kurikulës "Zbuluesit" për adhurimin është: "T'i shprehësh Perëndisë se sa vlerë ka Ai." Adhurimi është më tepër se sa thjesht këngët; është lutje, veprime dhe fjalë.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Sill disa objekte simbolike të Krishtlindjes për të përfaqësuar secilën prej pjesëve të mësimit: krahët e engjëjve, shkopin e bariut dhe dhuratat.
2. Shkruaj: "Kush adhuroi?" në një tabelë apo karton. Sa herë të hasni gjatë mësimit një person që adhuron Perëndinë Atë apo Jezusin, Perëndinë Bir, vizatojeni. Në fund të mësimit, shtoni më tepër "figura misterioze" dhe sfidoji nxënësit të jenë pjesë e grupit të njerëzve që adhurojnë Jezusin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Ndalu dhe lëshohu!

Qëllimi: Të prezantojmë idenë e të ndalurit për të adhuruar Jezusin, Mbretin tonë.

<u>Alternativa 1:</u> Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Bilbil
- Etiketa shpërblyese


Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ky është një version i përpunuar i lojës "Ma le – ta lash". Zgjidh dy nxënës si "Lënësit". Nëse ke më shumë se njëzet nxënës apo hapësirë shumë të madhe, atëherë mund të zgjedhësh më shumë nxënës.
2. Nxënësit që janë zgjedhur si "Lënësit", do të qëndrojnë në mes të dhomës. Të gjithë të tjerët do të shpërndahen.
3. Pasi ti të japësh një sinjal të gjithë nxënësit do të fillojnë të vrapojnë dhe duhet të jenë në lëvizje gjatë gjithë kohës. Kushdo që preket nga "Lënësi" duhet të bjerë menjëherë në gjunjë dhe "Lënësi" duhet të bërtasë "Ndalu dhe lëshohu – Jezusi është Mbreti ynë!" Gjatë gjithë lojës ata duhet të qëndrojnë në atë pozicion.
4. Pas dy ose tre minutash, bjeri bilbilit dhe të gjithë duhet të ngrijnë. Pastaj numëro se sa nxënës janë në gjunjë dhe jepi secilit prej "Lënësve" aq etiketa shpërblyese sa numri i personave në gjunjë.
5. Zgjidh dy nxënës të tjerë si "Lënës".
6. Luani aq raunde sa t'ju lejojë koha.

<u>Alternativa 2:</u> Stacioni i artit ose një hapësirë me tavolina

Mjetet:

- Letra me ngjyra në formë trekëndore (nga një për secilin; prijini paraprakisht) (burim i printueshëm)
- Hapëse vrimash (bëj një vrimë në qoshet e sipërme të çdo flamuri paraprakisht)
- Spango ose fije (për të krijuar një varg me trekëndëshat)
- Lapustila në ngjyra të ndryshme
- Disa shembuj të gatshëm



 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Secili prej nxënësve do të zbukurojë një trekëndësh që do të përdoret për të formuar një banderolë adhurimi dhe lavdërimi.
2. Inkurajoji nxënësit të shkruajnë fjalë adhurimi dhe lavdërimi për Jezusin, Mbretin tonë, në trekëndëshat e tyre. Nxënësit e vegjël mund të vizatojnë. Inkurajoji të përdorin fjalë nga këngët e tyre të preferuara të adhurimit.
3. Tregoju shembujt e përfunduar dhe jepu sugjerime atyre që nuk dinë se çfarë të shkruajnë apo atyre që janë për herë të parë. Alternativë: Paraprakisht krijo një listë me fjalë dhe fraza që nxënëist mund t'i përdorin te trekëndëshat e tyre.
4. Herë pas here kërkoju nxënësve të ndalen dhe (me kujdes) të lëshojnë lapustilën dhe të bërtasin: "Jezusi është Mbreti ynë!" Kjo do t'u japë një mundësi të ndalen dhe të lavdërojnë e të adhurojnë Jezusin, Mbretin tonë.
5. Ndërkohë që nxënësit përfundojnë, drejtuesit duhet t'i ndihmojnë t'i vendosin trekëndëshat te fija/spangoja për të formuar banerin.
6. Kur të përfundojë baneri, vareni te hapësira e grupit të adhurimit.

Ide alternative: Mund të përdorni kapëse rrobash ose karfica për t'i kapur trekëndëshat pas litarit.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – lidhja e KZ-së me mësimin: Kemi luajtur Ndalu dhe Lëshohu. Çfarë bëre kur të preku "Lënësi"? (U ndale dhe u lëshove në gjunjë) Përgjatë ditës, a e ke të vështirë të ndalesh dhe të adhurosh Jezusin? (Po) Mirëpo, a e meriton Ai? (Po!) Sot do të mësojmë se përse Ai e meriton adhurimin tonë.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të udhëheqë në lutje, duke e falënderuar specifikisht Perëndinë që dërgoi Jezusin.*

Zbuloje: Në mësimin e sotëm do të shohim vargje edhe nga Dhiata e Re edhe nga Dhiata e Vjetër. Do ta nisim me librin e Lukës. A gjendet Luka në Dhiatën e Re apo te e Vjetra? (Dh.V.) Kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 1:26.

Kronologjia: A e gjeni dot lindjen e Jezusit te kronologjia? Kërkoju nxënësve të drejtohen atje.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantim me mësimin nga Bibla: Kur studiojmë lindjen e Jezusit, mësojmë për disa personazhë. Perëndia ia dha lajmin e mirë secilit në mënyrë të veçantë e të pazakontë. Megjithatë, reagimi i të gjithëve ishte i ngjashëm. Të gjithë e kuptuan se po merrnin një mesazh nga Perëndia i plotfuqishëm, nga i vetmi Perëndi, Krijuesi i universit. Të gjithë e kuptuan se ajo që po ndodhte ishte përtej aftësive të tyre -se ishte diçka që vetëm Perëndia Krijues mund ta bënte. Kur e dëgjuan lajmin u përgjigjën duke adhuruar sepse Ai është Mbreti i shenjtë i gjithçkaje! Le të shohim në Bibël mësimin e jashtëzakonshëm të lindjes së Jezusit dhe se si mamaja e Tij, Maria, barinjtë dhe dijetarët e adhuruan këtë Mbret.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 1:26-38, 2:1-20; Mateu 2:1-11; Psalmi 145:1

Një engjëll i shfaqet Marisë

Parafrazim i Lukës 1:26-37:

Maria do të martohej me një burrë të quajtur Jozef. Mirëpo, para se të martohej me Jozefin, një engjëll iu shfaq papritur! Me shumë mundësi Maria ishte shumë e habitur. Engjëlli kishte një mesazh për të nga Perëndia. Engjëlli i tha se ajo do të lindte një fëmijë, babai i të cilit ishte Perëndia dhe se emri i Tij do të ishte Jezus. María mund të kishte debatuar me engjëllin, apo të ishte zemëruar, ose të trishtohej dhe të qante. Por ajo nuk veproi ashtu! Fryma e Perëndisë e ndihmoi të kuptonte se kjo foshnjë ishte Mbreti i gjithçkaje që ishte krijuar. Dëgjoni përgjigjen e Marisë për engjëllin:

Lexo Luka 1:38

Përmbledhje: Uau! Ajo do të lindte një fëmijë që do të ishte më i jashtëzakonshëm se çdo gjë e krijuar. Maria e dinte se sa i madh është Perëndia dhe e adhuroi duke iu bindur Perëndisë së mrekullueshëm që mund ta realizonte këtë. Ajo mund të ketë menduar diçka të ngjashme me vargun nga Mendo si duhet, Psalmi 145:1. **Lexo Psalmin 145:1**

Uau! Vetëm Krijuesi mund ta bënte këtë!

Engjëjt i shfaqen barinjve

Parafrazim i Lukës 2:1-20:

Thuajse kishte ardhur koha që foshnja të lindte, dhe Jozefi dhe Maria duhej të shkonin në Betlehem për t'u numëruar për censusin. Kur mbërritën në Betlehem, i vetmi vend që Jozefi mundi të gjente për të kaluar natën ishte stalla ku rrinin kafshët. Foshnja Jezus lindi pikërisht në një vend shumë të thjeshtë të llogaritur për kafshët.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jashtë qytetit gjendeshin barinj nëpër fusha që kujdeseshin për grigjën e deleve. Papritur iu shfaq një engjëll. Engjëlli iu dha mesazhin se një foshnjë kishte lindur e Ai do të ishte Shpëtimtari i botës. Kjo foshnjë ishte Mbreti i gjithçkaje! Engjëlli u tregoi se ku ta gjenin foshnjën.

Pastaj qielli u mbush me engjëj. Të gjithë po adhuronin Perëndinë e plotfuqishëm – Mbretin e gjithë krijimit. Uau! Vetëm Perëndia mund të urdhërojë engjëjt të sjellin një mesazh nga qielli në tokë! Kur engjëjt u larguan, barinjtë nxituan në Betlehem për të gjetur Mbretin. Kur e gjetën Jezusin, e adhuruan. Ata mund të kenë menduar diçka si Psalmi 145:1. **Lexo Psalmin 145:1**

Mirëpo, barinjtë nuk e mbajtën dot lajmin vetëm për vete. Ata i treguan kujtdo që takuan se foshnja Mbret kishte lindur. Ata adhuruan duke u treguar të tjerëve për Mbretin më të veçantë. Ata kishin pritur lindjen e Shpëtimtarit dhe tani ishin plot e të tejmbushur me gëzimin e lajmit të lindjes së Mbretit.

Dijetarët erdhën për të vizituar Jezusin

Parafrazim i Mateut 2:1-11:

Në një vend shumë të largët ishin disa njerëz të zgjuar, të quajtur dijetarë, që shikonin yjet e mësonin prej tyre. Ata vunë re një yll një natë dhe ishin të sigurt se ai do t'i drejtonte te Mbreti i ri. Ata mblodhën dhurata për t'ja cuar Mbretit të ri. Dijetarët e nisën udhëtimin e tyre duke përdorur yllin e ri si udhëheqës.

Më në fund mbërritën në vendin mbi të cilin qëndronte ylli. Ishte pikërisht aty ku qëndronte Jezusi. Le të zbulojmë se ç'ndodhi.

Lexo Mateun 2:10-11

Përmbledhje: Çfarë bënë dijetarët? Ata u mbushën me gëzim kur kuptuan se ishin në praninë e foshnjës më të rëndësishme në histori – Mbreti i gjithçkaje – dhe menjëherë u përkulën në adhurim. Ata mund të kenë menduar diçka të ngjashme me vargun nga Mendo si duhet, Psalmi 145:1. **Lexo Psalmin 145:1**

Dijetarët ishin burra shumë të rëndësishëm, por e dinin se kjo foshnjë ishte më e rëndësishme se ata. Përulja ishte mënyra e tyre për të treguar se sa i madh ishte Jezusi. Ata paraqitën dhuratat e tyre me ar, mirrë dhe temjan. Edhe pse dhuratat ishin shumë të shtrenjta, nuk ishin asgjë në krahasim me dhuratën që Perëndia kishte bërë duke dërguar Jezusin si Shpëtimtar. Uau! Vetëm Perëndia që krijoi yjet mund të përdorte një yll për t'i udhëhequr dijetarët te Jezusi!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Maria e adhuroi Perëndinë duke iu bindur. Barinjtë e adhuruan Perëndinë duke u treguar të tjerëve për Mbretin e ri. Dijetarët e adhuruan duke bërë dhurata e duke u përulur. Secili e kuptoi madhështinë e Jezusit dhe nuk mund të mos e adhuronin!

Përfundimi

Sa më tepër mëson për Jezusin, aq më shumë dëshiron ta adhurosh si Mbretin e gjithçkaje. Kur sheh, dëgjon apo ndjen diçka që të kujton Jezusin, duhet të ndalesh e të biesh në adhurim. Kur barinjtë dëgjuan për lindjen e foshnjës, ata ndalën gjithçka po bënin dhe shkuan ta adhuronin. Kur dijetarët gjetën Jezusin, ndalën dhe u përulën. I gjithë qëllimi i udhëtimit të tyre ishte të adhuronin jezusin!

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Nëse mbreti apo presidenit i shtetit tonë (ose ndonjë i famshëm tjetër) do të të kalonte përbri në një paradë, a do të prisje derisa të shkoje në shtëpi për ta përshëndetur? Jo, do të ndaloje në atë cast dhe do ta përshëndesje me entuziazëm dhe respekt.

Kur përulesh po i thua Jezusit se e kupton që Ai është i madh dhe ti je i vogël; ky quhet adhurim. Kur i zgjat krahët drejt qiellit dhe ngre kokën lart, por i tregon Jezusit se e kupton që Ai është shumë më i madh nga sa mund të imagjinosh ti. Qoftë nëse përulesh apo ngre duart, Jezusi e meriton adhurimin tënd. Ndalo tani dhe lëshohu në përnderim. Ky është Mbreti për të cilin festojmë në Krishtlindje. Mund të ndiejmë përulësi kur vërtet e adhurojmë Jezusin.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Si e adhuroi Maria Perëndinë? (Duke u treguar e bindur ndaj Tij)
2. A panë barinjtë engjëj që adhuronin Perëndinë? (Po)
3. Çfarë bënë dijetarët kur gjetën Jezusin? (Ata u përulën dhe e adhuruan)
4. Përse duhet ta adhurosh Perëndinë?
5. Si mund ta adhurosh Perëndinë këtë javë?
6. Sa fjalë të vijnë në mendje për ta përshkruar Jezusin?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lojërat e fundit të përsëritjes

Këshilla:

- *Zhvillo të njëjtën lojë disa javë rresht, që nxënësit të mësohen me rregullat, kështu nuk duhet të përqendrohesh shumë te udhëzimet.*
- *Printoji dhe ngjiti diku udhëzimet, që nxënësit t'i shohin.*

Garë quiz (mjetet: dy zilka apo diçka tjetër që shkakton zhurmë)

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Zgjidh dy nxënës (një nga secila skuadër) që të vijë përpara.
3. Bëj një pyetje nga përsëritja.
4. Nxënësi i parë që i bie ziles dhe përgjigjet saktë, fiton një pikë.
5. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton.

Variante argëtuese:

- **Hedhje e topit:** përgjigje e saktë = godit drejt koshit për të fituar një pikë shtesë
- **Hedhja e zarit:** përgjigje e saktë = hidh zarin (zaret) për të përcaktuar pikët e fituara
- **Tic Tac Toe:** përgjigje e saktë = vendos X ose O në tabelë
- **Rrotullo rrotën:** përgjigje e saktë = rrotullo për të fituar pikë, shpërblime ose etiketa shpërblyese
- **Zarfi i mistershëm:** përgjigje e saktë – zgjidh një zarf që ka pikë ose çmime
- **Këpucët:** përgjigje e saktë = tërhiqni në tokë këpucët e skuadrës; këpuca që arrin e para, fiton
- **Goditje "e vërtetë ose e gabuar"** (mjetet: dy vrasëse mizash): shkruaj "e vërtetë" dhe "e gabuar" në tabelë; nxënësi i parë që godet përgjigjen e saktë, fiton një pikë (ose shkruaj "A", "B" dhe "C" për pyetje me alternativa)

Mbytu ose noto

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Kërkoju të ngrihen të gjithë në këmbë.
3. Pyet njërin nga nxënësit që janë në këmbë.
4. Nëse përgjigjet saktë, ata mund të:
   a. "mbysin" dikë nga skuadra kundërshtare, pra, personi tjetër duhet të ulet dhe të presë që dikush ta "shpëtojë" – OSE –
   b. mund të "shpëtojnë" dikë nga skuadra e tyre që është "mbytur" nga dikush tjetër.
5. Skuadra e parë që i "mbyt" të gjithë anëtarët e skuadrës kundërshtare, fiton!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shëno shumë pikë

1. Vendosu paraprakisht pyetjeve të përsëritjes vlerë në pikë, duke i dhënë më shumë pikë pyetjeve më të vështira (e vështirë = 20 pikë, mesatare = 15 pikë, e thjeshtë = 10).
2. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
3. Skuadrat duhet ta zgjedhin pyetjen e tyre në bazë të vlerës së pikëve.
4. Kur japin përgjigje të saktë, fitojnë pikë për skuadrën.
5. Skuadra e parë që mbledh 100 pikë fiton!

Vendosja në piramidë e gotave plastike (2 sete me gota plastike)

1. Ndaji nxënësit në skuadra.
2. Sa herë që nxënësit përgjigjen saktë, fitojnë një gotë, të cilën duhet ta vendosin te piramida e skuadrës. Piramida do të ndërtohet me çdo gotë që fitohet.
3. Skuadra e parë që i fiton të gjitha gotat dhe përfundon piramidën, fiton.

Gotë mirësie (mjetet: shkopinj druri të vendosur në një gotë me ngjyra; vendos paraprakisht vlerë në pikë te shkopinjtë; vendos pikë pozitive dhe negative, pastaj vendosi shkopinjtë me kokë poshtë që të mos dallohen pikët)

1. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
2. Bëji njërit prej tyre një pyetje përsëritjeje.
3. Kur një nxënës të përgjigjet saktë, mund të zgjedhë njërin nga shkopinjtë dhe të fitojnë pikët e shënuara në të.
4. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton!

Gjejeni se kush...

1. Kërkoji njërit prej nxënësve të ulet përballë klasës dhe pas vetes të ketë një tabelë ose një copë letre.
2. Shkruaj emrin e personit për të cilin kanë mësuar javën e kaluar në tabelën që ndodhet pas nxënësit të ulur në karrige.
3. Kërkoju nxënësve të ngrenë dorën dhe ai që është ulur në karrige do të zgjedhë tre persona që do t'i japin ndihma.
4. Nëse e gjen personazhin, fiton një Etiketë shpërblyese.
5. Personi që jep të dhënën më ndihmuese, fiton vendin te "karrigia e të ftuarit" për raundin e ardhshëm.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Topi i plazhit (mjetet: top plazhi; shkruaj paraprakisht te topi një sërë pyetjesh që mund të aplikohen për çdo mësim, për shembull: Kush ishte personazhi kryesor në këtë mësim? Çfarë mësuam nga KZ-ja? Cili është vargu i ditës nga "Mendo si duhet"? Ku gjendet mësimi ynë në Bibël?)

1. Mos e ndaj klasën në skuadra.
2. Luaj muzikë ose kërkoji njërit nga drejtuesit të recitojë 2 nga 12 vargjet kyç ndërkohë që nxënësit e kalojnë topin te njëri-tjetri. Nxënësit duhet të qëndrojnë ulur.
3. Kur të ndalojë muzika ose të kenë përfunduar vargjet, kushdo që ka topin në dorë duhet t'i përgjigjet pyetjes në të cilën ka gishtin e madh.
4. Jepi një Etiketë shpërblyese nëse përgjigjet saktë.

Rreth botës

1. Mos e ndaj klasën në skuadra; kërkoju të gjithëve të ulen në rreth, në tokë ose me karrige.
2. Zgjidh dy nxënës që të qëndrojnë në mes të rrethit.
3. Bëj një pyetje përsëritjeje.
4. Dy nxënësit e parë që ngrihen dhe përgjigjen saktë, fitojnë raundin.
5. Fituesi qëndron në këmbë.
6. Nxënësi që e humbi vendin, ulet atje ku ishte ulur fituesi.
7. Tani fituesi garon kundër nxënësit tjetër që është ulur pranë tij (në kah orar).
8. Vazhdoje këtë proces deri sa të përfundojë rrethi.
9. Qëllimi është që nxënësit të qarkullojnë nëpër të gjithë rrethin derisa të kthehen në vendin fillestar.
10. Nëse një nxënës arrin të kthehet në karrigen fillestare, fiton lojën.
11. Nëse mbaron koha para se dikush të kthehet në vendin fillestar, atëherë fiton ai që ka ecur më shumë përpara.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

LIBRI PA FJALË

T'U PREZANTOJMË FËMIJËVE UNGJILLIN

Libri pa fjalë është mënyra kryesore se si e ndajmë Ungjillin me fëmijët në kurrikulën e Zbuluesit. Do të vini re se do t'i i referohemi çdo javë ndërsa prezantohet mesazhi i Ungjillit. Secila ngjyrë ka një kuptim të thjeshtë dhe një varg kyç që do t'i ndihmojë fëmijët të marrin kuptimin e vërtetë të dashurisë së Perëndisë dhe të mënyrës se si mund të kemi një marrëdhënie personale me Të, tani e në përjetësi.

Libri pa fjalë është një mjet që paraqet një mesazh të qartë të Ungjillit. Për fëmijët më të rritur, mund t'ju duket si një mjet shumë i përsëritur, por pasi rishikuam rezultatet e testit, mësuam se fëmijët më të rritur dinë fjalën kyç, ngjyrën dhe vargun, por shpesh nuk dinë ta përdorin si mjet për të ndarë apo mbrojtur besimin e tyre. Mbajeni në mendje ndërsa modeloni mesazhin e Ungjillit për fëmijët çdo javë.

Përpiquni që me raste ta përdorni prezantimin e Ungjillit pa iu referuar ngjyrave. Pasi të keni përfunduar, pyetini fëmijët se çfarë iu kujton. Ose, filloni ta ndani Ungjillin duke shprehur gëzimin që keni për shkak se jeni pastruar (shpëtuar) nga mëkati në jetën tuaj. Është e rëndësishme të përfshihet gëzimi i të qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Kur bëhesh i krishterë, Perëndia është Ati yt Qiellor dhe ti u bashkohesh të gjithë të krishterëve si pjesë e familjes së kishës së Tij.

Përdorimi i Librit pa fjalë

Ngjyra e artë – Faqja e artë na kujton dashurinë e Perëndisë për ne dhe se si ne, si të krishterë, mund të kemi sigurinë se një ditë do të shkojmë në qiell. Gjoni 14:2 thotë: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend". Qielli është i vërtetë… dhe është një vend i përsosur e real. Do të jetë i mbushur me gëzim, lumturi, rrugë të arta, me praninë e vetë Perëndisë dhe do të jetë një familje e përsosur. Por diçka nuk është në qiell… dhe ajo është mëkati.

Ngjyra e errët – Faqja e errët përfaqëson mëkatin. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë që është kundër Perëndisë. Shembuj të mëkatit janë kopjimi, vjedhja dhe thashethemet. Këto gjëra nuk do të jenë në qiell dhe janë gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë. Romakëve 3:23 thotë: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë". Ndëshkimi i mëkatit është vdekja e përjetshme, që do të thotë se nuk mund të shkojmë në qiell, por ka shpresë…

Ngjyra e kuqe – Faqja e kuqe na kujton Jezusin. Jezusi është Biri i vetëm i përsosur i Perëndisë, që erdhi në tokë të jetonte një jetë të përsosur. Për shkak të jetës së Tij të përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë. Hebrenjve 9:22b thotë: "...dhe pa derdhur gjak, nuk ka ndjesë". Jezusi derdhi gjakun e Tij dhe për këtë shkak, Ai është e vetmja rrugë për në qiell. Jo përmes veprave të mira (Efesianëve 2:8-9), por vetëm përmes dhuratës së Jezusit. Pranimi i kësaj dhurate falas nga Jezusi është zgjedhje personale. Por prit, duhet të të tregoj diçka... Jezusi nuk qëndroi i vdekur, Ai u ngrit sërish dhe pati fitore mbi mëkatin!

Ngjyra e bardhë – Faqja e bardhë na kujton se, nëse besojmë këto të vërteta, marrim falje për mëkatin tonë. Veprat 16:31 thotë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote". Beso dhe do të shpëtosh nga ndëshkimi i mëkatit tënd. Mëkati yt mund të falet dhe ti mund të pastrohesh. Por kjo është një zgjedhje që çdo individ duhet ta bëjë vetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ngjyra e gjelbër – Faqja e gjelbër na kujton se, pasi i kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd, Ai dëshiron që ti të afrohesh më tepër me Të. Është një *marrëdhënie*, jo një fe. Ai bëhet udhëheqësi i jetës sate. Për shkak se Ai është udhëheqësi yt, do të duash të rritesh… si bari në muajt e ngrohtë të verës (i gjelbër). 2 e Pjetrit 3:18a thotë: "Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht". Ne afrohemi me Të kur lexojmë Biblën, kur lutemi dhe kur i bindemi Fjalës së Tij.

Duket fantastike, apo jo? Pavarësisht sa vjeç je, kjo është një zgjedhje që duhet ta bësh vetë! Mund të zgjedhësh ta pranosh sot këtë të vërtetë të mrekullueshme. Nëse dëshiron të zgjedhësh t'i kërkosh Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Zoti yt, duhet të lutesh ose të flasësh me Perëndinë për këtë. Perëndia është real dhe mund të të dëgjojë kur lutesh.

Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të lutesh tani për këtë:

1. Pranoje që je mëkatar… tregoji për mëkatin që të mundon dhe se ti e di që ai mëkat nuk i pëlqen Perëndisë. (**ngjyra e errët**)
2. Tregoji se beson që Jezusi vdiq dhe mori ndëshkimin për mëkatin tënd. (**ngjyra e kuqe**)
3. Kërkoji personalisht Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës sate. (**ngjyra e bardhë**)
4. Falënderoje që të ka falur dhe që u bë udhëheqësi i ri i jetës sate.

Nëse vërtet i ke kërkuar Perëndisë të të shpëtojë dhe të bëhet udhëheqësi i jetës saee, duhet të dish që mëkati të është falur dhe ti je fëmijë i Perëndisë.



Këshilla shtesë

Për të ndihmuar në udhëzimin e fëmijëve drejt shpëtimit, programi i Zbuluesit siguron kartën *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*.



Për të ndihmuar me prezantimin e Ungjillit dhe për të filluar me dishepullimin e fëmijëve, programi i Zbuluesit ofron fletushkat *E beson apo jo?* dhe *Po tani, çfarë ndodh?* si dhe libër shënuesin *Unë besoj*.



Fletushka *E beson apo jo?* shpjegon Ungjillin duke përdorur Shkrimin, përkufizime të përshtatshme për fëmijët dhe kornizën e Librit pa fjalë. Është një mjet i shkëlqyer për t'i shpjeguar Ungjillin një fëmije të interesuar, dhe për t'ia dhënë me vete fëmijës që dëshiron të mendojë për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij.

Nëse një nxënës zgjedh t'i besojë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar, fletushka *Po tani, çfarë ndodh?*, është një prezantim i mirë i çfarë do të thotë të jetosh jetën e krishterë. Mbulon shkurtimisht tema si: identiteti i tyre në Krishtin, disiplina frymërore, adhurimi dhe lutja, dhe të bërët pjesë e familjes së Perëndisë.



Pasi fëmija merr vendimin t'i besojë Krishtit si Shpëtimtar, libër shënuesi *Unë besoj* mund të plotësohet si kujtesë e këtij vendimi të rëndësishëm. Shënuesin e mban nxënësi dhe pjesa fundore e tij plotësohet dhe i dorëzohet drejtuesit, në mënyrë që të gëzohemi bashkë me nxënësin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mirënjohje dhe Falënderime

Falënderime të sinqerta për Shawn Thornton, pastor i kishës Calvary Community Church në Westlake Village, Kaliforni, për përdorimin e konceptit “Mendo si duhet”, “Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”. Kjo ide, bashkë me “Kupto si duhet”, është bërë struktura e çdo mësimi të qendërzuar në Bibël në këtë kurikul. E vlerësojmë shumë që ka lejuar këtë ide të jetë pjesë e kësaj kurikule, që të tjerë të mund të pajisen për t’u mësuar fëmijëve të “Kuptojnë si duhet”, të “Mendojnë si duhet”, të “Veprojnë si duhet” dhe të “Ndihen si duhet”.

Jemi mirënjohës për bashkëpunimin e vyer që kemi me “Awana International” dhe që na kanë dhënë lejen t’i referohemi Awana-s brenda kurikulës dhe materialeve trajnuese të “Discovery Land”. Kemi parë se Perëndia e ka përdorur marrëdhënien mes kurikulës të së dielës dhe programit të mesjavës nga Awana që të ketë një ndikim të fortë te nxënësit tanë nëpër botë.

Awana është një markë e regjistruar e “Awana Clubs International”. Përdorur me leje. Appleton Alliance Association, Inc vepron në pavarësi nga “Awana Clubs International” dhe është përgjegjëse vetëm për përmbajtjet e kësaj kurikule.

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla, ABS 2009, përdorur me leje nga *Albanian Bible Society (A.B.S.).*

LEGO® është një markë tregtare e grupit të legove. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association